

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

AGROBIZNES

Niveli IV i KSHK

(Bllok 4 vjeçar)

Kodi: H/1-IV-23

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2023

Përmbajtja

- I. Qëllimet e arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, 4 vjeçar, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimet të nxënësve në arsimin profesional, në Profilin mësimor “Agrobiznes” niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për arsimin profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre në nivelin teknik të mesëm për bujqësi tradicionale dhe organike për tu punësuar në fushën e agrobiznesit në institucione/ndërmarrje shtetërore ose private, apo për krijimin e menaxhimin e një biznesi privat, si person fizik ose juridik”*. Zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimit emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijojnë nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes” niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijojnë kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MFE përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të ketë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në proceset e punëve në fushën e agrobiznesit.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të përdorë mjete dhe burime dixhitale në funksion të veprimtarisë profesionale.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes në punë.
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- Të përdorë teknologjinë dixhitale në funksion të veprimtarisë profesionale.
- Të kultivojë perime.
- Të kultivojë bimë e arave.
- Të kujdeset ndaj kafshëve bujqësore.
- Të përdorë dhe kryejë shërbime ndaj makinave bujqësore.
- Të prodhojë fidanë të kulturave drufrutore.
- Të kryejë punime të ujitjes, kullimit dhe sistemimit të tokave bujqësore.
- Të kujdest gjatë riprodhimit të kafshëve bujqësore.
- Të mbledhë prodhimet bujqësore.
- Të përpunojë prodhimin bimor.
- Të përpunojë prodhimin blegtoral.
- Të krijojë dhe organizojë fermën bujqësore.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të fermës bujqësore.
- Të inventarizojë pasurinë e fermës.
- Të planifikojë prodhimin në fermën bujqësore.
- Të prodhojë produkte organike bimore.
- Të realizojë mbrojtjen e integruar në bujqësi.
- Të blejë dhe shesë produkte bujqësore.
- Të magazinojë, ruaj dhe sigurojë cilësinë e prodhimit bujqësor.

- Të kryejë marketingun në fermën bujqësore.
- Të menaxhojë burimet njerëzore në fermën bujqësore.
- Të kryejë veprime që lidhen me llogaritjet ekonomike në fermën bujqësore.
- Të kontribuojë në dixhitalizimin e fermës bujqësore.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale dhe me Certifikatën e teknikut/menaxherit të mesëm në Profilin e agrobiznesit. Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si teknik/menaxher i mesëm në ferma bujqësore, në ferma blegtorale, në ferma të prodhimit organik, në njësi ekonomike të bletarisë, të agroturizmit, të kultivimit të bimëve mjekësore, zbukuruese dhe aromatike, në shoqatat e bashkëpunimit bujqësor etj. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet, në sektorin e bujqësisë tradicionale dhe organike. Me mbarimin e arsimit profesional në Profilin “Agrobiznes” në nivelin IV të KSHK, nxënësi fiton ka mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesmes dhe universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK (4 vjeçar)						
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (540/ 576)	10/11 360/ 396)	10/11 (360/ 396)	13/14 (416/ 448)
1		Gjuhë shqipe	1	1	1	1
2		Letërsi	1	1	1	1
3		Gjuhë e huaj 1	2	2	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2	2	2
6		Fizikë	2	-	-	1
7		Kimi	1	-	1	-
8		Biologji	-	-	1	1
9		Shkenca sociale	2	-	-	1
10		Histori	-	2	-	1
11		Gjeografi	1	-	1	-
12		Teknologji informimi e komunikimi	1	1	-	1
13		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1	1	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	8 (288)	10 (360)	8 (288)	8 (256)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	-	-	2	2
2	L-05-198-12	Mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	-	-	1
3	L-14-622-23	Bazat e prodhimit bimor	2	1	-	-
4	L-14-597-23	Kulturat bujqësore	3	2	-	-
5	L-28-623-23	Bazat e prodhimit blegtoral	2	2	-	-

6	L-14-624-23	Teknologji bujqësore	1	2	-	-
7	L-08-625-23	Përpunimi i prodhimeve bimore	-	1	-	-
8	L-17-626-23	Marketing bujqësor	-	2	-	-
9	L-14-285-23	Bazat e bujqësisë organike	-	-	1	-
10	L-17-627-23	Menaxhimi i fermave bujqësore	-	-	3	3
11	L-17-628-23	Njohuri ekonomike në bujqësi	-	-	2	2
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	5 (180)	7 (252)	9 (324)	6 (192)
1	M-14-1944-23	Kultivimi i perimeve	54	-	-	-
2	M-14-1842-23	Kultivimi i bimëve të arave	54	-	-	-
3	M-28-1945-23	Kujdesi ndaj kafshëve bujqësore	36	-	-	-
4	M-36-1946-23	Përdorimi dhe shërbimi i makinave bujqësore	36	-	-	-
5	M-14-1843-23	Prodhimi i fidanëve të kulturave drufrutore	-	54	-	-
6	M-14-1947-23	Punime për ujitjen, kullimin dhe sistemimin e tokave	-	36	-	-
7	M-28-520-23	Kujdesi gjatë riprodhimit të kafshëve bujqësore	-	54	-	-
8	M-14-1948-23	Mbledhja e prodhimeve bujqësore	-	36	-	-
9	M-08-1949-23	Përpunimi i prodhimit bimor	-	36	-	-
10	M-08-1950-23	Përpunimi i prodhimit blegtoral	-	36	-	-
11	M-17-1951-23	Krijimi dhe organizimi i fermës bujqësore	-	-	72	-
12	M-17-1952-23	Plotësimi i dokumentacionit teknik të fermës bujqësore	-	-	36	-
13	M-17-1953-23	Inventarizimi i pasurisë së fermës	-	-	36	-
14	M-17-1954-23	Planifikimi i prodhimit në fermën bujqësore	-	-	36	-
15	M-14-1955-23	Prodhimi i produkteve organike bimore	-	-	36	-
16	M-14-1956-23	Mbrojtja e integruar në bujqësi	-	-	36	-
17	M-17-1957-23	Blerja dhe shitja e produkteve bujqësore	-	-	36	-
18	M-14-1958-23	Magazinimi, ruajtja dhe sigurimi i cilësisë së prodhimit bujqësor	-	-	36	-
19	M-17-1959-23	Marketingu në fermën bujqësore	-	-	-	48
20	M-17-1960-23	Menaxhimi i burimeve njerëzore në fermën bujqësore	-	-	-	33
21	M-17-1961-23	Veprime ekonomike në fermën bujqësore	-	-	-	48
22	M-17-1962-23	Veprime për detyrimet ndaj shtetit	-	-	-	33
23	M-26-1963-23	Digjitalizimi i fermave bujqësore	-	-	-	30
D		Module me zgjedhje të detyruara të praktikës profesionale (Gjithsej)	1 (36)	2 (72)	3 (108)	1 (32)
1	M-14-146-23	Kultivimi i luleve në mjedise të hapura	36	-	-	-
2	M-28-1844-23	Rritja e kribit të mëndafshit dhe kërmillit	36	-	-	-
3	M-14-1964-23	Kompostimi i mbetjeve organike	36	-	-	-
4	M-14-1865-23	Kultivimi i bimëve aromatike dhe mjekësore	36	-	-	-
5	M-14-1847-23	Shtimi me copa i kulturave bujqësore	-	36	-	-
6	M-14-150-23	Mbjellja e fidanëve të hardhisë	-	36	-	-
7	M-28-1965-23	Rritja dhe kujdesi për bletët	-	36	-	-
8	M-28-1849-23	Mbarështimi i shpendëve shtëpiake	-	36	-	-
9	M-14-1966-23	Përpunimi i bimëve aromatike dhe mjekësore	-	-	54	-

10	M-17-1967-23	Prezantimi në panairë i produkteve bujqësore	-	-	54	-
11	M-17-108-23	Sigurimi i informacioneve ekonomike në internet	-	-	54	-
12	M-17-1968-23	Hartimi i kontratave në fermën bujqësore	-	-	-	32
13	M-26-1969-23	Marketingu dixhital i fermave bujqësore	-	-	-	32
14	M-14-1970-23	Ambalazhimi dhe etiketimi i produkteve bujqësore	-	-	-	32
Gjithsej A+B+C+D			29/30	29/30	30/31	28/29
			1044/ 1080	1044/ 1080	1080/ 1116	896/ 928

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, 11 dhe 12 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (32 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 3 javë për provimet e Maturës shtetërore profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta

Kurrikuli i arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimit e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të Profilin “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të Profilit profesional “Agrobiznes”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4÷10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare. Në përfundim të klasës 13, nxënësi i arsimuar në Profilin profesional “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve përfundimtare të mëposhtme:

- a) Provimet e maturës shtetërore profesionale;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të njohurive të përgjithshme, njohurive të profesionit dhe të kompetencave profesionale të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që kryhen në fushën e Agrobiznesit.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në Profilin “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në Profilin mësimor “Agrobiznes”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, me Çertifikatën e aftësisimit profesional dhe me suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provimeve përfundimtare të nivelit IV i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 72 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë

Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë
Tema 20	Vizitë studimore në një sipërmarrje të suksesshme	4 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë

Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmartja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”.
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor.
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
Tema 10	Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

3. Lënda “Bazat e prodhimit bimor”(L-14-622-23). Kl. 10 – 72 orë dhe kl. 11 – 36 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e prodhimit bimor” kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e prodhimit bimor”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë objektin dhe rëndësinë e bazave të prodhimit bimor.

- Të përshkruajnë kuptimin, elementet përbërëse të ekosistemit, agroekosistemit dhe qarkullimin e lëndëve në ekosistem.
- Të përshkruajnë veprimtaritë e njeriut dhe ndikimet e tij mbi ekuilibrin e ekosistemit.
- Të përshkruajnë atmosferën, elementët përbërës të saj, dukuritë atmosferike, si dhe faktorët klimatik që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e bimëve.
- Të përcaktojnë zonat dhe nënzonat klimatike të vendit tonë, bimësinë përkatëse të tyre.
- Të përshkruajnë ndikimin e ndryshimeve klimatike te kulturat bujqësore, si dhe masat mbrojtëse ndaj ndryshimeve klimatike.
- Të shpjegojnë organizimin e qelizës, ndërtimin dhe morfologjinë bimës.
- Të përshkruajnë llojet e bimëve bujqësore, klasifikimin e shpërndarjen e tyre në botë,
- Të krahasojnë proceset fiziologjike të bimës (fotosintezës, transpirimit, dhe frymëmarrjes).
- Të analizojnë ndikimin e faktorëve biotik dhe abiotik në prodhimin bujqësor si dhe streset bimore.
- Të përshkruajnë kuptimin e konceptit “rritje” dhe “zhvillim” të bimëve, si dhe fazat përkatëse të tyre.
- Të shpjegojnë fazat e mbirjes të bimët një dhe dythelbore duke bërë krahasimin midis tyre.
- Të përshkruajnë mënyrat e shtimit me farë dhe vegjetativ të bimëve bujqësore, rolin e farishtes dhe fidanishteve sipas kulturave.
- Të përshkruajnë konceptin mbi tokën, tokën bujqësore, pjellorinë dhe prodhimtarinë e saj.
- Të tregojnë llojet e relievit dhe përshtatshmërinë e tyre për kultivimin e kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë tipin e tokës dhe karakteristikat e saj, profilin e tokës dhe përbërësit për çdo horizont.
- Të përshkruajnë përbërësit organikë dhe inorganikë të tokës, ndikimin e tyre në jetën e bimëve bujqësore.
- Të përshkruajnë tretësirën dhe reaksionin e tokës (Ph) si dhe rolin mbi jetën e bimëve bujqësore.
- Të përshkruajnë elementët kryesore që përcaktojnë cilësitë fizike dhe mekanike të tokës.
- Të përshkruajnë elementët kryesore ushqyes të tokës (mikro dhe makro elementët).
- Të interpretojnë fenomenin e erozionit të tokës, faktorët që e shkaktojnë dhe masat mbrojtëse.
- Të përshkruajnë faktorët që shkaktojnë përmytjet dhe ndikimet e tyre në jetën dhe zhvillimin e bimës.
- Të përshkruajnë parimet e përgjithshme, rolin e qarkullimit bujqësor, bashkëshoqërimi në ruajtjen e pjellorisë së tokës, si dhe skemat kryesore të qarkullimit bujqësor sipas zonave.
- Të përshkruajnë mënyrat e punimit të tokës sipas agroteknikës së kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë shërbimet kryesore të kulturave bujqësore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prodhimit bimor”, kl. 10 – 72 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për bazat e prodhimit bimor	2 orë
Tema 2	Kuptimi për ekosistemin dhe agroekosistemin	6 orë
Tema 3	Klima dhe elementët klimatik	6 orë
Tema 4	Bima, mjedisi dhe streset mjedisore	6 orë
Tema 5	Klasifikimi dhe morfologjia i bimëve	4 orë
Tema 6	Rritja dhe zhvillimi i bimëve	4 orë
Tema 7	Proceset fiziologjike të bimëve	4 orë
Tema 8	Shumëzimi i bimëve	8 orë
Tema 9	Toka bujqësore, profili dhe elementët përbërës të tokës	6 orë
Tema 10	Tretësira tokësore dhe reaksioni i tokës	6 orë

Tema 11	Cilësitë fizike dhe biologjike të tokës	6 orë
Tema 12	Erozioni i tokës dhe masat mbrojtëse	4 orë
Tema 13	Qarkullimi bujqësor dhe bashkëshoqërimi i bimëve bujqësore	6 orë
Tema 14	Agroteknologjia e kulturave bujqësore	4 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e prodhimit bimor” kl. 11-36 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e prodhimit bimor”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë llojet e plehrave organike dhe kimike si dhe rëndësinë e përdorimit të tyre.
- Të përshkruajnë llojet e plehërimeve të tokës dhe aplikimi i tyre sipas agroteknikës së kulturave bujqësore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e plehërimit të gjelbër sipas bimëve që përdoren.
- Të përshkruajnë elementët bazë të Praktikave të Mira Bujqëore (GAP).
- Të përshkruajnë mënyrat e përpunimit të mbetjeve organike.
- Të përshkruajnë konceptin, rëndësinë e njohjes, llojet e barërave të egra, si dhe dëmet që sjellin ato në prodhimin bujqësor.
- Të theksojnë rëndësinë e njohjes së sëmundjeve të bimëve bujqësore, konceptin “sëmundje”, sëmundjet infektive dhe parazitare, si dhe shkaktarët kryesorë të tyre.
- Të përshkruajnë simptomat kryesore të bimëve të prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- Të shpjegojnë teknikat e thjeshta për luftimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe mbrojtjen biologjike të kulturave bujqësore.
- Të përshkruajnë rëndësinë e përdorimit të teknologjive bashkëhorore (përfshirë TIK) për proceset e punës në bujqësi.
- Të përshkruajnë mënyrat e vjeljes, korrijës dhe mbledhje së produkteve bujqësore.
- Të përshkruajnë mënyrat e transportit dhe ambalazheve që përdoren për produktet bujqësore.
- Të përshkruajnë rëndësinë e etiketimit të produkteve sipas legjislacionit në fuqi.
- Të përshkruajnë rëndësinë e njohjes dhe zbatimit të parametrave për ruajtjen e produkteve bujqësore në transport dhe magazinë.
- Të përshkruajnë harmonizimin e ekonomisë së fermës me natyrën, proceset jetësore natyrore.
- Të shpjegojnë se çfarë është ekonomia e mbyllur.
- Të theksojnë rëndësinë dhe mënyrat e kombinimit të prodhimit bujqësor me prodhimin blegtoral.

– **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prodhimit bimor”, kl. 11 – 36 orë**

Tema 1	Llojet e plehrave dhe plehërimi i kulturave bujqësore	4 orë
Tema 2	Shërbimet në kulturat bujqësore	6 orë
Tema 3	Praktika të Mira Bujqësore	2 orë
Tema 4	Rëndësia e njohjes së barërave të egra dhe mënyrat e luftimit	4 orë
Tema 5	Njohuri mbi sëmundjet dhe dëmtuesit e kulturave bujqësore	8 orë
Tema 6	Mënyrat e vjeljes së kulturave bujqësore	4 orë
Tema 7	Proceset e pasvjeljes së kulturave bujqësore	4 orë
Tema 8	Njohuri mbi ekonominë e mbyllur	4 orë

4. Lënda “Kulturat bujqësore” (L-14-597-23). Kl. 10 – 108 orë dhe kl. 11 – 72 orë

• Synimet e lëndës “Kulturat bujqësore” kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kulturat bujqësore” klasa 10, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë rëndësinë e kultivimit të perimeve, vlerat ushqimore dhe kurative të tyre.
- të përshkruajnë kërkesat e perimeve për klimë, tokë dhe elementet ushqyese.
- të dallojnë perimet sipas grupimeve të tyre botanike dhe mënyrave të shtimit.
- të përshkruajnë llojet e shtretërve, zgjedhjen e vendit, mënyrat e ngrohjes, përgatitjen e dherishtes dhe të kubikëve.
- të përshkruajnë mënyren përgatitjes së fidanëve në shtretër, shërbimet,
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike të serrave dhe kriteret e zgjedhjes së vendit për ndërtimit të e tyre.
- të përshkruajnë serrat me ngrohje qendrore dhe diellore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes solanore.
- të shpjegojnë veçoritë botanike, biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyës;
- të perimeve të familjes solanore (domatja, speci, patlixhan).
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes solanore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes bostanore.
- të shpjegojnë veçoritë botanike, biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyës të perimeve të familjes bostanore (kungulli, kastravec, pjepri, shalqini etj).
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes bostanore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes zambakore.
- të shpjegojnë veçoritë botanike, biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyës të perimeve të familjes zambakore (qepa, preshi, hudhra dhe asparagu).
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes zambakore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes kryqore.
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyës të perimeve të familjes kryqore (lakra, lulelakra, brokoli, rrepa dhe rrilka).
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes kryqore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes kenopodiore (spinaqi, pazia, panxhari i kuq etj).
- të përshkruajnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyës të perimeve të familjes kenopodiore.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes kenopodiore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes kompozite (sallata, çikorja, angjinarja etj).
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyës të perimeve të familjes kompozitore.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes kompozitore.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes ombrellore (karota, majdanoz, kopër, selino, finok etj);
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe elemente ushqyës të perimeve të familjes ombrellore;
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes ombrellore;

- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike, vlerat ushqimore dhe kurative të perimeve të familjes bishtajore (fasulja bishtajë, bizelja, batha,) e mëllagore (bamja).
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të perimeve të familjes bishtajore.
- të përshkruajnë rëndësinë estetike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve zbukuruese;
- të përshkruajnë kërkesat e bimëve zbukuruese për klimë, tokë dhe element ushqyes;
- të përshkruajnë rëndësinë e shumimit me farë të bimëve zbukuruese, si dhe kushtet që ndikojnë në ruajtjen e farës;
- të përshkruajnë mënyrat e ndryshme të shumimit vegetativ;
- të rendisin bimët zbukuruese që kultivohen në fushë të hapur;
- të përshkruajnë bimët zbukuruese njëvjeçare më të përhapura të fushës;
- të përshkruajnë bimët zbukuruese dyvjeçare më të përhapura të fushës si: flokëza, lulja e dheneve, lulekëmbana, lulesheboja, lulja mos më harro, mëllaga e detit, vjollca etj;
- të përshkruajnë bimët zbukuruese shumëvjeçare më të përhapura të fushës si: aguliçëja, lulebora, margarita, lulevjeshta, lulezemra, lulekuqi, karafili, trëndafil;
- të përshkruajnë bimët zbukuruese më të përhapura të mjediseve të mbrojtura si: tulipani, gladiola, lulepatatja, shpatorja, zambaku, zymbyli, etj;
- të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe vlerat ekonomike dhe bujqësore të drithrave në ekonominë e një vendi.
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element të ushqyes të të lashtave (grurë, tërshërë, elb, thekër etj.).
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të të lashtave.
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të të vonave.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit misrit dhe orizit.
- të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe kultivarët e bishtajoreve për kokërr;
- të identifikojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë e elementë ushqyes të kulturave bishtajore për kokërr si.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të bimëve bishtajore.
- të përshkruajnë vlerat ekonomike dhe bujqësore të kulturave industriale.
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të bimëve industriale (pambukut, lulediellit, panxharsheqerit);
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të bimëve industriale.
- të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe vlerat ekonomike dhe mjekësore të bimëve aromatike dhe mjekësore.
- të shpjegojnë karakteristikat botanike, veçoritë biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe element të ushqyes të bimëve aromatike dhe mjekësore.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore.
- të theksojnë rëndësinë e kultivimit dhe dëmet shëndetësore të përdorimit të duhanit.
- të përshkruajnë karakteristikat botanike, cilësitë fiziko-kimike të gjetheve, veçoritë biologjike, kërkesat për klimë, tokë dhe element ushqyes të duhanit.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të duhanit.
- të përshkruajnë rëndësinë, përhapjen dhe klasifikimin e patates, karakteristikat botanike, biologjike dhe kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të patates.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të patates.
- të përshkruajnë rëndësinë ekonomike dhe bujqësore të prodhimit të kulturave foragjere si bazë ushqimore për blegtorinë.
- të shpjegojnë rëndësinë dhe veçoritë e jonxhës, si një ndër kulturat më të rëndësishme të livadheve.
- të përshkruajnë teknologjinë e kultivimit të jonxhës.

- të përshkruajnë rëndësinë, klasifikimin, veçoritë dhe bimësinë e kullotës.
- të përshkruajnë rëndësinë praktike dhe ekonomike të përdorimit të nënprodukteve të bujqësisë, blegtorisë dhe industrisë në ushqimin e kafshëve.
- Të përshkruajnë kërkesat kryesore të legjislacionit për prodhimin dhe cilësinë e produkteve bujqësore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e standardeve ndërkombëtare në cilësinë e prodhimeve bujqësore (ISO, Global GAP, HACCP etj.).
- Të përshkruajnë metodat, kriteret dhe teknikat që përdoren për vlerësimin e cilësisë të prodhimeve bujqësore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kulturat bujqësore”, kl. 10 – 108 orë**

Tema 2	Rëndësia e kultivimit të perimeve, vlerat ekonomike dhe përdorimi i tyre.	2 orë
Tema 3	Kërkesat e perimeve ndaj kushteve të mjedisit.	2 orë
Tema 4	Klasifikimi dhe shtimi i perimeve.	3 orë
Tema 5	Perimorja dhe kriteret e ngritjes së saj.	3 orë
Tema 6	Shtretërit dhe ngritja e tyre.	4 orë
Tema 7	Serrat dhe ngritja e tyre.	3 orë
Tema 8	Perimet e familjes solanore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	5 orë
Tema 9	Perimet e familjes bostanore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 10	Perimet e familjes zambakore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	3 orë
Tema 11	Perimet e familjes kryqore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 12	Perimet e familjes kenopodiore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	3 orë
Tema 13	Perimet e familjes bishtajore e mëllagore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	3 orë
Tema 14	Perimet e familjes kompozite dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 15	Perimet e familjes ombrellore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	3 orë
Tema 16	Rëndësia dhe roli i bimëve zbukuruese në mjedis.	4 orë
Tema 17	Kërkesat e bimëve zbukuruese për klimë, tokë dhe element ushqyes.	4 orë
Tema 18	Klasifikimi dhe shumimi i bimëve zbukuruese.	4 orë
Tema 19	Shtretërit dhe mjediset e mbrojtura për kultivimin e bimëve zbukuruese.	3 orë
Tema 20	Bimët zbukuruese që kultivohen në mjedis të hapur.	4 orë
Tema 21	Bimët zbukuruese që kultivohen në mjediset e mbrojtura.	3 orë
Tema 22	Bimët zbukuruese qepore, zhardhokore, rizomore dhe mishtore.	2 orë
Tema 23	Rëndësia, përhapja dhe klasifikimi i drithrave.	2 orë
Tema 24	Kulturat e të lashtave dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 25	Kulturat e të vonave dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 26	Kulturat bishtajoreve për kokërr dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 27	Kulturat industriale dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 28	Bimët aromatike dhe mjekësore dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	3 orë
Tema 29	Kultura e duhanit dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 30	Kultura e patates dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	4 orë
Tema 31	Prodhimi foragjer dhe teknologjia e kultivimit të tyre.	3 orë
Tema 32	Nënprodhimet e bujqësisë dhe industrisë si ushqim foragjer.	4 orë
Tema 33	Standardet e cilësisë së prodhimeve bujqësore.	2 orë

- **Synimet e lëndës “Kulturat bujqësore”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kulturat bujqësore” klasa 11, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të pemëtarisë në kushtet klimatiko-tokësore të vendit tonë;
- të grupojnë pemët frutore sipas organeve frutifikuese dhe zhvillimit të organeve vegetative;
- të përshkruajnë karakteristikat e përgjithshme të secilit grup të pemëve frutore;
- të përshkruajnë organet vegetative dhe frutorë të pemëve frutore, hardhisë, ullirit, agrumeve etj;
- të përshkruajnë karakteristikat morfologjike dhe funksionale të pjesëve vegetative;
- të përshkruajnë ndryshimet gjatë zhvillimit individual të një peme frutore të shtuar me fare dhe në mënyrë vegetative, duke iu referuar e tapave të rritjes;
- të shpjegojnë ciklin vjetor të rritjes dhe etapat e një cikli të plotë rritjes së drufrutorëve;
- të përshkruajnë fenofazat në periudhën e vegjetacionit e të qetësisë të pemëve frutore;
- të përshkruajnë prodhimin periodik faktorët që e favorizojnë si dhe rrugët për mënjanimin e tij;
- të përshkruajnë ndikimin e faktorët klimatikë dhe tokësorë mbi ecurinë e vegjetacionit dhe prodhimtarisë së pemëve frutore;
- të shpjegojnë ndikimin e dukurive ekstreme klimatike në prodhimin bujqësor;
- të përshkruajnë rajonizimin e kulturave drufrutore, ullirit, agrumeve në varësi të kushteve klimatiko-tokësore të vendit tonë;
- të përshkruajnë mënyrat e shtimit të pemëve frutore, ullirit, agrumeve, (me farë dhe vegetativ);
- të përshkruajnë mënyrat e shartimit si dhe mjetet kryesore të realizimit të shartimit;
- të rendisin kushtet klimatike dhe teknologjike për ngritjen e fidanishtes;
- të përshkruajnë organizimin e sektorit të shtimit dhe formimit të kulturave drufrutore;
- të përshkruajnë kriteret e përzgjedhjes së kulturës për nënshartesë dhe mbishartesë që marrin pjesë në shartim.
- të përshkruajnë hapat teknologjikë të kultivimit në drufrutorë;
- të përshkruajnë rëndësinë e krasitjes së drufrutorëve të rinj dhe drufrutorëve në prodhim;
- të shpjegojnë llojet dhe teknikat e krasitjeve në pemët frutore, ullinjve, agrumeve;
- të përshkruajnë karakteristikat kryesore morfo-biologjike të kulturave frutore më të rëndësishme farore, bërthamore, arore, manore, subtropikale dhe hardhisë;
- të shpjegojnë klasifikimin botanik dhe ekonomik të hardhisë dhe të bëjë dallimin midis tyre;
- të shpjegojnë mënyrat e shtimit tek hardhia (me farë, vegetative);
- të argumentojnë domosdoshmërinë e prodhimit të fidanëve antifilokserikë;
- të përshkruajnë parimet mbi të cilat mbështetet ngritja e vreshtit mëmë antifilokserik;
- të shpjegojnë etapat e teknologjisë së prodhimit të fidanëve të shartuar dhe shërbimet kryesore që bëhen në vreshtin mëmë antifilokserik;
- të shpjegojnë mënyrën e përgatitjes së tokës dhe shartesave për mbjellje;
- të rendisin mënyrat e mbjelljes të shartesave dhe shërbimet në shartesore;
- të analizojnë sistemet e krasitjes tek hardhia dhe fazat përkatëse;
- të argumentojnë rëndësinë e shërbimeve agroteknike në vreshtari;
- të përshkruajnë sëmundjet më të përhapura të hardhisë si dhe masat e kontrollit të tyre;
- të përshkruajnë dëmtuesit kryesorë të hardhisë, si dhe masat e kontrollit të tyre;
- të shpjegojnë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes, seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjes e magazinimit të produkteve;
- të dallojnë kultivarët e rrushit për tavolinë, verë të bardhë, kuqe, për tharje e përdorime të tjera;
- të përshkruajnë standardet e prodhimit të drufrutorëve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kulturat bujqësore” kl. 11 - 72 orë**

Tema 1	Rëndësia e kultivimit të pemëve frutore dhe vlerat ekonomike.	2 orë
Tema 2	Roli, rëndësia dhe klasifikimi i pemëve frutore.	2 orë
Tema 3	Organet e rritjes, të zhvillimit dhe të riprodhimit të pemëve frutore.	4 orë
Tema 4	Zhvillimi individual i pemëve frutore.	4 orë
Tema 5	Roli i faktorëve klimatiko-tokësorë në jetën e prodhimit të pemëve frutore	3 orë
Tema 6	Ndikimi i dukurive ekstreme klimatike në prodhimin bujqësor.	2 orë
Tema 7	Mënyrat e shtimit të pemëve frutore dhe faktorët që ndikojnë në shtimin e tyre	2 orë
Tema 8	Shtimi me farë i pemëve frutore.	2 orë
Tema 9	Shtimi vegetativ me copa i pemëve frutore.	4 orë
Tema 10	Shtimi me shartim dhe mënyrat e shtimit me shartim.	4 orë
Tema 11	Pajisjet, veglat dhe materialet e nevojshme për shartim.	2 orë
Tema 12	Krasitjet, llojet dhe teknikat e krasitjeve të pemëve frutore.	6 orë
Tema 13	Vlerësimi pomologjik i pemëve frutore.	6 orë
Tema 14	Roli, rëndësia dhe klasifikimi i hardhisë.	2 orë
Tema 15	Organet e rritjes, të zhvillimit dhe të riprodhimit të hardhisë.	4 orë
Tema 16	Mënyrat e shtimit të hardhisë me farë dhe vegetativ.	4 orë
Tema 17	Krijimi i vreshtave të rinj.	2 orë
Tema 18	Krasitja dhe formimi i hardhisë.	6 orë
Tema 19	Shërbimet agroteknike në vreshta.	3 orë
Tema 20	Vjelja dhe ruajtja e prodhimit.	3 orë
Tema 21	Kultivarët e rrushit.	3 orë
Tema 22	Standardet e prodhimit të drufrutorëve	2 orë

5. Lënda “Bazat e prodhimit blegtoral” (L-28-623-23) kl. 10 – 72 orë dhe kl.12 – 72 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e prodhimit blegtoral”, kl. 10.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e prodhimit blegtoral”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike të prodhimit blegtoral sipas llojeve të kafshëve;
- Të përshkruajnë rëndësinë rregullave higjieno-sanitare brenda dhe jashtë fermave blegtorale;
- Të përshkruajnë rëndësinë e higjienës së përgjithshme të tufës, vendqëndrimit dhe procedurat e pastrimit të tij;
- Të shpjegojnë rolin e ujit, higjienës së tij dhe të enëve, baseneve apo enëve të tjera ujë-pirëse.
- Të shpjegojnë parimet dhe kriteret për ngritjen e strehimeve të kafshëve;
- Të përshkruajnë rëndësinë e strehimit dhe të mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshës, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike;
- Të përshkruajnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve për fiksimin e kafshëve;
- Të përshkruajnë ndërtimin anatomik dhe funksionet e sistemeve dhe aparateve të organizmit të kafshës;
- Të shpjegojnë fazat e ciklit seksual, pjekurisë seksuale dhe jetës ekonomike;
- Të shpjegojnë kalendarin ndërzim–pjellje-tharje të tufës;
- Të përshkruajnë sjelljen (etologjinë) e kafshëve në situata të veçanta;
- Të përshkruajnë tipet dhe llojet e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve;
- Të shpjegojnë rëndësinë e zhvillimit të akuakulturës në vend;
- Të shpjegojnë teknikat e rritjes së peshkut dhe midhjes;

- Të përshkruajnë mënyrat e riprodhimit të peshqve dhe midhjeve;
- Të shpjegojnë mënyrat e ushqimit të peshqve dhe midhjeve;
- Të shpjegojnë rëndësinë e monitorimit të parametrave të ujit në mirë-rritjen e peshqve dhe midhjeve;
- Të përshkruajnë rëndësinë e zhvillimit të bletarisë;
- Të shpjegojnë teknikat e rritjes dhe kujdesit të bletëve;
- Të përshkruajnë mënyrat e shtimit të bletëve;
- Të rendisin disa nga përkujdesjet e veçanta që kërkojnë bletët në fazën e shumimit të tyre;
- Të përshkruajnë fazat e maturimit të mjaltit për përcaktimin e kohës së vjeljes së tij;
- Të dallojnë llojet (kategoritë) e ushqimeve, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajnë mënyrat e të ushqyerit të gjedhit;
- Të përshkruajnë mënyrat e të ushqyerit intensiv dhe ekstensiv të derrave;
- Të përshkruajnë mënyrat e të ushqyerit të njëthundrakëve (kuaj, gomerë, mushka);
- Të përshkruajnë mënyrat e të ushqyerit të të imtave;
- Të përshkruajnë mjeljen manuale dhe mekanike të kafshëve;
- Të përshkruajnë mënyrat e të ushqyerit të shpendëve për vezë dhe për mish;
- Të përshkruajnë mënyrat e të ushqyerit e të porsalindurve;
- Të shpjegojnë rëndësinë e përshtatjes së të ushqyerit në raste patologjie;
- Të listojne masat profilaktike dhe zooteknike;
- Të përshkruajnë legjislacionin e mirëqenies dhe të drejtës së kafshëve shtëpiake;
- Të përshkruajnë llojet e detergjentëve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar për enët, makinat mjelëse apo sipërfaqe të tjera dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajnë procedurat e pastrimit të impianteve mjelës, enëve apo pajisjeve të qumështit;
- Të përshkruajnë mënyrat e grumbullimit dhe ruajtjen e prodhimeve blegtorale.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prodhimit blegtoral”, kl.10 – 72 orë**

Tema 1	Rëndësia ekonomike e prodhimit blegtoral.	3 orë
Tema 2	Rëndësia rregullave higjieno-sanitare në ferma blegtorale.	3 orë
Tema 3	Higjiena e tufës, ujit, vendqëndrimit dhe procedurat e pastrimit të tij.	3 orë
Tema 4	Parimet dhe kriteret për ngritjen e strehimeve të kafshëve.	3 orë
Tema 5	Përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve për fiksimin e kafshëve	2 orë
Tema 6	Mikroklima në stallë.	3 orë
Tema 7	Ndërtimi anatomik dhe funksionet e sistemeve dhe aparateve të organizmit të kafshëve.	3 orë
Tema 8	Sjellja (etologjia) e kafshëve dhe cikli seksual i tyre	2 orë
Tema 9	Tipet dhe llojet e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve	3 orë
Tema 10	Rëndësia e zhvillimit të akuakulturës në vend.	3 orë
Tema 11	Ushqyerja dhe riprodhimi i peshqve dhe i midhjeve.	3 orë
Tema 12	Rëndësia e bletarisë dhe teknikat e rritjes e të kujdesit të bletëve.	3 orë
Tema 13	Shtimi dhe përkujdesjet e veçanta në fazën e shumimit të bletëve.	3 orë
Tema 14	Maturimi i mjaltit dhe fazat e maturimit të mjaltit.	3 orë
Tema 15	Llojet e ushqimeve, karakteristikat dhe përdorimi i tyre.	2 orë
Tema 16	Mënyrat e të ushqyerit të gjedhit.	3 orë
Tema 17	Ushqyerja të të imtave.	3 orë

Tema 18	Mjelja manual dhe mekanike e kafshëve	2 orë
Tema 19	Ushqyerja të njëthundrakëve.	3 orë
Tema 20	Ushqyerja intensive dhe ekstensive e derrave.	3 orë
Tema 21	Ushqyerja e shpendëve për vezë dhe për mish.	3 orë
Tema 22	Masat profilaktike dhe zooteknike.	3 orë
Tema 23	Legjislacioni i mirëqenies dhe i të drejtës së kafshëve shtëpiake.	3 orë
Tema 24	Llojet e detergjentët/ dezinfektantët dhe procedurat e pastrimit të impianteve mjelëse, enëve apo pajisjeve të qumështit.	2 orë
Tema 25	Mënyrat e grumbullimit dhe ruajtja e prodhimeve blegtorale.	3 orë
Tema 26	Standardet e prodhimit blegtoral	2 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e prodhimit blegtorale”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e prodhimit blegtoral”, kl.11, nxënësit duhet:

- Të theksojnë rëndësinë ekonomike të përpunimit së produkteve blegtorale;
- Të përshkruajnë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë;
- Të rendisin mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar;
- Të përshkruajnë përbërjen kimike dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e qumështit;
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe mënyrën e përpunimit të thjeshtë të qumështit, ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve dhe nënprodukteve të tij;
- Të shpjegojnë mënyrat e përpunimit të thjeshtë të mishit, ruajtjes e ambalazhimit të produkteve të përpunuara;
- Të përshkruajnë procesin e përpunimit, ambalazhimit dhe ruajtjes së peshkut për konsum.
- Të përshkruajnë kërkesat kryesore të legjislacionit për ushqimin që lidhet me cilësinë e prodhimeve blegtorale;
- Të shpjegojnë rëndësinë e standardeve ndërkombëtare në cilësinë e prodhimeve blegtorale (ISO, HACCP etj.);
- Të përshkruajnë metodologjitë për vlerësimin e cilësisë të proceseve prodhuese blegtorale;
- Të përshkruajnë metodat, kriteret dhe teknikat që përdoren për vlerësimin e cilësisë të prodhimeve blegtorale;
- Të shpjegojnë teknikat e ndarjes së produkteve blegtorale sipas cilësisë;
- Të shpjegojnë normat e përdorimit të shtuesve (aditivë ushqimorë) në të ushqyerit e kafshëve dhe të shpendëve;
- Të shpjegojnë kushtet teknike që duhen për ruajtjen e cilësisë së produkteve blegtorale;
- Të shpjegojnë standardet e cilësisë së ujit që përdoret në fermë sipas destinacionit të përdorimit;
- Të përshkruajnë sistemet dhe kriteret e vlerësimit të cilësisë të mjedisit të fermës;
- Të përshkruajnë llojet e ambalazheve të përshtatshme ekologjike dhe rëndësinë e përdorimit të tyre për sigurimin e cilësisë së produktit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prodhimit blegtoral”, kl.11 - 72 orë.**

Tema 1	Rëndësia ekonomike e përpunimit të produkteve blegtorale.	3 orë
Tema 2	Mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer.	5 orë
Tema 3	Mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar.	5 orë
Tema 4	Përbërja kimike dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e qumështit.	4 orë

Tema 5	Përpunimi i thjeshtë i qumështit, ambalazhimi dhe ruajtja produkteve dhe nënprodukteve të tij.	5 orë
Tema 6	Përpunimi i thjeshtë i mishit, ruajtja e ambalazhimi produkteve të përpunuara	5 orë
Tema 7	Përpunimi, ambalazhimi dhe ruajtja e peshkut për konsum.	4 orë
Tema 8	Kërkesat e legjislacionit për ushqimin me origjinë shtazore.	4 orë
Tema 9	Standardet ndërkombëtare të cilësisë së prodhimeve blegtorale.	5 orë
Tema 10	Vlerësimi i cilësisë së proceseve prodhuese blegtorale.	5 orë
Tema 11	Teknikat e ndarjes së produkteve blegtorale sipas cilësisë.	5 orë
Tema 12	Përdorimi lëndëve shtesë në ushqimet e kafshëve dhe të shpendëve.	4 orë
Tema 13	Kushtet teknike për ruajtjen e cilësisë së produkteve blegtorale.	4 orë
Tema 14	Standardet e cilësisë së ujit sipas destinacionit të përdorimit.	5 orë
Tema 15	Sistemet dhe kriteret e vlerësimit të cilësisë së mjedisit të fermës.	5 orë
Tema 16	Llojet e ambalazheve dhe rëndësia e përdorimit të tyre.	4 orë

6. Lënda “Teknologji bujqësore” (L-14-624-23). kl.10- 36 orë dhe kl.11- 72 orë

• Synimet e lëndës “ Teknologji bujqësore”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji bujqësore”, kl.10, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë e teknologjisë bujqësore për prodhimin bujqësor.
- Të bëjnë klasifikimin e traktorëve dhe makinave bujqësore
- Të përshkruajnë ndërtimin e përgjithshëm të traktorëve dhe makinave bujqësore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të mekanizmave dhe sistemeve të motorit me djegie të brendshme.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të transmesionit të traktorëve dhe makinave bujqësore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të shasisë dhe mekanizmave të komandimit të traktorëve dhe makinave bujqësore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të pajisjeve të punës të traktorëve dhe makinave bujqësore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të pajisjeve elektrike të traktorëve dhe makinave bujqësore.
- Të listojnë makinat bujqësore për punime bazë dhe plotësuese.
- Të shpjegojnë metodat e kultivimit të mekanizuar të tokës bujqësore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për punimin bazë të tokës bujqësore.
- Të listojnë makinat bujqësore të punimit sipërfaqësor të tokës bujqësore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për punimin sipërfaqësor të tokës bujqësore.
- Të listojnë makinat bujqësore mbjellëse.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për mbjelljen e kulturave të ndryshme.
- Të listojnë makinat bujqësore për shpërndarjen e plehrave.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave plehëruese.

- Të shpjegojnë procedurat e rregullimit të makinave për aplikimin e plehrave minerale dhe organike.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për aplikimin e amoniakut të lëngshëm dhe plehrave organike komplekse të lëngshme në tokë.
- Të listojnë makinat bujqësore për mbrojtjen kimike të bimëve
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për mbrojtjen kimike të bimëve.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për përgatitjen e lëngjeve të punës.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe parimin e funksionimit të spërkatësve, gjeneratorëve aerosol dhe pjalmuesve.
- Të listojnë makineritë bujqësore për korrjen e foragjereve
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për korrjen e barit.
- Të listojnë makineritë bujqësore për korrjen e silazhit dhe sanës.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për korrjen e silazhit dhe sanës.
- Të listojnë impiantet për prodhimin e ushqimit bimor dhe foragjer.
- Të shpjegojnë procesin tekniko- teknologjik të përgatitjes së silazhit.
- Të listojnë makineritë për tharjen artificiale të bimëve dhe të shpjegojë parimin e funksionimit dhe karakteristikat teknike.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të instalimeve dhe njësive për tharjen artificiale të bimëve.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të mjeteve dhe mekanizmave për korrjen e drithërave.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të autokombainave.
- Të listojnë pajisjet shtesë për korrësit e drithërave.
- Të listojnë makineritë për përpunimin e drithërave pas korrjes.
- Të shpjegojnë teknologjinë e pastrimit dhe seleksionimit të drithërave.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave për pastrimin dhe seleksionimin e drithërave.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të tharësve të drithit.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji bujqësore”, kl.10 - 36 orë**

Tema 1	Kuptimi dhe rëndësia e teknologjisë bujqësore për prodhimin bujqësor	1 orë
Tema 2	Klasifikimi dhe ndërtimi i përgjithshëm i traktorëve dhe makinave bujqësore	2 orë
Tema 3	Llojet, mekanizmat dhe sistemet e motorëve me djegie të brendëshme.	4 orë
Tema 4	Transmesionet e traktorëve dhe makinave bujqësore.	4 orë
Tema 5	Shasitë dhe mekanizmat të komandimit të traktorëve dhe makinave bujqësore.	2 orë
Tema 6	Sistemet e ecjes së traktorëve dhe makinave bujqësore.	1 orë
Tema 7	Pajisjet e punës të traktorëve dhe makinave bujqësore.	2 orë
Tema 8	Pajisjet elektrike të traktorëve dhe makinave bujqësore.	2 orë
Tema 9	Makinat bujqësore për punime bazë dhe plotësuese të tokës bujqësore.	3 orë
Tema 10	Makinat bujqësore të punimit sipërfaqësor të tokës bujqësore.	2 orë

Tema 11	Makinat bujqësore mbjellëse.	3 orë
Tema 12	Makinat bujqësore për shpërndarjen e plehrave.	2 orë
Tema 13	Makinat bujqësore për mbrojtjen e bimëve.	2 orë
Tema 14	Makinat bujqësore për korrjen e foragjereve, silazhit, lirit dhe sanës.	2 orë
Tema 15	Makinat bujqësore korrëse të drithrave.	2 orë
Tema 16	Makinat bujqësore për përpunimin dhe tharjen e drithërave pas korrjes.	2 orë

• **Synimet e lëndës “Teknologjia bujqësore”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologji bujqësore”, kl.11, nxënësit duhet:

- Të listojnë makinat mbledhëse të patateve, kulturave rrënjore dhe perimore.
- Të shpjegojnë qëllimin, ndërtimin dhe parimin e funksionimit të makinave mbledhëse të kulturave rrënjore dhe perimore.
- Të përshkruajnë makinat e ngarkimit dhe shkarkimit në bujqësi, llojet e tyre, pajisjet dhe parimin e funksionimit.
- Të listojnë sistemet, makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për seleksionim, ambalazhim dhe ruajtje e magazinim të produkteve të kulturave bimore.
- Të shpjegojnë qëllimin dhe organizimin e përgjithshëm të makinerive dhe pajisjeve për fermat blegtorale.
- Të shpjegojnë mekanizimin dhe automatizimin e furnizimit me ujë të objekteve blegtorale.
- Të përshkruajnë instalimet dhe pajisjet e furnizimit me ujë për kafshët dhe automatizimin e tyre.
- Të shpjegojnë rrjetet e presionit të ujit, tubacionet, pajisjet dhe kullat e ujit.
- Të shpjegojnë llojet dhe klasifikimin e tasave për pijet automatike, të palëvizshme, të lëvizshme, individuale, grupore dhe me ujë të nxehtë.
- Të shpjegojnë automatizimin e njërive të pompimit me kulla dhe rezervuarë uji.
- Të shpjegojnë mekanizimin dhe automatizimin e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit.
- Të listojnë makineritë dhe pajisjet për bluarjen dhe trajtimin termik të ushqimit.
- Të klasifikojnë makinat për përgatitjen e ushqimit.
- Të listojnë makinat për bluarjen e ushqimit me prerje.
- Të listojnë makinat për grimcimin e ushqimit.
- Të shpjegojnë mikserat për ushqim.
- Të përshkruajnë vendet e përgatitjes për ushqim.
- Të përshkruajnë vendet e përgatitjes së ushqimit të fermave të qumështit.
- Të shpjegojnë skemat teknologjike të vendeve për përgatitjen e përzierjeve të ushqimit të grimcuar të lirshme, të grimcuara (mono-foragjere).
- Të shpjegojnë teknologjitë për përgatitjen e ushqimit nga mbetjet ushqimore.
- Të përshkruajnë mekanizmat e shpërndarjes së ushqimit dhe rëndësinë e tyre.
- Të shpjegojnë skemat teknologjike për shpërndarjen e ushqimeve të ndryshme sipas mënyrave të mbajtjes së kafshëve.
- Të shpjegojnë ushqyesit e lëvizshëm për shpërndarjen e ushqimit të grimcuar të trashë dhe të gjelbër, të koncentruar dhe gjysmë të lëngshëm.
- Të shpjegojnë ushqyesit e palëvizshëm për lloje të ndryshme fermash.
- Të shpjegojnë instalimet hidraulike dhe pneumatike për transportin dhe shpërndarjen e ushqimit.
- Të shpjegojnë mekanizimin dhe automatizimin e mjeljes.
- Të shpjegojnë makinat e qumështit.

- Të shpjegojnë rëndësinë e mjeljes së lopëve me makinë, parakushtet për krijimin e makinave mjelëse dhe rregullat e mjeljes me makinë.
- Të klasifikojnë makinat mjelëse, pulsatorët dhe kolektorët e makinave të ndryshme mjelëse.
- Të shpjegojnë instalimet e mjeljes.
- Të shpjegojnë kompletin e instalimeve me vakuum.
- Të shpjegojnë pompat me vakuum, cilindrat, rregullatorët, matësit.
- Të klasifikojnë mjelëset dhe pajisjet e tyre.
- Të përshkruajnë mekanizimin dhe automatizimin e përpunimit parësor të qumështit.
- Të shpjegojnë qëllimin e përpunimit primar të qumështit.
- Të listojnë llojet e proceseve teknologjike të përpunimit parësor të qumështit, si dhe filtrave e pastruesve centrifugalë të qumështit.
- Të shpjegojnë ftohësit e qumështit, rezervuarët ftohës dhe njësitë e ftohjes.
- Të shpjegojnë pasterizimin e qumështit, pasterizuesit e pllakave dhe sterilizuesit e qumështit.
- Të listojnë pajisjet për përpunimin parësor të qumështit.
- Të shpjegojnë thelbin e homogjenizimit dhe ndarjes së qumështit.
- Të klasifikojnë homogjenizuesit dhe ndarësit e qumështit.
- Të shpjegojnë pajisjet për paketimin e qumështit dhe produkteve të tij.
- Të shpjegojnë mekanizimin dhe automatizimin e heqjes dhe përdorimit të plehut organik.
- Të klasifikojnë mjetet mekanike për heqjen e plehut organik nga ndërtesat e blegtorisë dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë metodat për heqjen e plehut të ngurtë, gjysmë të lëngshëm dhe të lëngshëm.
- Të shpjegojnë transportuesit kruese dhe instalimet kruese.
- Të klasifikojnë mjetet hidraulike për heqjen e plehut organik.
- Të shpjegojnë procesin e heqjes dhe transportimit të plehut organik me sisteme hidraulike.
- Të shpjegojnë ruajtjen e mekanizuar të plehut organik dhe të përpunimit të tij.
- Të listojnë mjetet teknike për transportimin e plehut organik nga ferma në depon e plehut organik.
- Të shpjegojnë mjetet teknike për shkarkimin e plehut organik nga depot e plehut organik. Të shpjegojnë mekanizimin e qethjes së deleve dhe rëndësinë e saj.
- Të përshkruajnë pajisjet për qethjen e deleve dhe për përpunimin parësor të leshit.
- Të përshkruajnë pajisjet qethëse elektrike.
- Të shpjegojnë kërkesat për mikroklimën e ndërtesave blegtorale.
- Të listojnë pajisjet e mikroklimës në ndërtesat blegtorale.
- Të shpjegojnë qëllimin, parimet dhe mënyrat e funksionimit të instalimeve të ventilimit dhe të ngrohjes elektrike.
- Të shpjegojnë sistemet e ndriçimit, burimet e dritës, si dhe pajisjet për rrezatim të kafshëve dhe ngrohjen lokale të kafshëve të reja.
- Të shpjegojnë rëndësinë e pajisjeve për të mbajtur një temperaturë, lagështi, shpejtësi të caktuar të ajrit dhe përbërjen e gazit në fermë.
- Të shpjegojnë skemat dhe pajisjet e ventilimit të ndërtesave blegtorale.
- Të përshkruajnë gjeneratorët e nxehtësisë dhe të ngrohësve elektrike për ngrohjen e ndërtesave blegtorale.
- Të shpjegojnë mekanizimin dhe automatizimin e integruar në fermat blegtorale.

▪ **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologji bujqësore”, kl.11- 72 orë**

Tema 1	Makinat bujqësore për mbledhjen e kulturave perimore rrënjore.	2 orë
Tema 2	Makinat bujqësore për mbledhjen e perimeve.	3 orë



Tema 3	Makinat e ngarkim – shkarkimit në bujqësi.	2 orë
Tema 4	Impiantet për prodhimin e ushqimit bimor, foragjer.	2 orë
Tema 5	Sistemet dhe pajisjet për seleksionimin, ambalazhimin, magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore.	3 orë
Tema 6	Vështrim i përgjithshëm i makinerive dhe pajisjeve për fermat blegtorale.	3 orë
Tema 7	Sistemet dhe pajisjet e furnizimit me ujë të objekteve blegtorale.	3 orë
Tema 8	Automatizimi dhe komandimi i instalimeve të furnizimit me ujë.	2 orë
Tema 9	Sistemet dhe mekanizmat e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit për blegtorinë.	5 orë
Tema 10	Mekanizimi dhe automatizimi i përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit për blegtorinë.	3 orë
Tema 11	Pajisjet për mjeljen e kafshëve të qumështit.	5 orë
Tema 12	Mekanizimi dhe automatizimi i mjeljes së kafshëve të qumështit.	3 orë
Tema 13	Pajisjet për përpunimin parësor të qumështit.	5 orë
Tema 14	Mekanizimi dhe automatizimi i përpunimit parësor të qumështit.	3 orë
Tema 15	Pajisjet për heqjen dhe përdorimin e plehut organik.	4 orë
Tema 16	Mekanizimi dhe automatizimi i heqjes dhe përdorimit të plehut organik.	3 orë
Tema 17	Pajisjet hidraulike për heqjen e plehut organik.	2 orë
Tema 18	Pajisjet për qethjen e bagëtive dhe përpunimin parësor të leshit.	5 orë
Tema 19	Mekanizimi dhe automatizimi i qethjes së bagëtive dhe përpunimit të leshit	3 orë
Tema 20	Sistemet dhe pajisjet e mikroklimës në ndërtesat blegtorale.	4 orë
Tema 21	Komandimi automatik i pajisjeve të mikroklimës në ndërtesat blegtorale	3 orë
Tema 22	Mekanizimi dhe automatizimi i integruar i fermave.	4 orë

7. Lënda “Përpunimi i prodhimeve bimore” (L-08-625-23). Kl. 11 – 36 orë

• Synimet e lëndës “Përpunimi i prodhimeve bimore”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përpunimi i prodhimeve bimore” klasa 11, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë rëndësinë ekonomike të përpunimit së prodhimeve bimore;
- të përshkruajnë teknologjinë e përpunimit së prodhimeve të drithërave;
- të përshkruajnë teknologjinë e përpunimit të perimeve;
- të përshkruajnë teknologjinë e përpunimit të bimëve vajore;
- të përshkruajnë mënyrat e ruajtjes e ambalazhimit të prodhimeve vajore të përpunuara;
- të përshkruajnë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë;
- të rendisin mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar;
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të reçelit të portokallit, qitros dhe nerënxës.
- të rendisin kriteret mbi të cilat bazohet prodhimi i marmalatës;
- të përshkruajnë prodhimin e marmalatës së mollës, dardhës dhe të fikut;
- të përshkruajnë teknologjinë e përpunimit të frutave të thata;
- të rendisin kriteret mbi të cilat bazohet prodhimi i lëngjeve;
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të lëngjeve të frytave të ndryshëm;
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të lëngjeve të frutave të ndryshëm.
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të verës së kuqe dhe të verës së bardhë;
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të rakisë;
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të prevedesë dhe lëngut të rrushit;

- të tregojnë rëndësinë ekonomike të ullirit dhe kriteret mbi të cilat bazohet prodhimi i vajit nga ulliri;
- të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të vajit të ullirit dhe të ullirit për kriposje;

● **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përpunimi i prodhimeve bimore” kl. 11 - 36 orë**

Tema 1	Rëndësia ekonomike e përpunimit të prodhimeve bimore.	2 orë
Tema 2	Përpunimi i prodhimit të drithërave.	3 orë
Tema 3	Përpunimi i perimeve.	3 orë
Tema 4	Rëndësia e përpunimit të bimëve vajore.	3 orë
Tema 5	Përpunimi i prodhimit foragjer.	3 orë
Tema 6	Përpunimi i frutave.	3 orë
Tema 7	Prodhimi i reçelit.	3 orë
Tema 8	Prodhimi i marmalatës.	3 orë
Tema 9	Prodhimi i lëngjeve të frutave.	3 orë
Tema 10	Përpunimi i frutave të thata.	3 orë
Tema 11	Prodhimi i rakisë, verës dhe lëngut të rrushit.	4 orë
Tema 12	Teknologjia e prodhimit të vajit të ullirit dhe të ullirit për kriposje.	3 orë

8. Lënda “Marketing bujqësor” (L-17-626-23), kl. 11 – 72 orë

● **Synimet e lëndës “Marketing bujqësor”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Marketing bujqësor”, kl.11, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin e marketingut, rolin e marketingut në shoqëri dhe zhvillimin ekonomik.
- të përshkruajnë funksionet e marketingut.
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë e mjedisit të marketingut dhe elementët e tij.
- të klasifikojnë dhe përshkruajnë elementët e mjedisit marketing.
- të theksojnë rolin e etikës dhe përgjegjësisë shoqërore ndaj mjedisit marketing.
- të përshkruajnë kuptimin e tregut dhe klasifikimin e tregjeve sipas kriterëve të ndryshme.
- të përshkruajnë rëndësinë dhe procedurën e segmentimit të tregut.
- të rendisin, duke përshkruar, kriteret dhe metodat kryesore të segmentizimit të tregut.
- të përshkruajnë karakteristikat dhe strategjitë e segmenteve të përzgjedhura.
- të interpretojnë fazat e evoluimit të tregut dhe të zgjerimit të tij.
- të përshkruajnë sjelljen e blerësve individualë.
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në sjelljen e tyre, të tillë si: faktorët demografikë, socialë dhe psikologjik.
- të specifikojnë etapat e procesit të marrjes së vendimit të blerësit individualë.
- të përshkruajnë sjelljen e konsumatorëve.
- të përshkruajnë kuptimin e produktit dhe karakteristikat e produkteve bujqësore.
- të klasifikojnë llojet e produkteve dhe dallimin midis të mirave dhe shërbimeve.
- të përshkruajnë produktet e konsumit dhe ato industrialë.
- të përshkruajnë elementët e marketingut mik.
- të përshkruajnë kuptimin, etapat dhe llojet e ciklit të jetës së produkteve.
- të përshkruajnë kuptimin e shpërndarjes, rolin dhe llojet e kanaleve të shpërndarjes.
- të përshkruajnë sistemet e shpërndarjes, kuptimin dhe llojet e shitjes me pakicë.

- të përshkruajnë funksionet e shitjes me shumicë dhe klasifikimin e shitësve me shumicë.
- të përshkruajnë kanalet e shpërndarjes së produkteve bujqësore.
- të përshkruajnë kuptimin, përmbajtjen e promocionit dhe proceset e komunikimit.
- të përshkruajnë procesin e planifikimit të promocionit (përcaktimi i objektivave, buxheti, përpunimi i promocionit miks).
- të shpjegojnë llojet e promovimit: reklama, publiciteti, shitje personale, promocioni i shitjeve etj.
- të përshkruajnë kuptimin e çmimit dhe politikat e caktimit të çmimeve.
- të përshkruajnë metodat dhe strategjitë e caktimit të çmimeve.
- të argumentojnë domosdoshmërinë e përdorimit të tik-ut në promovimin e fermave bujqësore.

• **Përmbajtja e përgjithshme e lëndës “Marketing bujqësor” kl.11 – 72 orë**

Tema 1	Kuptimi dhe rëndësia e marketingut	4 orë
Tema 2	Mjedisi marketing	3 orë
Tema 3	Segmentimi i tregut	6 orë
Tema 4	Sjellja konsumatore	3 orë
Tema 6	Produkti dhe llojet e tij	4 orë
Tema 7	Kuptimi i shpërndarjes, roli dhe llojet e kanaleve të shpërndarjes	4 orë
Tema 8	Promovimi i produkteve	4 orë
Tema 9	Çmimi dhe llogaritja e tij	4 orë
Tema 10	Marketingu dixhital i fermave bujqësore	4 orë

9. Lënda “Bazat e bujqësisë organike” (L-14-285-23), kl. 12 – 36 orë

• **Synimet e lëndës “Bazat e bujqësisë organike”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e bujqësisë organike”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë konceptin “Bujqësi organike” dhe rëndësinë e saj në ditët e sotme.
- Të theksojnë përfitimet ekonomike, shëndetësore dhe ekologjike nga bujqësia organike.
- Të përshkruajnë burimet natyrore të bujqësisë organike si: toka, uji, plehrat, klima etj., si dhe masat biologjike për ruajtjen e pjellorisë së tokës.
- Të përshkruajnë ndikimet e ujit dhe cilësisë së tij në bujqësinë organike.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e prodhimit organik duke përfshirë farën si material gjenetik, masat agroteknike të procesit biologjik nga fara te produkti, si dhe mbrojtjen e integruar në bujqësi.
- Të bëjnë dallimin e prodhimeve organike nga OMGJ.
- Të përshkruajnë produktet dhe lëndët që përdoren në bujqësinë organike dhe kriteret e përdorimit të tyre.
- Të përshkruajnë praktikën e mbarështrimit të kafshëve në ferma organike.
- Të përshkruajnë bazat e të ushqyerit organik, dhe ndikimet e tij në produktet blegtorale.
- Të përshkruajnë shëndetin natyral të kafshëve.
- Të përshkruajnë mënyrën e rritjes së gjallesave ujore (akuakulturën).
- Të përshkruajnë karakteristikat e bujqësisë tradicionale në vendin tonë, si dhe rrugët e transformimit të bujqësisë tradicionale në organike.

- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve pa tokë, mënyrat e kultivimit të bimëve pa tokë (hidroponia) dhe mënyrën e kultivimit të bimëve pa tokë dhe pa ujë (aeroponia).
- Të përshkruajnë rëndësinë e njohjes së legjislacionit të prodhimeve organike.
- Të theksojnë legjislacionin e certifikimit dhe të tregëtimit të produkteve organike.
- Të përshkruajnë mënyrat e tregëtimit të produkteve organike.
- Të theksojnë mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri, në format e agroturizmit, bujqësisë ekologjike dhe sportive.

• **Përmbajtjet e përgjithëshme të lëndës “Bazat e bujqësisë organike”, kl.12 - 36 orë**

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe përparësitë e bujqësisë organike	2 orë
Tema 2	Burimet natyrore dhe administrimi i tyre	3 orë
Tema 3	Agroteknologjia e prodhimit organik	4 orë
Tema 4	Larmia biologjike	2 orë
Tema 5	Produktet dhe lëndët që përdoren në bujqësinë organike	2 orë
Tema 6	Mbarështrimi organik i kafshëve. Akuakultura organike	3 orë
Tema 7	Kalimi nga bujqësia tradicionale në organike	3 orë
Tema 8	Kultivimi i bimëve pa tokë	3 orë
Tema 9	Legjislacioni dhe rregullat e certifikimit dhe tregëtimit të prodhimeve Organike.	2 orë
Tema 10	Standardet e bujqësisë organike	2 orë
Tema 11	Mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri	2 orë
Tema 12	Vizitë mësimore për njohjen konkrete të fermave organike në rajon	5 orë
Tema 13	Veprimtari praktike për rritjen e ndjeshmërisë dhe interesit të komunitetit rajonal për bujqësinë organike	3 orë

10. Lënda “Menaxhimi i fermave bujqësore” (L-17-627-23). kl. 12 – 108 orë dhe kl.13 – 96 orë

• **Synimet e lëndës “Menaxhimi i fermave bujqësore”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ Menaxhimi i fermave bujqësore ”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë karrierat e punësimeve në fermat bujqësore.
- të theksojnë përshkrimet e punës të personelit në fermat bujqësore.
- Të shpjegojnë procedurën për krijimin dhe organizimin e fermës bujqësore.
- të përshkruajnë strukturat e organizimit të njësisë së prodhimit bujqësor.
- të përshkruajnë ndarjen e detyrave dhe organizimin e punës në fermat bujqësore.
- të listojnë burimet e nevojshme për prodhimin e një produkti bujqësor.
- të shpjegojnë mënyrat e planifikimit për prodhimin e një produkti të caktuar.
- të përshkruajnë mënyrat e organizimit të proceseve të punës dhe monitorimit të saj.
- të shpjegojnë rëndësinë dhe format e bashkëpunimit me specialistë dhe aktorë të tjerë në zinxhirin e vlerës në bujqësi.
- të përshkruajnë faktorët që ndikojnë në performancën e fermës bujqësore.
- të përshkruajnë kuptimin e akteve normative, të tilla si ligje, vkm-të, urdhëresat dhe aktet e tjera ligjore për sektorin bujqësor.
- të argumentojnë domosdoshmërinë e mbajtjes parasysh të bazës ligjore në veprimtarinë e fermës bujqësore.
- të përshkruajnë marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fermat bujqësore.
- të përshkruajnë parimet, burimet, sistemet dhe subjektet e së drejtës.

- të përshkruajnë kuptimin e së drejtës agrare, raportin e saj me degët e tjera të së drejtës.
- të përshkruajnë kuptimin e pronës dhe elementët e së drejtës së pronësisë.
- të përshkruajnë mënyrat e bashkëpronësisë dhe shpronësimit.
- të përshkruajnë kuptimin e kontratës, llojet dhe veçoritë e kontratave në sektorin bujqësor.
- të argumentojnë domosdoshmërinë e mbajtjes parasysh të bazës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.
- të argumentojnë rëndësinë e komunikimit me etikë dhe profesionalizëm.
- të përshkruajnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- të argumentojnë domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Menaxhimi i fermave bujqësore” kl.12 – 108 orë**

Tema 1	Karrierat e punësimeve në fermat bujqësore	3 orë
Tema 2	Përshkrimet e punës të personelit në fermat bujqësore	3 orë
Tema 3	Krijimi dhe organizimin e fermës bujqësore	7 orë
Tema 4	Legjislacioni mbi organizimin dhe regjistrimin e fermave bujqësore	6 orë
Tema 5	Strukturat e organizimit të njësisë së prodhimit bujqësor	6 orë
Tema 6	Ndarja e detyrave dhe organizimi i punës në fermat bujqësore	6 orë
Tema 7	Planifikimi për prodhimin e produkteve bujqësore	9 orë
Tema 8	Rëndësia dhe format e bashkëpunimit me specialistë të sektorit bujqësor	5 orë
Tema 9	Faktorët që ndikojnë në performancën e fermës bujqësore	6 orë
Tema 10	Njohuri të përgjithshme mbi të drejtën dhe legjislacionin bujqësor	7 orë
Tema 11	Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fermat bujqësore	6 orë
Tema 12	Parimet, burimet, sistemet dhe subjektet e së drejtës	5 orë
Tema 13	Kuptimi i së drejtës agrare, raporti i saj me degët e tjera të së drejtës	7 orë
Tema 14	Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë	6 orë
Tema 15	Bashkëpronësia dhe shpronësimi	5 orë
Tema 16	Kontratat, llojet dhe veçoritë e kontratave në sektorin bujqësor	7 orë
Tema 17	Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve	4 orë
Tema 18	Rëndësia e komunikimit me etikë dhe profesionalizëm	4 orë
Tema 19	Rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit	6 orë

• **Synimet e lëndës “Menaxhimi i fermave bujqësore”, kl.13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Menaxhimi i fermave bujqësore” kl.13 nxënësi duhet:

- të përshkruajnë aspektet kryesore të drejtimit të fermave bujqësore.
- të përshkruajnë parimet e teorisë ekonomike të fermës bujqësore.
- të përcaktojnë objektivat afatshkurtëra dhe afatmesme të fermës.
- të përshkruajnë domosdoshmërinë dhe parimet e Profilit të fermave bujqësore.
- të përshkruajnë procesin e marrjes së vendimeve, funksionet dhe fushat e drejtimit të fermës bujqësore.
- të përshkruajnë marrëdhëniet e prodhimit, marrëdhëniet e kostove dhe ligjin e fitimeve në rënie.
- të përshkruajnë zgjedhjen e nivelit të përdorimit të faktorëve prodhues.
- të përshkruajnë domosdoshmërinë dhe strukturën e buxhetit të një aktiviteti bujqësor.
- të përshkruajnë procedurat e planifikimit të përgjithshëm të buxhetit të fermës, pjesët përbërëse dhe buxhetin e lëvizjes së parave.

- të përshkruajnë llojet e rriskut dhe qëndrimet e fermerit ndaj tyre.
- të listojnë hapat në marrjen e vendimeve me rrisk.
- të rendisin burimet e sigurimit të kapitalit në fermë dhe faktorët që ndikojnë në marrjen dhe dhënien e kredisë në bujqësi.
- të analizojnë investimet kapitale në bujqësi.
- të paraqesin format e ndryshme të administrimit të tokës: blerja e tokës, marrja dhe dhënia me qera e tokës bujqësore etj.
- të përshkruajnë fragmentizimin dhe treguesit që masin nivelin e fragmentizimit në fermë.
- të përshkruajnë burimet dhe efektivitetin e përdorimit të krahut të punës në fermë.
- të vlerësojnë llogaritjen e kostove të makinerive bujqësore.
- të rendisin burimet e sigurimit të makinerive bujqësore: blerja dhe marrja me qera.
- të pasqyrojnë lidhjet e madhësisë së fermës me kostot.
- të shpjegojnë domosdoshmërinë e rritjes së fermës në varësi të kushteve dhe burimeve financiare.
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe domosdoshmërinë e menaxhimit të fermave bujqësore;
- të përshkruajnë nivelet, funksionet, rolet dhe aftësitë menaxheriale;
- të shpjegojnë rolin e faktorëve të mjedisit menaxherial mbi suksesin e fermës bujqësore;
- të shpjegojnë mikromjedisin dhe makromjedisin e fermës bujqësore;
- të argumentojnë përgjegjësinë sociale të fermës bujqësore;
- të shpjegojnë rëndësinë dhe natyrën e planifikimit të fermës bujqësore;
- të përshkruajnë elementët e planifikimit bujqësor;
- të analizojnë procesin e planifikimit si funksion menaxherial;
- të shpjegojnë llojet e planeve sipas nivelit hierarkik, kohëzgjatjes dhe përdorimit;
- të shpjegojnë vendimmarrjen dhe kushtet në të cilat merren vendimet;
- të shpjegojnë hapat nëpër të cilat kalon procesi i vendimmarrjes;
- të shpjegojnë vendimmarrjen në grup dhe individuale, avantazhet dhe disavantazhet;
- të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë e organizimit si funksion menaxherial;
- të shpjegojnë kuptimin e udhëheqjes si funksion menaxherial;
- të bëjnë dallimin midis udhëheqjes dhe menaxhimit;
- të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë dhe llojet e kontrollit si funksion menaxherial;
- të shpjegojnë menaxhimin financiar dhe burimet e financimit në fermat bujqësore;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e menaxhimit të dokumentacionit financiar të fermave bujqësore;
- të shpjegojnë programet e menaxhimit të rriskut në bujqësi;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e sigurimit të fermave bujqësore;
- të përshkruajnë elementët e planit të biznesit;
- të argumentojnë domosdoshmërinë e hartimit të një plani efektiv biznesi;
- të hartojnë një plan biznesi në drejtimin përkatës profesional.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Menaxhimi i fermave bujqësore” kl.13 – 96 orë**

Tema 1	Aspekte kryesore të drejtimit të fermave bujqësore	5 orë
Tema 2	Parimet ekonomike të drejtimit të fermave bujqësore	5 orë
Tema 3	Teknikat e buxhetimit dhe të planifikimit bujqësor	6 orë
Tema 4	Profili i fermës dhe kushtet e rriskut dhe pasigurisë	4 orë
Tema 5	Sigurimi i kapitalit dhe kredisë në bujqësi	5 orë
Tema 6	Sigurimi dhe përdorimi i tokës	6 orë
Tema 7	Sigurimi dhe drejtimi i krahut të punës	5 orë

Tema 8	Sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore	6 orë
Tema 9	Madhësia e fermës dhe rritja e saj.	5 orë
Tema 10	Kuptimi dhe domosdoshmëria e menaxhimit të fermave bujqësore	5 orë
Tema 11	Menaxhimi dhe mjedisi menaxherial	5 orë
Tema 12	Planifikimi dhe marrja e vendimeve në fermat bujqësore	6 orë
Tema 13	Organizimi si funksion menaxherial i fermave bujqësore	6 orë
Tema 14	Udhëheqja dhe menaxhimi i fermave bujqësore	4 orë
Tema 15	Kontrolli si funksion menaxherial i fermave bujqësore	4 orë
Tema 16	Menaxhimi i burimeve njerëzore në fermat bujqësore	5 orë
Tema 17	Menaxhimi financiar i fermave bujqësore	5 orë
Tema 18	Menaxhimi i rriskut dhe sigurimi i fermave bujqësore	4 orë
Tema 19	Zhvillimi i një plani biznesi të fermës bujqësore	5 orë

11. Lënda “Njohuri ekonomike në bujqësi” (L-17-628-23), kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Njohuri ekonomike në bujqësi” kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri ekonomike në bujqësi”, klasa 12, nxënësit duhet të:

- të përshkruajnë detyrat, qëllimet, rolin dhe rëndësinë e kontabilitetit bujqësor.
- të shpjegojnë nocionin e inventarizimit, përmbajtjen dhe formën e inventarëve.
- të përshkruajnë procedurën e kryerjes së inventarizimit të fermës bujqësore.
- të shpjegojnë nocionet e pasurisë, kapitalit, aktiveve, pasiveve dhe bilancit.
- të evidentojnë dallimet ndërmjet pasurisë dhe kapitalit, aktiveve dhe pasiveve.
- të përshkruajnë veprimet ekonomike dhe ndikimet e tyre në vlerat e bilancit.
- të shpjegojnë kuptimin, përmbajtjen, llojet dhe qëllimin e mbajtjes së llogarive.
- të zbërthejnë bilancin në llogari aktive dhe pasive.
- të shpjegojnë përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të metodës së regjistrimit të dyfishtë në regjistrimin e veprimeve ekonomike.
- të kryejnë kontabilizime të thjeshta në llogaritë e gjendjeve.
- të shpjegojnë si kryhet mbyllja e një bilanci të thjeshtë përfundimtar.
- të shpjegojnë konceptet e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe ndikimin që ato kanë në kapitalin e fermës.
- të përshkruajnë funksionimin e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve.
- të kontabilizojnë të ardhura dhe shpenzime të ndryshme.
- të përshkruajnë kuptimin e rezultatit të ndërmarrjes dhe procedurën e llogaritjes së tij.
- të përmbledhin shpenzimet dhe të ardhurat në llogarinë e rezultatit dhe ta llogarisin atë.
- të kontabilizojnë blerjen dhe shitjen e mallrave përkatësisht, si shpenzim dhe të ardhura.
- të llogarisin detyrimin për TVSH-në.
- të kryejnë kontabilizimet për TVSH-në.
- të shpjegojnë mënyrën e hartimit të deklaratave tatimore të TVSH-së.
- të tregojnë ligjet kryesore që ekzistojnë në Shqipëri për kontabilitetin dhe qëllimin e hartimit të tyre.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri ekonomike në bujqësi”, kl. 12 – 72 orë

Tema 1	Rëndësia dhe detyrat e kontabilitetit bujqësor	6 orë
Tema 2	Inventarizimi, inventarët dhe llojet e inventarëve në fermat bujqësore	9 orë
Tema 3	Kuptimi dhe hartimi i një bilanci të thjeshtë bujqësor	9 orë

Tema 4	Pasqyrimi kronologjik i veprimeve ekonomike	10 orë
Tema 5	Analiza dhe funksionimi i llogarive	10 orë
Tema 6	Llogaritë e rezultatit	10 orë
Tema 7	Llogaritë e mallrave	9 orë
Tema 8	Tatimi mbi vlerën e shtuar	9 orë

- **Synimet e lëndës “Njohuri ekonomike në bujqësi”, kl. 13-64 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri ekonomike në bujqësi”, klasa 13, nxënësit duhet:

- të kontabilizojnë shpenzimet dhe të ardhurat e tjera që lidhen me blerjen e shitjen e mallrave, me rregullimin e marrëdhënieve me të tretët.
- të përshkruajnë klasifikimin e aktiveve të qëndrueshme.
- të përshkruajnë mënyrën e pjesëmarrjes së aktiveve afatgata në qarkullimin ekonomik të ndërmarrjes bujqësore.
- të shpjegojnë konceptin e amortizimit.
- të kontabilizojnë amortizimin e aktiveve afatgjata.
- të kontabilizojnë veprime të ndryshme me aktivet afatgjata.
- të përshkruajnë parimin e ndërtimit, përmbajtjen, rëndësinë e listës së llogarive.
- të interpretojnë bazën ligjore mbi planin e llogarive dhe standardet kontabël, si dhe të drejtat dhe detyrimet që i lindin ndërmarrjes prej tij.
- të tregojnë dispozitat ligjore në fushën e shpërblimeve, tatimeve mbi të ardhurat dhe detyrimeve të punëdhënësit e të punëmarrësit ndaj sigurimeve shoqërore.
- të llogarisin shpërblimet e punës dhe detyrimeve ligjore në lidhje me pagat
- të llogarisin detyrimin e ndërmarrjes ndaj sigurimeve shoqërore.
- të kontabilizojnë shpërblimet e llogaritura, ndalesat dhe pagesat e tyre përkatëse.
- të kontabilizojnë veprime të ndryshme arkëtimi dhe pagesash.
- të dallojnë pagesat nga shpenzimet dhe arkëtimet nga të ardhurat.
- të përshkruajnë rolin dhe rëndësinë e kontrollit të brendshëm.
- të mbajnë librat ndihmës në bazë të normativave ligjore përkatëse.
- të shpjegojnë domosdoshmërinë dhe veprimet që kryhen në fund të periudhës ushtrimore.
- të bëjnë vlerësimin e mbylljes vjetore dhe analiza të thjeshta të bilancit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri ekonomike në bujqësi”, kl. 13 – 64 orë**

Tema 1	Rregjistrime për blerjet dhe shitjet	6 orë
Tema 2	Rregjistrimet për skontot tregtare	4 orë
Tema 3	Aktivet e qëndrueshme dhe klasifikimi i tyre	5 orë
Tema 4	Rregjistrimet kontabël me aktivet afatgjata.	6 orë
Tema 5	Llogaria private	3 orë
Tema 6	Lista e llogarive dhe plani kontabël	3 orë
Tema 7	Regjistrimet kontabël në fushën e personelit	7 orë
Tema 8	Llogaritja dhe regjistrimi i detyrimeve ligjore në lidhje me pagat	6 orë
Tema 9	Qarkullimi i pagesave në fermat bujqësore	4 orë
Tema 10	Rregjistrimet kontabël të qarkullimit të pagesave	5 orë
Tema 11	Kontrolli i brendshëm dhe librat ndihmës	6 orë
Tema 12	Mbyllja vjetore	9 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Kultivimi i perimeve”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KULTIVIMI I PERIMEVE	M-14-1944-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për vlerësimin e tokës, përgatitjen e shtratit/farishtes dhe mbjelljen e farës në shtrat, përgatitjen e farishtes për prodhimin e fidanëve, si dhe kultivimin e perimeve në mjedise të mbrojtura dhe fushë të hapur.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi vlerëson tokën për kultivimin e perimeve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për vlerësimin e tokës;– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vlerësimin e tokës;– të përcaktojë vendin për hapjen e profilit të tokës;– të hapë profilin e tokës në thellësinë 30-40 cm;– të nxjerrë dheun pa dëmtuar gjallesat;– të numërojë gjallesat;– të vëzhgojë me kujdes numrin e gjallesave në tokë;– të vlerësojë gjallesat në tokë duke shënuar numrin e tyre dhe llojin e tyre (krimba, kërpudha);– të vendosë kasën e shkallëzuar pa dëmtuar rrënjët;– të vëzhgojë me kujdes gjatësinë, gjerësinë dhe trashësinë e rrënjëve;– të vlerësojë sipas parametrave sasinë e rrënjëve;– të vëshgojë ngjyrën, aromën dhe lagështinë e tokës sipas parametrave teknikë;– të hedhë kampionin e dheut nga një lartësi rreth 1 m;– të vëzhgojë shkrifërimin dhe porozitetin e tokës pas hedhjes së tokës sipas provës me gishta;– të vlerësojë cilësinë e tokës për kultivimin e kulturave bujqësore;– të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e kulturave bujqësore;

- të demonstrojnë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të tokës;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas vlerësimit të tokës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e kulturave bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përgatit tokën për ngritjen e shtratit dhe farishtes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës për ngritjen e shtratit dhe farishtes;
- të përgatitë sipas nevojës materialet ndihmëse për ndërtimin e shtratit dhe farishtes;
- të përcaktojë sipërfaqen e tokës për ndërtimin e shtratit dhe farishtes, sipas kriterëve të duhura;
- të transportojë me krah veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur;
- të shpërndajë me krah plehun organik dhe mineral sipas kriterëve;
- të hapë kanalën sipas kriterëve të elementëve gjatësi 8-20 m, gjerësi 1.4-1.5 m dhe thellësi 40-60 cm;
- të ndërtojë muret mbi tokë me gjatësi 8-20 m, lartësia e murit nga toka nga jugu 20 cm dhe 30 cm nga veriu, pjerrësi 10 cm;
- të mbushë shtratin me plehun e përgatitur sipas kriterëve të përcaktuara;
- të kryejë bashkimin e plehut dhe të dheut në raportin 2:1 duke e përzier mirë në një vend të pastër;
- të kryejë dezinfektimin e dherishtes me disa mënyra: formalinë, gur kali, vapam sipas kriterëve të përcaktuara të përdorimit të tyre;
- të përzgjedhë mbulesat e shtratit sipas materialeve që disponon (xham, plastmas, rrogos) dhe të mbulojë shtretërit;
- të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas instruksionit të përcaktuar;
- të shpërndajë plehun organik në sipërfaqen e tokës me krah në sasinë e duhur;
- të kryejë siç duhet punimin bazë të tokës me bel;
- të kryejë shkruftimin e shtratit të mbjelljes me vegla dore;
- të kryejë ngritjen e vllajës sipas parametrave teknik (gjatësia 10 m x 1.5 m gjerësi).
- të kryejë sheshimin dhe hedhjen e plehut të imët mbi vllajë sipas udhëzimeve;

- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas përgatitjes së tokës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm .
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për ngritjen e shtratit dhe farishtes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi mbjell farën në shtratin e nxehtë dhe farishte për prodhimin e fidanëve perimore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë farën sipas cilësisë së farës dhe llojit të kulturave perimore;
- të përcaktojë saktë sasinë e farës për mbjellje;
- të përcaktojë saktë kohën e mbjelljes së farës në shtratin e nxehtë dhe farishte;
- të trajtojë para mbjelljes farën në se është e nevojshme;
- të mbjellë farën në shtratin e nxehtë dhe farishte sipas teknikës më të përshtatshme me specifikat sipas kulturave perimore;
- të ujisë farishten me shoshë pas mbjelljes së farës;
- të kryejë mbulimin e shtratit të nxehtë dhe farishtes me materiale të ndryshme: politilen (PVC), rrogzë etj.;
- të pastrojë vendin pas mbjelljes së farës në shtratin e nxehtë dhe farishtes;
- të heqë barërat e këqija nëse ka;
- të kryejë rrallimet e bimëve duke respektuar distancat e duhura të mbjelljes;
- të kryejë plehërimin e lëngshëm duke mënjeluar djegien e gjetheve;
- të kryejë spërkatjen e fidanëve me lëng bordolez ose sipas udhëzimeve të specialistit;
- të kryejë kalitjen e fidanëve duke siguruar ajrimin shtratit/farishtes;
- realizon procesin e shkuljes dhe klasifikimit të fidanëve;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas mbjelljes së farës;
- të zbatojë me përpikëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së farës në shtratin e nxehtë

dhe farishtes për prodhimin e fidanëve perimore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi kultivon perime në ambiente të mbrojtura.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e tokës për mbjelljen e farave/fidanëve në ambiente të mbrojtura;
- të kryejë shpërndarjen e plehërave organike dhe kimike;
- të kryejë punimin bazë të tokës për mbjelljen e fidanëve perimore;
- të kryejë punimet plotësuese të tokës për mbjelljen e fidanëve;
- të kryejë piktimin në rreshta për mbjelljen e farës/fidanëve;
- të kryejë hapjen e brazdës për mbjelljen e farave/fidanëve;
- të realizojë mbjelljen e fidanëve sipas standardeve të mbjelljes;
- të kryejë ujitjen dhe shërbimet pas mbjelljes së farave/fidanëve;
- të kryejë prashitjen e bimëve pas mbirjes së farës ose pas zënjes së fidanëve;
- të kryejë plehërimin e lëngshëm duke mënjanuar djegien e gjetheve;
- të kryejë spërkatjen e fidanëve me lëng bordolez ose preparate të tjera për mbrojtjen nga sëmundje dhe dëmtuese sipas udhëzimeve të specialistit;
- të realizojë shërbime të vazhdueshme si: ajrimi i serrës, vendosja e sistemit mbështetës dhe lidhjet sipas kulturave deri në marrjen e prodhimit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kultivimit të perimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të perimeve në ambiente të mbrojtura;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Nxënësi kultivon perime në fushë të hapur.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e tokës për mbjelljen e fidanëve;
- të përcaktojë sipërfaqen e tokës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur;
- të transportojë veglat, pajisje dhe materialet në sipërfaqen e tokës së përcaktuar për tu mbjellë me perime;
- të kryejë shpërndarjen e plehërave organike dhe kimike;

- të kryejë përgatitjen e tokës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur;
- të kryejë piketimin e parcelës në rreshta për mbjelljen e fidanëve në fushë të hapur;
- të kryejë hapjen e brazdave për mbjelljen e farave/fidanëve;
- të realizojë mbjelljen e fidanëve sipas standardeve të mbjelljes;
- të kryejë ujitjen dhe shërbimet pas mbjelljes së fidanëve;
- të kryejë prashitjen e bimëve pas mbirjes së farave ose pas zënjes fidanëve;
- të kryejë plehërimin e lëngshëm duke mënjanuar djegien e gjetheve;
- të kryejë spërkatjen e fidanëve me lëng bordolez ose preparate të tjera për mbrojtjen nga sëmundje dhe dëmtuese sipas udhëzimeve të specialistit;
- të realizojë shërbime të vazhdueshme, si vendosja e sistemit mbështetës dhe lidhjet sipas kulturave deri në marrjen e prodhimit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes kultivimit të perimeve në fushë të hapur;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës (mjedise të mbrojtura ose fushë e hapur), në ekonomi bujqësore ku kultivohen perime me farë/fidanë.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përgatitjen shtratit, farishtes, dherishtes, përgatitjes së fidanit, mbjelljes dhe shërbimeve pas mbjelljes së farave/fidanëve në serra dhe fushë të hapur deri në marrjen e prodhimit perimor.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen punëve dhe shërbimeve të ndryshme për kultivimin e perimeve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur e më pas në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës e shërbimet e ndryshme që kryhen para dhe gjatë kultivimit të perimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës për kultivimin e perimeve.
- Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në kultivues të suksesshëm të perimeve si në mjedise të mbrojtura edhe në fushë të hapur.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Farëra perimesh të ndryshme.
 - Vegla të thjeshta dore.
 - Mjete mekanike traktor disk, frezë, makina mbjellëse.
 - Pompa spërkatëse.
 - Metër shirit, piketa, spango etj..
 - Plehra kimike, pesticide, dherishte, pleh organik etj..
 - Mjedis i mbrojtur dhe i hapur i përshtatshëm.
 - Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë etj..
-

2. Moduli “Kultivimi i bimëve të arave

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KULTIVIMI I BIMËVE TË ARAVE	M-14-1842-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për vlerësimin e tokës dhe për të zbatuar agroteknologjinë e kultivimit të bimëve të arave sipas standardeve të caktuara.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi vlerëson tokën për kultivimin e bimëve të arave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse;– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vlerësimin e tokës për kultivimin të kulturave bujqësore;– të hapë profilin e tokës në thellësinë 30-40 cm;– të nxjerrë dheun pa dëmtuar gjallesat;– të numërojë gjallesat;– të vëzhgojë me kujdes numrin e gjallesave në tokë;– të vlerësojë gjallesat në tokë duke shënuar numrin e tyre dhe llojin e tyre (krimba, kërpudha);– të vendosë kasën e shkallëzuar pa dëmtuar rrënjët;– të vëzhgojë me kujdes gjatësinë, gjerësinë dhe trashësinë e rrënjëve;– të vlerësojë sipas parametrave sasinë e rrënjëve;– të vëshgojë ngjyrën, aromën dhe lagështinë e tokës sipas parametrave teknikë;– të hedhë kampionin e dheut nga një lartësi rreth 1 m;– të vëzhgojë shkrifërimin dhe porozitetin e tokës pas hedhjes së tokës sipas provës me gishta;– të vlerësojë cilësinë e tokës për kultivimin e kulturave bujqësore;– të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e kulturave bujqësore;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e kulturave bujqësore;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të tokës për kultivimin e kulturave	

bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kultivon të lashtat.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur;
- të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;
- të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike dhe minerale;
- të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës;
- të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas cilësisë së kërkuar;
- të kryejë mbjelljen e farave sipas mënyrës, kohës dhe distancave të mbjelljes;
- të kryejë hapjen e vijave kulluese;
- të kryejë shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetaionit;
- të kryejë plehërimin me plehëra azotike;
- të kryejë heqjen e barëve të këqija;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kultivimit të të lashtave;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të të lashtave;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kultivon të vonat.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur ;
- të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;
- të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike dhe minerale;
- të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës;
- të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas cilësisë së kërkuar;
- të kryejë mbjelljen e farave sipas distancave të mbjelljes;
- të kryejë shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetaionit;
- të kryejë prashitjen dhe plehërimin e bimëve pas mbirjes;
- të kryejë ujitjen e bimëve sipas nevojave;

- të realizojë trajtimin e bimëve për sëmundje dhe dëmtues;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kultivimit të të vonave;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të të vonave;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kultivon bishtajore për kokërr.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur ;
- të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;
- të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike;
- të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës;
- të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas cilësisë së kërkuar;
- të kryejë mbjelljen e farave sipas distancave të mbjelljes;
- të kryejë shërbimet pas mbjelljes;
- të kryejë vendosjen e sistemit mbështetës për bimën;
- të kryejë shërbimet gjatë vegjetacionit.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastroj të kryejë dhe sistemojë vendin punës pas kultivimit të bishtajoreve për kokërr;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të bishtajoreve për kokërr;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kultivon bimë foragjere.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur;
- të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;
- të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike dhe minerale;
- të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës;

- të kryejë rulimin dhe nivelimin e tokës;
- të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas cilësisë së kërkuar;
- të kryejë mbjelljen e farave me shpërndarje ose makina mbjellëse sipas distancave të mbjelljes;
- të kryejë shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kultivimit të foragjereve;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të bimëve foragjere;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi kultivon bimë industriale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës;
- të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;
- të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike;
- të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës;
- të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas cilësisë së kërkuar;
- të përcaktojë kohën dhe mënyrat e mbjelljes;
- të kryejë mbjelljen e farave sipas distancave të mbjelljes;
- të kryejë shërbimet pas mbjelljes;
- të kryejë shërbimet gjatë vegetacionit;
- të kryejë korrjen dhe përpunimin e prodhimit bujqësor;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kultivimit të bimëve industriale;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të bimëve industriale;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës (mjedise të mbrojtura ose fushë e hapur), në ekonomi bujqësore ku kultivohen bimët e arave.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demostrimet konkrete për kultivimin e bimëve të arave.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e një sërë operacionesh pune për kultivimin e bimëve të

-
- arave, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas të pavarur.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës dhe rëndësinë e kryerjes së tyre.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve gjatë kultivimit të bimëve të arave.
 - Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në kultivues të suksesshëm të bimëve të arave në mënyrë që nxënësit të shohin dhe të praktikohen në proceset e punës së përgatitjes së tokës për mbjelljen e bimëve të arave.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Pleh stalle, plehra kimike.
 - Fara të ndryshme (të lashta, të vona, bishtajore, bimë industrial, foragjere).
 - Preparate dezinfektuese.
 - Uniforma e punës.
 - Vegla të thjeshta dhe të mekanizuara .
 - Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë etj.
 - Pompa spërkatëse.
-

3. Moduli “Kujdesi ndaj kafshëve bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KUJDESI NDAJ KAFSHËVE BUJQËSORE	M-28-1945-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të vlerësuar komplekset blegtorale, kushtet higjienike të tyre, statet fiziologjike të kafshëve, mbarështimin e specieve të ndryshme bujqësore, si dhe kushtet higjienike të prodhimit të produkteve me origjinë shtazore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi kontrollon standardet higjienike të kompleksit blegtoral. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kontrollit të standardeve higjienike të kompleksit blegtoral;– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kontrollin e standardeve higjienike të kompleksit blegtoral;– të kontrollojë kushtet higjieno-sanitare brenda dhe jashtë fermave blegtorale, sipas regullave të caktuara;– të kontrollojë higjienën e përgjithshme të tufës së kafshëve;– të vlerësojë parametrat higjienik dhe sasior të ujit në stallë;– të vlerësojë parametrat përbërës të stallës blegtorale;– të kontrollojë dhe vlerësojë parametrat e mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshës, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kontrollit të standardeve;– të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të standardeve higjienike të kompleksit blegtoral; <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje-përgjigje me gojë.	
	RN 2 Nxënësi kryen kontrollin e kafshëve.	

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës për shërbimet që do kryejë;
- të fiksojë kafshët e mëdha përpara manipulimit me to;
- të kontrollojë gjendjen shëndetësore të përgjithshme të kafshëve, të paktën njëherë në ditë;
- të identifikojë sjelljet e kafshëve dhe shenjat kryesore në këto sjellje si: sjellje seksuale, të mbrojtjes, të ikjes, sjelljes në situata stresuese;
- të zbatojë gjithë masat për parandalimin e luftimeve midis kafshëve;
- të lejojë trajtimin profilaktik të rregullt dhe ndërhyrjet mjekësore gjatë sëmundjeve apo dëmtimeve;
- të sigurojë lëvizjen ditore të kafshëve në mjedise të mbyllura dhe ose hapura.
- të kontrollojë kushtet e transportit të kafshëve për të respektuar kushtet e mirëqënies së tyre;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas kontrollit të kafshëve;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit të kafshëve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi kryen të ushqyerit e kafshëve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse personale;
- të përcaktojë radhën e duhur të punës për të ushqyerin e kafshës;
- të përzgjedhë llojin e ushqimeve sipas llojit dhe nevojave të kafshës;
- të kontrollojë në mënyrë periodike ushqimin dhe vendmagazinimin e ushqimit të blegtorisë;
- të identifikojë problemet që mund të kenë ushqimet e njoma, cilësia e silazhit dhe ushqimi peletuar;
- të kontrollojë koritat, pirëset automatike dhe rezervuarët e ujit;
- të kontrollojë cilësinë e ushqimeve gjatë procesit të ushqyerit të kafshës;
- të organizojë të ushqyerit për konsumim të barabartë ushqimi.
- të sigurojë furnizimin me ujë në sasi e cilësi në çdo kohë sipas programeve të parapërgatitura.
- të ushqejë kafshët (të trasha dhe/ose të imta), sipas kategorive që qëllimit të mbarështimit të tyre;
- të ushqejë shpendë sipas drejtimit të prodhimit;
- të ushqejë të porsalindur në lloje të ndryshme kafshës



bujqësore;

- të grumbullojë dhe manaxhojë jashtëqitjet e kafshëve duke respektuar mjedisin;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas ushqyerjes së kafshëve;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ushqyerjes së kafshëve bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme për kullotje pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizohen edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarëshojnë blegtorinë me regjim stallor.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të të ushqyerit të kafshëve.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me vlerat ushqyese të ushqimeve të fermës dhe përshtatshmërinë e tyre për lloje të ndryshme kafshësh.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin e parametrave higjienik të stallave, vlerësimin e parametrave fiziologjik dhe prodhues të kafshëve, i ushqen ato dhe mbledh prodhimet prej tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kujdesin ndaj kafshëve bujqësore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë blegtorale
 - Tokë kullosorë, punishte ushqimi.
 - Magazinë ushqimi, depo silazhi.
 - Tabela analitike të ushqimeve.
 - Tabela për nevojat ushqimorë të kafshëve.
 - Mjete të tjera vizuale.
 - Manuale praktike për të ushqyerin e kafshëve.
 - Katalogje ushqimesh etj.
-

4. Moduli “Përdorimi dhe shërbimi i makinave bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI DHE SHËRBIMI I MAKINAVE BUJQËSORE	M-36-1946-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për përgatitjen, përdorimin dhe shërbimin e makinave bujqësore për funksionim optimal, duke ndjekur specifikimet teknike, në kushte të sigurta dhe në përputhje me rregulloret aktuale në fuqi..	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimorë	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përgatitet për punime me makina bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pasqisjet mbrojtëse personale;– të përzgjedhë makinat bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra sipas punës që do të kryhet;– të interpretojë manualët dhe dokumentet teknike të makinave bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra të përzgjedhur;– të përcaktojë radhën e përgatitjes për punë. duke ndjekur specifikimet teknike;– të përcaktojë karakteristikat e lidhjeve për bashkim që do të zbatohen;– të përcaktojë procedurat për të arritur një lidhje bashkimi të sigurtë sipas specifikimeve të teknike;– të përcaktojë procedurat për montimin e boshtit të transmisionit për të arritur një bashkim të përshtatshëm të rritjes së fuqisë së makinës bujqësore dhe tërheqëse;– të përcaktojë procedurat për furnizimin me lëndë djegëse për të garantuar furnizimin me energji gjatë punës;– të përcaktojë procedurat për kontrollin e nivelit të lubrifikantëve, lëngut ftohës, presionit të gomave, për të bërë korrigjimet e nevojshme sipas manualit të udhëzimeve;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë ligjet dhe rregulloret aktuale në fuqi gjatë përzgjedhjes së makinave bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra sipas punës që do të kryhet– të zbatojë planin e parandalimit të rrezikut në punë;	

-
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjeve për punime me makina bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përdor makina bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë makinat bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra sipas punës që do të kryhet;
- të interpretojë manualat dhe dokumentet teknike të makinave bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra të përzgjedhur;
- të përcaktojë numrin e rrotullimeve të motorit bazuar në kërkesën për fuqi dhe ngarkesën e nevojshme për të reduktuar konsumin e lëndës djegëse;
- të ndez motorin e makinës bujqësore lëvizëse dhe tërheqëse duke u përshtatur me regjimin e zgjedhur;
- të përcaktojë pozicionin e funksionimit të ngritjes së fuqisë (normale ose ekonomike) dhe regjimin e normalizuar të punës, në bazë të kërkesës së pajisjes së drejtuar për të reduktuar konsumin e lëndës djegëse;
- të përcaktojë pozicionin e ngritësit hidraulik në bazë të parametrave të kushteve të punës (thellësia, sforcimi, i përzier, rrëshqitës, lundruet);
- të përdorë funksionet e tërheqjes (me katër rrota aktive, bllokimin e diferencialit, ndër të tjera), nëse ekzistojnë, për të ruajtur disa kushte pune dhe për të zvogëluar konsumin e lëndës djegëse;
- të përdorë funksionet e elektronikës në bord (tërheqja, menaxhi, drejtimi automatik, kontrolli i injektimit, përdorimi i GPS, ndër të tjera) për të lehtësuar punën dhe për të zvogëluar konsumin e lëndës djegëse;
- të përzgjedhë grupin e marsheve dhe marshin përpara, në varësi të llojit të punës që do të kryhet për të arritur shpejtësinë e dëshiruar;
- të përshtasë drejtimin e makinës me karakteristikat topografike dhe gjendjen e tokës;
- të realizojë një drejtimin efikas, duke respektuar treguesit e përcaktuar
- të monitorojë pajisjet treguese për të kontrolluar funksionimin, si dhe për të zbuluar ose korrigjuar keqfunksionimet e mundshme;
- të zbatojë ligjet dhe rregulloret aktuale në fuqi gjatë përdorimit të makinave bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra;
- të zbatojë planin e parandalimit të rrezikut në punë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të makinave bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi mirëmban makinat bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të makinave vetëlëvizëse dhe të tërhequra;
- të përgatitë makinat vetëlëvizëse dhe të tërhequra dhe vendin e punës për mirëmbajtje;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e mirëmbajtjes së makinerive;
- të realizojë mirëmbajtjen e planifikuar të makinave vetëlëvizëse dhe të tërhequra;
- të realizojë mirëmbajtjen e planifikuar në përputhje me udhëzimet e prodhuesit ose manualin e shërbimeve për t'i mbajtur ato në kushte funksionimi;
- të përcaktojë gjendjen funksionale të elementeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike të vetëlëvizëse dhe të tërhequra bujqësore;
- të korrigjojë, sipas rastit, përkeqësimin ose parregullitë e mundshme të zbuluara;
- të realizojë periodikisht gratatimin në pikat e grassatimit duke ndjekur manualin e shërbimeve;
- të realizojë periodikisht kontrollin e filtrave t'i pastrojë dhe/ose zëvendësojë nëse kërkohet;
- të kontrollojë sistemin elektrik, duke përfshirë ndriçimin dhe sinjalizimin, për të garantuar funksionimin e duhur;
- të zëvendësojë lëngjet punuese (lubrifikimit, frenave, ftohjes, etj.);
- të zëvendësojë tuba dhe gomina të dëmtuara;
- të regjistrojë në librin e kontrollit të dhënat e kërkuara për mirëmbajtjen e makinave bujqësore makinave vetëlëvizëse dhe të tërhequra për përdorim të mëvonshëm;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së makinave vetëlëvizëse dhe të tërhequra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përgatit pajisjet për punimet e tokës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë makinat bujqësore vetëlëvizëse dhe të tërhequra sipas punës që do të kryhet;
- të përzgjedhë pajisjet për punime bazë, plotësuese dhe sipërfaqësore të tokës në varësi të objektivit të punës, llojit dhe

kushteve të tokës;

- të zbatojë ligjet dhe rregulloret aktuale në fuqi gjatë mirëmbajtjes së makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra;
- të zbatojë planin e parandalimit të rrezikut në punë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra;

RN 5 Nxënësi përdor pajisjet për mbjellje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet për mbjellje, sipas punës që do të kryhet;
- të interpretojë manualët dhe dokumentet teknike të pajisjeve të përzgjedhura për mbjellje;
- të ngarkojë farat, bimët ose organet vegetative në pajisjet për mbjellje, duke zbatuar procedurat e nevojshme për të mos dëmtuar materialin bimor;
- të kontrollojë që funksionimi i pajisjes për mbjellje të kryhet në kushtet e vendosura për të optimizuar punën;
- të kontrollojë parametrat e funksionimit të pajisjes për mbjellje (thellësia e inkorporimit, mbulimi i tokës, etj.), për të arritur kushte të favorshme për mbirjen;
- të kontrollojë ndarjen ndërmjet dy kalimeve të njëpasnjëshme ose gjerësinë e punës së pajisjes dhe të rregullohet me shënuesit e kalimit (mekanikë ose shkumë);
- të sigurojë ndarjen midis linjave të mbjelljes dhe mbjelljes që të jetë identike në të gjithë fushën;
- të përshtasë shpejtësinë e motorit, marshin përpara dhe pozicioni i funksionimit të ngritjes së fuqisë, nëse ka, të makinës bujqësore ose tërheqëse, bazuar në pajisjet që do të përdoren dhe specifikën e funksionimit, për optimizimin e punës;
- të rregullojë presionin i ajrit në sistemin pneumatik, nëse është e aplikueshme, në përputhje me rekomandimet e prodhuesit për të arritur një dozë dhe/ose shpërndarje të mirë të farave, bimëve ose organeve vegetative;
- të rregullojë elementet prerëse të tokës në mbjellësit e drejtpërdrejtë të mbjelljes për të arritur thellësinë e duhur të mbjelljes, në varësi të llojit, gjendjes së tokës, si dhe nivelit të mbetjeve të saj;
- të kontrollojë operacionet e punës me pajisjet e mbjelljes me transmetim, linjë ose monogrimë dhe me pajisje mbjelljeje ose transplantimi që të kryhet në kushtet e përcaktuara për optimizimin e punës;
- të kontrollojë që ekzekutimi i punës së përgatitjes së

tokës i përgjigjet kushteve të pritshme (doza, thellësia, kondicionimi, etj.) duke bërë rregullimet e duhura nëse është e nevojshme;

- të plotësojë fletët e kontrollit dhe raportet e punës;
- të zbatojë ligjet dhe rregulloret aktuale në fuqi gjatë përdorimit të pajisjeve për mbjellje sipas punës që do të kryhet;
- të zbatojë planin e parandalimit të rrezikut në punë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të pajisjeve për mbjellje sipas punës që do të kryhet;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi mirëmban pajisje për mbjellje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të pajisjeve për mbjellje sipas punës që do të kryhet;
- të përgatitë pajisjet dhe vendin për mirëmbajtjen e pajisjeve për mbjellje;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për kryerjen e mirëmbajtjes së pajisjeve për mbjellje;
- të realizojë mirëmbajtjen e planifikuar në përputhje me udhëzimet e prodhuesit ose manualin e shërbimeve për t'i mbajtur ato në kushte funksionimi;
- të përcaktojë gjendjen funksionale të elementeve mekanike, hidraulike dhe pneumatike të pajisjes për mbjellje;
- të korrigjojë, sipas rastit, përkeqësimin ose parregullitë e mundshme të zbuluara;
- të përcaktojë gjendjen funksionale të elementeve strukturorë të pajisjes për mbjellje;
- të realizojë nëse është e nevojshme, shtrëngimet dhe rregullimet e nevojshme në elementet strukturorë të pajisjes për mbjellje;
- të realizojë grasatimin e elementeve strukturorë të pajisjes për mbjellje, duke ndjekur manualin e shërbimeve;
- të kontrollojë gjendjen funksionale të elementeve të sigurisë së pajisjes për mbjellje (siguresat mekanike, friksionet, etj.);
- të realizojë, nëse është e nevojshme, zëvendësimin ose rregullimin e elementeve të sigurisë së pajisjes për mbjellje
- të kontrollojë gjendjen funksionale të elementeve të dozimit (vrira të kalibruara, akset, rrotat e dozimit, cilindrat, disqet, grupet e ndryshimit etj.);
- të realizojë, nëse është e nevojshme rregullimin dhe rregjistrimin e tyre;

- të kontrollojë gjendjen funksionale të elementeve të shpërndarjes ose inkorporimit;
- të realizojë, nëse është e nevojshme rregullimin dhe rregjistrimin e tyre;
- të kontrollojë gjendjen funksionale të elementeve të çarjes së dheut në makinat e mbjelljes;
- të realizojë, nëse është e nevojshme, rregullimin, mprehjen ose zëvendësimin e tyre;
- të regjistrojë në librin e kontrollit të dhënat e kërkuara për mirëmbajtjen e pajisjeve për mbjellje për përdorim të mëvonshëm;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë ligjet dhe rregulloret aktuale në fuqi gjatë mirëmbajtjes së pajisjeve për mbjellje;
- të zbatojë planin e parandalimit të rrezikut në punë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së të pajisjeve për mbjellje;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në mjediset e parkut të makinerive bujqësore.
- Mësuesi/Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra.
 - Makina bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra.
 - Pajisjet për punime bazë, speciale dhe sipërfaqësore të tokës
 - Pajisjet për mbjellje
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për

përgatitjen dhe mirëmbajtjen e makinave bujqësore vetëlëvzëse dhe të tërhequra.

- Pajisje matëse.
 - Pjesë këmbimi dhe aksesore.
 - Lëngje dhe lubrifikantë të ndryshëm
 - Kompleti i veshjes.
 - Kataloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Prodhimi i fidanëve të kulturave drufrutore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I FIDANËVE TË KULTURAVE DRUFRUTORE	M-14-1843-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procese të thjeshta pune për mbjelljen e farave, prodhimin e filizave, kryerjen e shërbimeve, shartimit me kalema dhe me sythë të kulturave drufrutore.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	<p>Nxënësi mbjell farën e drufrutorëve në farishte. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse për mbjelljen e fares së drufrutarëve në farishte; – të sigurojë sasinë e farës për mbjellje; – të përzgjedhë materialet, veglat e pajisjet përkatëse për mbjelljen e farave në farishte; – të transpotojë veglat, pajisjet e materialet në vendin ku është farishtja; – të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për punimin e tokës; – të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës; – të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta; – të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike; – të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës; – të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas kriterëve të caktuara; – të përcaktojë kohën dhe mënyrat e mbjelljes; – të kryejë përgatitjen e vllajave 1.5m x 15m; – të kryejë mbjelljen e farave sipas distancave të mbjelljes; – të kryejë shërbimet pas mbirjes së farës deri në formimin e filizit me trashësi 9-12mm; – të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup; – të pastrojë dhe sistemojë vendin punës; – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së

-
- mjedisit gjatë mbjelljes së farave të drufrutoreve në farishte;
Instrumentet e vlerësimit:
– Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen shartimin me kalema të kulturave drufrutore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet, veglat e pajisjet përkatëse për shartim me kalem me çarje të plotë në kulturat drufrutore.
- të transportojë veglat, pajisjet e materialet në vendin që do të kryhet shartimi.
- të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për shartim.
- të përcaktojë llojin e kulturës dhe pemët që do të shartohen ,me kalem sipas kriterëve të përcaktuara.
- të përcaktojë llojin e kulturës dhe pemët ku do të merrën copat për mbishartesë sipas kriterëve të përcaktuara.
- të realizojë prerjen e copave të nënshartesës sipas hapave të punës.
- të realizojë prerjen e copave të mbishartesës sipas hapave të punës.
- të shtratifikojë në rërë të pastër dhe të ruajë copat në kushte optimale.
- të zbatojë teknikën e prerjeve për përgatitjen e nënshartesës.
- të zbatojë teknikën e prerjeve për përgatitjen e kalemave si mbishartesë.
- të realizojë vendosjen dhe puthitjen e mbishartesës me nënshartesën sipas procedurës.
- të kryejë lidhjen e vendit të shartimit sipas rregullit të duhur.
- të kryejë izolimin e vendit të shartimit me mastiç.
- të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme zënien e shartimit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shartimit me kalema në kulturat drufrutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen shartim me syth të kulturave drufrutore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet, veglat, pajisjet përkatëse për shartim me sytha;
- të transportojë veglat, pajisjet, materialet në vendin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë;
- të përcaktojë pemët që do të shartohen;
- të presë në formë "T"-je me gjatësi 3cm me 2cm nënshartesën;
- të përgatisë mbishartesë me një syth pak lëvore dhe ind drunor;
- të vendosë me kujdes, sythin te nënshartesa;
- të puthisë, siç duhet, nënshartesa me mbishartesës;
- të lidhë me kujdes, pjesëtarët e shartimit;
- të izolojë vendin e shartimit me mastiç apo material tjetër, sipas procedurës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë shartimit me syth në kulturat drufrutore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen shërbime në shartesore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet, veglat, pajisjet përkatëse për kryerjen e shërbimeve;
- të transportojë veglat, pajisjet, materialet në vendin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë;
- të kryejë pastrimin e nënshartesës nga thithakët;
- të kryejë pastrimin e mbishartesës nga lastarët e tepërt;
- të kryejë punimin e tokës në shartesore;
- të kryejë plehërimin e shartesorës;
- të kryejë ujitjen e tokës;
- të kryejë krasitjet e fidanëve të shartuar;
- të kryejë spërkatjet e fidanëve të shartuar ;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve ndaj fidanëve të shartuar

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen klasifikimin, etiketimin dhe ruajtjen e fidanëve të shartuar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet, veglat, pajisjet përkatëse për kryerjen e shërbimeve;
- të transportojë veglat, pajisjet, materialet në vendin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë;
- të kryejë shkulljen e fidanëve sipas standardit;
- të kryejë klasifikimin e fidanëve sipas standardit;
- të kryejë vendosjen e etiketave sipas kategorive;
- të transportojë dhe të ruajnë fidanët sipas standardit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë klasifikimit, etiketimit dhe ruajtjes së fidanëve të shartuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në pemëtore pranë saj.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të përgatitjes së tokës për mbjelljen e farave për prodhimin e filizave, shartimin me kalem me sytha, shartesore si dhe klasifikimin, etiketimin e fidanëve të shartuar në kulturat drufrutore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të përgatitjes së përgatitjes së tokës për mbjelljen e farave për prodhimin e filizave, shartimin me kalem me sytha, shartesore si dhe klasifikimin, etiketimin e fidanëve të shartuar në kulturat drufrutore, fillimisht në mënyrë të mbiqëkyrur dhe më pas të pavarur.
- Mësuesi/Instruktori duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për prodhimin e fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përgatitjes së tokës, shartimit, klasifikimit, etiketimit dhe ruajtjes së fidanëve të shartuar në kulturat drufrutore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Bel, Shatë, Krehër, Fara
 - Thika shartimi,
 - Nënshartesa, kalema, sytha,
 - Gërshërë,
 - Rrafje,
 - Mastic shartimi.
 - Piketa, etiketa,
 - Plehra kimike,
 - Plehra organike,
 - Pesticide, Rërë
-

6. Moduli “Punime për ujitjen, kullimin dhe sistemimin e tokave”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME PËR UJITJEN, KULLIMIN DHE SISTEMIMIN E TOKAVE	M-14-1947-23
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer punime me mjete të thjeshta ose motorike për ujitjen, kullimin dhe sistemimin e tokave sipas standardeve.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN1 Nxënësi hap vijat kulluese me mjete të thjeshta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të veshë uniformën e duhur të punës; – të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet për hapjen e vijave kulluese; – të vlerësojë kushtet e lagështisë së tokës; – të lexojë kartën teknologjike të kulturës bujqësore; – të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjeteve për hapjen e vijave kulluese; – të përcaktojë mënyrën optimale, skemën e hapjes së vijave kulluese dhe regjimin përkatës të punës; – të realizojë procesin e hapjes së vijave kulluese, sipas mënyrës, skemës dhe regjimit përkatës të punës; – të tregojë kujdes të vazhdueshëm për mjetin për hapjen e vijave kulluese; – të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të mjeteve për hapjen e vijave kulluese; – të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup; – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të plugjeve për hapjen e vijave kulluese; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi përdor sistemet e thjeshta të ujitjes në formë shiu. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të veshë uniformën e duhur të punës; – të përzgjedhë mjetin dhe pajisjet për vënien në punë të pompës; 	

- të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjeteve dhe të pompës;
- të transportojë impiantin e ujitjes me shihedhje (tuba, bashkuese, sprucatore etj) në vendin ku do të kryhet ujitja;
- të lexojë skemën e vendosjes së impiantit shihedhës dhe parametrat që duhen respektuar gjatë ujitjes me shihedhje;
- të montojë impiantin shihedhës në përputhje me skemën e përcaktuar të funksionimit për sigurimin e një regjimi optimal të punës;
- të realizojë procesin e ujitjes me shihedhje sipas mënyrës, skemës dhe regjimit përkatës të punës;
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të funksionimit tëshihedhësave/ sprucatorëve për bllokime, rrjedhje tëndryshme apo mosfunksionime të mundëshme;
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së ujitjes dhe sigurimin e uniformitetit;
- të ç'montojë impiantin pas përfundimit të ujitjes në sipërfaqen e përcaktuar;
- të transportojë impiantin shihedhës në parkim apo në sektor tjetër të ujitjes;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të impiantit shihedhës;
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pjesëve të impiantit, në raste të parregullsive të mundshme;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes sëmjedisit gjatë përdorimit të sistemit të thjeshtë të ujitjes në formë shiu;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përdor sistemet e thjeshta e ujitjes me pika/ e lokalizuar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të përzgjedhë mjetin dhe pajisjet për vënien në punë të pompës;
- të kontrollojë paraprakisht gjendjen teknike të mjeteve dhe të pompës;
- të përcaktojë mënyrën e sigurimit të presionit të nevojshëm për funksionimin e sistemit të ujitjes me pika;
- të vendos në punë pompën;
- të transportojë impiantin e ujitjes me pika (tuba, lidhëse, pikatore, etj.) në vendin ku do të kryhet ujitja;
- të lexojë skemën e vendosjes së impiantit të ujitjes me pika dhe parametrat që duhen respektuar gjatë ujitjes;
- të montojë impiantin e ujitjes me pika në përputhje me skemën e përcaktuar të funksionimit për sigurimin e një regjimi optimal të punës;

- të realizojë procesin e ujitjes me pika sipas mënyrës, skemës dhe parametrave përkatës të punës;
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të funksionimit të pikatoreve për bllokime, çarje, rrjedhje apo dëmtime të mundëshme;
- të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së ujitjes;
- të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes së përditshme të impiantit të ujitjes me pika;
- të kryejë riparime të lehta dhe/ose zëvendësime të pikatoreve prej bllokimeve apo dëmtimeve gjatë punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të impiantit në ujitjen me pika;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësit kryejnë sistemimin sipërfaqësor në formë kurrizi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;
- të përzgjedhë mjetin dhe pajisjet për sistemimin në formë kurrizi të tokës;
- të përcaktojnë koeficientin e shkrifërimit sipas llojit të tokës;
- të përcaktojnë gjerësinë dhe pjerrësinë e lehut sipas parametrave teknikë për kullim dhe ujitje më të mirë dhe llojit të tokave;
- të ndajnë ngastrën në lehe duke respektuar përmasat e ngastrës;
- të hapin vijat kulluese paralele me K₂K në largësinë 20-30 m;
- të përcaktojnë ndryshimin e thellësisë së punës për të dhënë formën e kurrizit sipas parametrave teknikë në varësitë llojit të tokës;
- të kryejnë procesin e ndërtimit të kurrizit sipas parametrave teknikë në varësi të llojit të tokës;
- të kontrollojnë cilësinë e ndërtimit të kurrizit për plotësimin e kushteve teknike;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit sipërfaqësor në formë kurrizi;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësit kryejnë punime për sistemimin e rrafshët të tokës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës;

- të përzgjedhë mjetin dhe pajisjet për sistemimin e rrafshët të tokës;
- të përcaktojnë ngastrën ku do të kryhet sistemimi i rrafshët, sipas tipit të tokës;
- të ndajnë ngastrën në lehe sipas përmasave të përcaktuara;
- të kryejnë procesin e sistemimit të rrafshët të tokës me mjete të thjeshta duke zbatuar skemën sipas rregullave për ruajtjen e thellësisë së njëtrajtshme, gjerësinë e njëjtë të punimit;
- të kontrollojnë cilësinë për plotësimin e parametrave teknikë;
- të demonstrojnë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë sistemimit të rrafshët të tokës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose fermë bujqësore rajonale.
- Mësuesi apo instruktori duhet të përpiqet që rezultatet mësimore të këtij moduli të realizohen në kushtet konkrete të fermës, duke u dhënë mundësi nxënësve të grumbullojnë të gjitha të dhënat që duhet për të analizuar kushtet dhe mundësitë për kryerjen e punimeve për ujitjen, kullimit dhe sistemimin e tokave.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e demonstrime konkrete për kryerjen e punimeve për ujitjen, kullimit dhe sistemimin.
- Nxënësit duhet të praktikohen në veprimtari konkrete pune për të përdorur dhe mirëmbajtur makinat e ujitjes dhe kullimit të tokave, si dhe për të kryer riparime të lehta nëto, fillimisht nën mbikqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për kryerjen e punimeve për ujitjen, kullimit dhe sistemimin.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e rezultateve mësimore të planifikuara në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës ose fermë bujqësore rajonale.
 - Mjete motorike bujqësore.
 - Makina dhe impiante të ujitjes dhe kullimit të tokave.
 - Materiale kancelarie.
 - Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme për kryerjen e punimeve për ujitjen, kullimit dhe sistemimin e tokave.
 - Udhëzues, katalogë, rregullore etj.
-

7. Moduli “Kujdesi gjatë riprodhimit të kafshëve bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KUJDESI GJATË RIPRODHIMIT TË KAFSHËVE BUJQËSORE	M-28-520-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për tu njohur me gjendjen për çiftëzim në tufë, për tu kujdesur për tufën gjatë mbarsmërisë, si dhe për tu kujdesur për tufën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurin.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN1 Nxënësi njihet me gjendjen për çiftëzim në tufë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të veshë uniformën e duhur të punës; – të përzgjedhë kafshët që do të çiftëzohen në tufë sipas kategorive të tyre; – të përcaktojë saktë shenjat e gjendjes së afshit për një lloj kafshe; – të deklarojë saktë frekuencën dhe kohëzgjatjen e gjendjes së afshit për lloje të ndryshme kafshësh; – të kujdeset për tufën gjatë procesit të çiftëzimit; – të përcaktojë moshën dhe peshën për kafshët që do të futen në ndërzim për herë të parë; – të përzgjedhë metodën për insiminimin (ndërzimin) e kafshëve në tufë; – të zbatojë saktë kriteret që nevojiten për çiftëzimin e kafshëve; – të kontrollojë ecurinë e procesit të insiminimit dhe të mbajë saktë shënimet përkatëse. – të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup; – të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë njohjes së gjendjes për çiftëzim në tufë; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vëzhgim me listë kontrolli. 	

RN 2 Nxënësi kujdeset për tufën gjatë mbarsmërisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë ambjentin për mbajtjen e kafshëve barse sipas fazave fiziologjike të mbarsmërisë.
- të përcaktojë kohëzgjatjen e mbarsmërisë në kafshët e ndryshme të tufës.
- të trajtojë kafshën barse në periudha të ndryshme, si laktacion, tharje deri në pjellje.
- të zbatojë masat veterinarë dhe higjienike në kafshët barse.
- të kryejë lëvizjen e kafshëve barse në stalla të veçanta sipas gjëndjes fiziologjike.
- të ushqejë kafshët barse në periudha të ndryshme të mbarsmërisë me racione të caktuara ushqimore.
- të kontrollojë gjëndjen e kafshëve në muajin e fundit të mbarsmërisë.
- të bëjë regjistrimin e operacioneve të punës të kryera në stallë.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në stalla.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesjes për tufën gjatë mbarsmërisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kujdeset për tufën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;
- të përcaktojë nëpërmjet regjistrave datën e pjelljes së kafshës;
- të dallojë shenjat e afrimit të pjelljes;
- të kontrollojë gjëndjen e gjirit në muajin e fundit të mbarsmërisë në kafshë;
- të përcaktojë saktë një lindje normale dhe jo normale;
- të përcaktojë saktë peshën e të porsalindurve;
- të trajtojë nënën pas procesit të pjelljes nga ana higjienike dhe ushqimore;
- të trajtojë të porsalindurit nga ana higjienike dhe ushqimore;
- të zbatojë masat e ndihmës dhe të kujdesit për të porsalindurin;
- të realizojë dhënien e kulloshtrës së parë, në sasinë dhe cilësi e duhur;
- të kryejë trajtimin e të porsalindurve në mjedise të veçanta si bokse, në profilaktor, në stalla etj.
- të mbajë të dhënave dhe të regjistrojë operacionet e punës në fermën e kafshëve bujqësore.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për kujdesin e tufës gjatë pjelljes dhe për të porsalindurve.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inicativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesjes për tufën gjatë pjelljes dhe për të porsalindurit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në territorin e fermës së shkollës dhe territore të tjera të përshtatshme pranë shkollës.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë edhe vizita në ferma blegtorale të cilat mbarështojnë blegtorinë me regjim stallor dhe kullosor.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të riprodhimit (çiftëzimit) të kafshëve me metoda të ndryshme me kafshë të gjalla për të identifikuar gjendjen e afshit si dhe asistimi në procesin e pjelljes së kafshëve në bazën prodhuese të shkollës dhe ekonomi blegtorale.
- Instruktori duhet të përdorë tekste standarde dhe manuale që kanë të bëjnë me metodat e riprodhimit të kafshëve të fermës dhe përshtatshmëria për lloje të ndryshme kafshësh.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në fermën e shkollës dhe ambiente të tjera të përshtatshme për trajtimin e kafshëve në periudha të ndryshme fiziologjike, me të porsalindurit, me kafshët e reja, me përzgjedhjen e ushqimeve me synimin për t'i futur për herë të parë kafshët në riprodhim në peshën dhe moshën e duhur, me higjenën e kafshëve, me procesin e pjelljes etj., fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për njohuritë e marra për riprodhimin e kafshëve, trajtimin e kafshëve në periudhë çiftëzimi, të kafshëve barse, të porsalindurave e të kafshëve të reja.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë për rritjen e kafshëve (me lopë, dele, derra, etj.).
 - Stacion inseminimi, rregjistër ndërzimi.
 - Materiale studimore. Mjete të tjera vizuale.
 - Tabela dhe makete të organeve të riprodhimit.
 - Video me demonstrime të ndryshme.
-

8. Moduli “Mbledhja e prodhimeve bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MBLEDHJA E PRODHIMEVE BUJQËSORE	M-14-1948-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për zbatimin e teknikave të mbledhjes së frutave, perimeve, ullitit, rrushit, si dhe kryerjen e marrjes së mjaltit në zgjua.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi kryen mbledhjen e frutave. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën e duhur të punës dhe pajisjet e mbrojtjes personale që përdoren gjatë mbledhjes së frutave;– të përcaktojë llojin e frutit për mbledhje;– të përcaktojë mënyrën e vjeljes në varësi të llojit dhe kultivarit (këputje me dorë, prerje me gërshërë etj);– të kryejë vjeljen me kujdes dhe pa dëmtuar frutat së bashku me bishtin;– të vendosë frutat e vjela në arkë me rradhë;– të seleksionojë me kujdes frutat e dëmtuara dhe të vendosën në arka të tjera;– të vendosin arkat me kujdes njëra mbi tjetrën në mjetin transportues që disponon ferma;– të transportojë pa i tronditur arkat drejt magazinës;– të magazinonjë sipas standardeve të magazinimit në përputhje me qëllimin e përdorimit;– të pastrojë vendin e punës;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të ruajtje së mjaltit gjatë vjeljes së frutave; Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen vjeljen perimeve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur të punës dhe pajisjet e mbrojtjes personale që përdoren gjatë mbledhjes së frutave;
- të përcaktojë llojin e perimes për mbledhje;
- të përcaktojnë mënyrën e vjeljes në varësi të llojit të perimeve (këputje me dorë , prerje me gërrshërë etj);
- të kryejë vjeljen me kujdes dhe pa dëmtuar perimet së bashku me bishtin;
- të vendosë perimet e vjela në arkë me rradhë;
- të seleksionojë me kujdes perimet e dëmtuara dhe të vendosën në arka të tjera;
- të vendosin arkat me kujdes njëra mbi tjetrën nëmjetin transportues që disponon ferma;
- të transportojë pa i tronditur arkat drejt magazinës;
- të magazinonjë sipas standardeve të magazinimit në përputhje me qëllimin e përdorimit;
- të pastrojë vendin e punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes së mjediseve gjatë vjeljes dhe ruajtjes së perimeve në magazinë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi vjel prodhimin e ullirit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë mënyrën e vjeljes sipas llojit/kultivarit të ullirit si dhe zonës ku kultivohet (kodrinore, fushore);
- të përzgjedhë mjetet duhura të vjeljes së ullirit (çarcafë, furkë, krehëra etj);
- të vendosin me kujdes platformat vjelëse ose shkallë në çdo pemë ulliri;
- të vjelin ullinjtë pa i dëmtuar dhe pa firo duke vendosur çarcafë poshtë pemës;
- të seleksionojnë kokrrat e dëmtuara, sëmura dhe jashtë standardit me kujdes;
- të mbushin koshat me prodhim sipas qëllimit të përdorimit të tyre (treg, vaj, konservim etj);
- të vendosin me kujdes koshat në mjetet transportuese;
- të transportojnë pa firo prodhimin e vjelës;
- të magazinonjë prodhimin sipas standardeve të magazinimit e qëllimit të përdorimit (treg, përpunim vaji, konservim);
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit e shëndetit gjatë kryerjes së vjeljes së ullirit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi vjel prodhimin e rrushit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë saktë fazën e vjeljes së prodhimit sipas qëllimit të prodhimit (tryezë, përpunim, ruajtje);
- të përcaktojë saktë kohën e vjeljes (në kohë me diellpa vesë);
- të përcaktojë mënyrat e vjeljes së rrushit sipas teknikave të vjeljes (me gërshërë duke i kapur me kujdes nga bishti) për tu mos dëmtuar veshuli;
- të përzgjedhë mjetet e nevojshme për vjeljen e rrushit duke respektuar procesin;
- të vjelë prodhimin me ngadalë dhe pa e dëmtuar duke e prerë me gërshërë bashkë me bishtin;
- të vendosë veshulët nëpër arka, duke i vendosur bishtat lart;
- të vendosë veshulët jashtë standardit në arka të veçanta;
- të vendosë arkat në mjetin transportues njëra mbi tjetrën pa i dëmtuar;
- të transportojë prodhimin në magazinë brenda ditës;
- të magazinon prodhimin sipas qëllimit të përdorimit, duke respektuar rregullat e magazinimit (treg, përpunim etj);
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, mjedisor dhe shëndetësor gjatë procesit të vjeljes së prodhimit të rrushit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen marrjen e mjaltit në zgjua.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën speciale për vete e vizitorët për ndërhyrjen në zgjua;
- të ndërhyjë në zgjua sipas radhës së përcaktuar të punës;
- të hapë me kujdes zgjoin;
- të nxjerrë me kujdes kornizat nga zgjoi;
- të transportojë me kujdes kornizat në centrifugë;
- të vendosë kornizat në pozicionin e duhur në centrifugë;
- të centrifugojë hojet e bletëve;
- të nxjerrë me kujdes hojet nga centrifugimi;

- të vendosë me kujdes kornizat në vendin e caktuar për tharje;
- të kullojë dhe grumbullojë mjaltin në enë të veçanta;
- të transportojë enët e mjaltit në vendin e caktuar;
- të vendosë mjaltin në kavanoza qelqi sipas standartit;
- të pastrojë vendin e punës dhe mjetet;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë ndërhyrjeve në zgjua për marrjen e mjaltit dhe ruajtjen e saj;

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul mund të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në pemëtore, ullishte, vreshta dhe agrumishte, parqet e bletëve sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet shkolla.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të përgatitjes për punë në procesin e vjeljes së prodhimit, në kulturat drufrutore, ullinj, agrume, vreshta dhe parqet e bletëve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të përgatitjes për punë të procesit të vjeljes së prodhimit të kulturave drufrutore dhe marrjes së mjaltit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për realizimin me sukses të këtyre proceseve.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të vjeljeve dhe ruajtjes së prodhimeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përgatitjes për punë në procesin e vjeljes dhe ruajtjes së prodhimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese e shkollës (pemëtore, vreshtari, ullishte apo agrunishte, parku i bletëve.
 - Mjete për realizimin e vjeljes shkallë, platformë vjelëse
 - Mjete transporti
 - Kosha, arka, gërshërë, furkë, krehëra.
 - Parku i bletëve.
 - Centrifugë, ene për marrjen e mjaltit, kavnozë.
 - Veshje speciale, maska për fytyrën, doreza llastiku, tymëse
-

9. Moduli “Përpunimi i prodhimit bimor“

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI I PRODHIMIT BIMOR	M-08-1949-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer përpunimin e frutave, drithrave për miell, perimeve për marinada dhe turshi me metoda të ndryshme të përpunimit të prodhimit bimor.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV I KSHK..”.	

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit

RN 1 Nxënësi kryen përpunimin e frutave të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletin e punës për përpunimin e frutave.
- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës për përpunimin e frutave, sipas kërkesave të përcaktuara.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës, në përputhje me kërkesat.
- të përzgjedhë llojin e frutave për përpunim, të tilla si: mollë, dardhë, pjeshkë, qershi, luleshtrydhe etj.
- të përcaktojë sasisë e frutave për përpunim, sipas kërkesës.
- të përcaktojë sasisë e sheqerit që do të përdoret në përpunimin e frutave.
- të transportojë me kujdes sasinë e frutave dhe të sheqerit në repart.
- të përgatitë enët ambalazhuese të produkteve, sipas kërkesës.
- të përgatitë etiketat për ambalazhim me të gjitha të dhënat e duhura.
- të seleksionojë frutat për përpunim, sipas kriterëve dhe drejtimit të prodhimit.
- të lajë frutat me ujë të rrjedhshëm.
- të përpunojë frutat për lëng, komposto, reçel etj., sipas kërkesës.
- të përgatitë ambalazhin e duhur për mbushjen me produktin e përpunuar, sipas sasisë, kërkesave dhe standardeve për ruajtje.
- të etiketojë produktin e ambalazhuar sipas rregullit.
- të lajë dhe pastrojë enët dhe mjetet tjera të përdorura gjatë përpunimit të frutave.
- të pastrojë vendin e punës pas përpunimit të frutave, sipas kërkesave higjieno-sanitare.
- të grumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme me mjetet e duhura dhe në vendin e caktuar.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;

-
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të frutave.
 - **Instrumentet e vlerësimit:**
 - Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përpunon drithërat për miell.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për përpunimin e drithrave.
- të përgatitë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e drithrave.
- të pastrojë drithërat për përpunim, sipas metodave të caktuara.
- të transportojë në vendin e duhur mbeturinat e pastrimit të drithërave.
- të transportojë sasinë e drithrave për bluarje.
- të përpunojë drithërat për miell, sipas procedurës.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të drithërave për miell.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përpunon perimet për marinadë dhe turshi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e marinadave dhe turshive sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjieno-sanitare.
- të transportojë me kujdes e pa i dëmtuar perimet në repart.
- të seleksionojë me kujdes perimet për prodhimin e marinadave dhe turshive.
- të lajë perimet me ujë të rrjedhshëm.
- të heqë pjesët e padobishme të perimeve.
- të përmasojë perimet.
- të blansherojë perimet sipas kërkesave teknologjike të procesit.
- të transportojë lëndët ndihmëse në repart.
- të përgatisë solucionin e kripës dhe acidit organik në raportet e duhura.
- të grumbullojë e transportojë mbeturinat e ndryshme nga reparti.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të perimeve për marinadë e turshi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të përpunimit të frutave, perimeve.
- Instruktori i praktikës, ose teknologu i repartit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve përgatitore për prodhimin nënprodukteve bimore, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për prodhimin e nënprodukteve bimore, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për përpunimin e produkteve bimore.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për prodhimin e nënprodukteve bimore si dhe ambalazhimin e tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë.
 - Mjete pune për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë, si dhe ambalazhimin e tyre.
 - Mjete pune për përpunimin e drithrave për miell.
 - Mjete pune për përpunimin e perimeve për marinade dhe turshi.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për prodhimin e nënprodukteve bimore.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale etj..
-

10. Moduli “Përpunimi i prodhimit blegtoral”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodit	PËRPUNIMI I PRODHIMIT BLEGTORAL	M-08-1950-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer përpunime të thjeshta të qumështit për konsum dhe nënprodukte, si dhe të mishit të shpendëve dhe kafshëve të tjera për mish.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përpunon qumështin për konsum dhe nënprodukte. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për përpunime qumështit për konsum dhe për nënprodukte.– të higjienizojë mjetet dhe i vendin e punës për përpunime qumështit për konsum dhe nënprodukte, sipas kushteve higjieno-sanitare.– të kontrollojë siç duhet, treguesit cilësorë të qumështit përkonsum.– të transportojë me shumë kujdes, qumështin nërezervuarin (tankun) e grumbullimit.– të filtrojë sasisë e qumështit sipas procedurës së filtrimit.– të realizojë përpunimin e qumështit për konsum sipas procedurës së përpunimit.– të bëjë ambalazhimin e qumështit për konsum dhe ruajtje, sipas kërkesës.– të përpunojë qumështin për nënprodukte (kos, gjizë, gjalpë etj.) sipas procedurave përkatëse.– të formojë dhe kripos djathin sipas procedurës përkatëse.– të ambalazhojë nënproduktet e qumështit për konsum dhe ruajtje, sipas kriterëve të përcaktuara.– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përpunimit të qumështit për konsum dhe nënprodukte. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi përpunon mishin e shpendëve dhe kafshëve të tjera për konsum.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e pranimit të shpendëve e kafshëve.
- të higjienizojë mjetet e punës sipas rregullave higjieno-sanitare.
- të lajë kafshët dhe shpendët dhe t'i transportojë ato në vendin e therjes.
- të therë shpendë ose kafshë të tjera sipas procedurës së kryerjes.
- të transportojë mishin trup në vendin e përpunimit me shumë kujdes.
- të varë siç duhet shpendët apo kafshët në konvejer.
- të lajë dhe të dezinfektojë koshat bosh të transportimit të mishit trup të shpendëve e të kafshëve.
- të varë kafshët e shpendët pas larjes.
- të largojë pjesët e padobishme nga procesi i therjes.
- të kryejë tualetin e shpendëve dhe të kafshëve pas therjes, sipas procedurës.
- të kryejë ndarjen anatomike të shpendëve e të kafshëve sipas llojit.
- të ambalazhojë mishin trup të shpendëve.
- të ambalazhojë mishin të ndarë në mënyrë anatomike të shpendëve e kafshëve të ndryshme.
- të sistemojë mishin e therur të shpendëve e të kafshëve në repartet e përpunimit termik të ngrirjes.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të përpunimit të mishit të shpendëve dhe të kafshëve të tjera për konsum.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të përpunimit të produkteve blegtorale.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të përpunimit të qumështit dhe mishit, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për përpunimit të qumështit dhe mishit, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për përpunimin e përpunimit të qumështit dhe mishit.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit

dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve gjatë përpunimit të qumështit dhe mishit.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimii shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përpunimin e qumështit dhe mishit, si dhe ambalazhimin e tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për përpunimin e qumështit dhe mishit.
 - Mjete pune për prodhimin dhe përpunimin e qumështit dhe mishit, si dhe ambalazhimin e tyre.
 - Mjete pune për përpunimin e qumështit dhe mishit.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse për përpunimin e qumështit dhe mishit.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale etj.
-

11. Moduli: “Krijimi dhe organizimi i fermës bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KRIJIMI DHE ORGANIZIMI I FERMËS BUJQËSORE	M-17-1951-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të hartuar dokumentet e krijimit dhe organizimit të fermës bujqësore, përcaktuar formën juridike, hartuar planin e biznesit, aplikimin për regjistrimin në organet përkatëse, kryer veprimtaritë e punës sipas sektorëve, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me krijimin dhe organizimin e fermës bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi krijon “fermën” bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	<ul style="list-style-type: none">– të përgatitë vendin me mjetet dhe paisjet e nevojshme për krijimin e fermës bujqësore.– të përshkruajë ciklin jetësor të një ferme bujqësore;– të kryejë studimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e produkteve bujqësore;– të përcaktojë qartë qëllimin e drejtimit të fermës (bujqësor, blegtoral, mikse);– të përcaktojë qartë llojin e prodhimit bujqësor;– të përcaktojë saktë edhe shërbime të tjera që mund të ofrohen nga ferma bujqësore;– të kryejë saktë studimin e tregut të ofruesve të produkteve bujqësore;– të krahasojë ofertat, çmimet dhe kushtet e ofruesve duke evidentuar ofruesit potencialë të tyre;– të përcaktojë saktë vendin e fermës bujqësore në rrjetin e shpërndarjes së produkteve/shërbimeve bujqësore;– të përcaktojë qartë, vëllimin e shitjeve në sasi dhe vlerë për muajt e parë;– të llogarisë saktë koston e parashikuar për njësi të produktit objekt të veprimtarisë bujqësore;– të llogarisë saktë kosto të tjera të parashikuara variabël dhe fikse për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore;– të pasqyrojë saktë shpenzimet e parashikuara për reklamën

-
- dhe marketimin e produkteve/shërbimeve bujqësore;
 - të hartojë pasqyra të sakta dhe të qarta të parashikimit të rezultatit të fermës;
 - të përcaktojë saktë strukturën e pasurisë së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë;
 - të përcaktojë saktë nevojën për kapitale të biznesit bujqësor që do të krijohet.
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krijimit të fermës bujqësore;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë krijimit të fermës bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përcakton emrin dhe harton dokumentet bazë të krijimit të fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe paisjet e nevojshme për përcaktimin e emrit dhe hartimit të dokumantacionit bazë të fermës bujqësore.
- të përcaktojë emrin e fermës bujqësore në varësi të veprimtarisë dhe imazhit që kërkon të përcjellë tek të tretët.
- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme për fermën, sipas mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarit të fermës;
- të hartojë dokumentacionin për krijimin e fermës, sipas formës juridike, duke shfrytëzuar burimet e duhura;
- të hartojë një statut dhe një akt të thjeshtë të themelimi;
- të përcaktojë mënyrën për derdhjen e kapitalit fillestar;
- të përcaktojë saktë dhe qartë mënyrën se si do të bëhet derdhja e kapitalit fillestar të fermës bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përcaktimin e emrit dhe hartimit të dokumenteve bazë të krijimit të fermës.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të dokumantacionit bazë të krijimit të fermës bujqësore;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi harton planin e biznesit të fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe dokumentat e nevojshme të punës për hartimin e planit të biznesit;
- të përcaktojë qartë qëllimet dhe objektivat e fermës bujqësore;
- të përcaktojë saktë misionin e fermës bujqësore;
- të hartojë qartë deklaratën e qëllimit të fermës bujqësore.
- të grupojë rezultatet e kërkimit të tregut në funksion të qëllimit për të cilin hartohet plani i biznesit;
- të kryejë analizën SWOT dhe të hartojë pasqyra me pikat e dobëta e të forta lidhur me qëllimin e planit të biznesit;
- të bëjë analizën e tregut të produkteve e shërbimeve që ofron biznesi bujqësor;
- të vendosë emrin e fermës bujqësore;
- të përcaktojë elementet përfaqësues të identitetit të fermës si: logo dhe moto e veprimtarisë së fermës etj.;
- të përcaktojë vendndodhjen e fermës bujqësore;
- të hartojë planin e financimit të fermës bujqësore;
- të hartojë planin e marketingut të fermës bujqësore;
- të hartojë planin e menaxhimit të fermës bujqësore;
- të përcaktojë saktë strukturën organizative të fermës bujqësore që do të krijohet;
- të përcaktojë saktë burimet njerëzore të fermës bujqësore;
- të përcaktojë ekipin menaxhues dhe stafin drejtues të fermës bujqësore;
- të përcaktojë procedurat e rekrutimit të personelit;
- të bashkëngjitë shtojca të nevojshme të planit të biznesit si: artikuj, diagrame, kontrata, informata të detajuara financiare, patentë, informata rreth produkteve, listën e çmimeve, broshura, buletin informativ dhe skica teknike etj.;
- të paraqesë dokumentacionin dytësor të fermës bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e planit të biznesit të fermës bujqësore.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të planit të biznesit të fermës bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi aplikon për liçencim dhe regjistrim në organet përkatëse.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe paisjet e nevojshme për

- aplikimin për licencim dhe regjistrim në organet përkatëse të fermës bujqësore;
- të identifikojë informacionin në faqen zyrtare të QKB mbi procedurën dhe dokumentat e licencimit;
 - të plotësojë saktë formularët e aplikimit për licencim dhe të gjithë dokumentet që duhet të shoqërojnë aplikimin;
 - të licensohet pranë organeve përkatëse (QKB), duke ndjekur afatet e licencimit;
 - të marrë në dorëzim çertifikatat e licensimit, të paraqitet në afatin e caktuar në zyrat e shërbimeve të tatimpaguesve për tërheqjen e kodit të aksesit në faqen e tatimeve të fermës bujqësore;
 - të plotësojë saktë dokumentacionin e kërkuar nga organet tatimore lokale;
 - të paraqesë në afat dokumentacionin në organet tatimore lokale, shlyejë detyrimet duke institucionalizuar marrëdhëniet me to;
 - të plotësojë saktë dhe paraqesë në kohë dokumentat për regjistrim në zyrat e inspektoriatit të punës;
 - të deklarojë saktë online personelin e punësuar në momentin e çeljes së veprimtarisë së fermës bujqësore.
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur aplikimin për licencim dhe regjistrim në organet përkatëse;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë aplikimit për licencim dhe regjistrim në organet përkatëse;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen veprimtari sipas sektorëve të fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe paisjet e nevojshme për veprimtaritë e punës sipas sektorëve të fermës bujqësore;
- të kryejë organizimin e dokumentacionit dhe veprimtarive sipas sektorëve të fermës bujqësore;
- të kryejë plotësimin, përpunimin, administrimin dhe arkivimin e dokumenteve për punën e sektorëve;
- të përdorë programet kompjuterike të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të fermës bujqësore;
- të përdorë internetin, postën elektronike, komunikimet dhe veprimet on-line për kryerjen e veprimtarive të fermës bujqësore;
- të kryejë veprimtaritë administrative dhe financiare sipas sektorëve të fermës bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e

- veprimtarive sipas sektorëve të fermës bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së veprimtarive të punës sipas sektorëve të fermës bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e zyrave mësimore. Për realizimin e modulit dhe RN-ve të tij nxënësit punojnë me grupe dhe qarkullojnë sipas një plani rotacioni të hartuar nga mësuesi.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për studimin fillestar për krijimin e fermës bujqësore, përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, hartimin e planit të biznesit dhe kryerjen e veprimtarive sipas sektorëve në fermë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për studimin fillestar për krijimin e fermës bujqësore të simuluar, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për hartimin e planit të biznesit dhe për kryerjen e veprimtarive sipas sektorëve.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për krijimin e fermës bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e procedurave për krijimin dhe organizimin e fermës bujqësore.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis i zyrës mësimore, mjete kancelarie, kompjuter në lidhje me internetin.
 - Mjetet, materialet dhe pajisjet për krijimin dhe organizimin e fermës së simuluar bujqësore;
 - Modele statutesh, aktesh themelimi, planesh biznesi, dosjesh aplikimi në QKB të marra nga ferma reale, për krijimin dhe organizimin e fermës së simuluar;
 - Formularë aplikimi dhe regjistrimi në QKB, pasqyra, deklarata të parashikimit të fitimit etj.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

12. Moduli: “Plotësimi i dokumentacionit teknik të fermës bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PLOTËSIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK TË FERMËS BUJQËSORE	M-17-1952-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të organizuar vendet e punës, hartuar dhe plotësuar formularë dhe dokumente pune, përdorur paisjet e zyrës dhe hartojë një plan të qarkullimit të dokumenteve dhe informacionit brenda fermës bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me plotësimin e dokumentacionit teknik të fermës bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi organizon zyrën dhe vendet e punës në fermën bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet dhe paisjet e nevojshme për organizimin e zyrës dhe vendeve të punës në fermën e simuluar;– të hartojë skica dhe planimetri të thjeshta në bazë të funksioneve të zyrës dhe kritereve ergonomike;– të hartojë listat e pajisjeve të nevojshme duke u bazuar në skicën dhe planimetrinë e zyrës;– të hartojë porosinë për pajisjet dhe mobiljet e nevojshme;– të hartojë dokumentacionin për marrjen në dorëzim;– të pasqyrojë pajisjet dhe mobiljet në pasuri të zyrës;– të vendosë pajisjet dhe mobiljet sipas vendeve të punës ose planimetrisë së hartuar;– të hartojë lista të detyrave në varësi të llojit të zyrës;– të hartojë lista të përgjegjësive brenda zyrës duke u bazuar në funksionet përkatëse dhe rregulloren e brendshme të fermës;– të caktojë grupet e punës për plotësimin e detyrave të veçanta në bazë të vendit të punës dhe aftësive personale të secilit anëtar;– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me organizimin e zyrës dhe vendeve të punës në fermën bujqësore.– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;	

-
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi harton dhe plotëson dokumente në fermën bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe paisjet e nevojshme për hartimin dhe plotësimin e dokumentave dhe formularë pune në fermën bujqësore;
- të përcaktojë saktë listën e dokumentave që përdoren në fermën bujqësore;
- të përcaktojë saktë përmbajtjen e dokumentit në përputhje me qëllimin për të cilin ai përdoret;
- të zbatojë rregullat për hartimin e dokumenteve të punës;
- të hartojë saktë një dokument me të gjithë elementët e formës së tij në përputhje me qëllimin për të cilin ai hartohet;
- të hartojë saktë në kompjuter regjistrat kontabël (ditarin, librin e madh, partitarët, ditarët analitikë) në formë modelesh, për veprimtarinë e fermës bujqësore.
- të hartojë saktë dokumente të ndryshme zyrtare;
- të hartojë saktë dokumente informative;
- të hartojë saktë korrespondencë zyrtare të formave dhe qëllimeve të ndryshme;
- të përcaktojë saktë elementet e një formulari pune sipas qëllimit që do të përdoret;
- të hartojë saktë një tekst të thjeshtë me të gjitha elementet e tij strukturorë të formës dhe të përmbajtjes;
- të plotësojë saktë dokumenta dhe formularë të ndryshëm të fermës bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin dhe plotësimin e dokumenteve në fermën bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përdor fotokopjuesin dhe pajisjet e tjera të zyrës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë, sipas funksioneve përkatëse, pjesët e ndryshme të fotokopjuesit;

- të përdorë korrekt panelin e komandimit të fotokopjuesit;
- të përgatisë saktë për fotokopim materiale të llojeve (formularë, dokumenta të fermës, foto, figura, materiale të përziera) dhe formateve të ndryshme;
- të kryejë saktë ndezjen dhe fikjen e fotokopjuesit;
- të vendosë, në mënyra të ndryshme, materialet që do të fotokopjohen;
- të përcaktojë saktë parametrat e fotokopjimit (zoom, numri i kopjeve, fotokopjimi në paralel, kontrasti, ngjyrat, përzgjedhja e sirtarit të marrjes së letrave, anulimi i komandave);
- të vendosë, në mënyrë korrekte, letrën në sirtare;
- të bëjë zëvendësimin e bojës (tonerit) të fotokopjuesit;
- të bëjë siç duhet nxjerrjen e letrave të bllokuara;
- të mirëmbajë siç duhet fotokopjuesin;
- të përzgjedhë drejt pajisjet kryesore të kancelarisë;
- të përdorë saktë pajisjen për hapjen e vrimave;
- të përdorë korrekt pajisjen për kapjen e akteve;
- të përdorë korrekt pajisjen për lidhjen e letrave;
- të përdorë drejt komandat e makinës llogaritëse të dorës;
- të përdorë korrekt materialet kryesore të kancelarisë;
- të mirëmbajë pajisjet dhe materialet kryesore të kancelarisë;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përdorimin e fotokopjuesit dhe pajisjeve të tjera të zyrës.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përcakton mënyrën e qarkullimit të dokumenteve dhe informacionit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe paisjet e nevojshme për përcaktimin e mënyrës së qarkullimit të dokumentave dhe informacionit të fermës bujqësore;
- të hartojë një plan të thjeshtë të qarkullimit të dokumenteve dhe informacionit brenda fermës bujqësore;
- të dokumentojë, në çdo rast, lëvizjen e dokumenteve dhe informacionit brenda dhe jashtë fermës bujqësore;
- të bëjë përpunimin dhe dokumentimin e postës në hyrje dhe në dalje sipas rregullave të vendosura më parë;
- të përcaktojë drejt afatet e realizimit të detyrave të veçanta;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me

përcaktimin e mënyrës së qakullimit të dokumenteve dhe informacionit;

- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore të shkollës dhe në ferma reale.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e fermave reale.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të organizuar një zyre pune, për konceptimin dhe hartimin e një plani të qarkullimit të dokumenteve dhe informacionit brenda njësisë ekonomike të dhënë dhe sipas parimeve, kritereve dhe rregullave të vendosura, si edhe për të hartuar tekste zyrtare, plotësuar formularë dhe dokumente pune duke përdorur të gjitha pajisjet e zyrës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për plotësimin e dokumentacionit teknik, qarkullimin e dokumenteve dhe informacionit brenda fermës bujqësore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjediset e zyrave mësimore.
 - Materiale kancelarie.
 - Dokumente të ndryshme pune nga ferma reale dhe të përgatitura nga mësuesi.
 - Formularë model nga praktika e fermave bujqësore.
 - Tekste të llojeve të ndryshme.
 - Telefon dhe Faks.
 - Fotokopjues.
 - Pajisje të vogla zyre (lidhëse letrash, hapëse vrimash, etj.).
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

13. Moduli “Inventarizimi i pasurisë së fermës”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INVENTARIZIMI I PASURISË SË FERMËS	M-17-1953-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer veprimet për inventarizimin, hartimin e inventarit dhe kontrollin e elementeve pasurore të fermës bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me inventarizimin e pasurisë së fermës.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen procesin e inventarizimit të fermës bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit të elementëve pasurore të fermës bujqësore;– të përcaktojë qartë metodikën që do të ndiqet për kryerjen e procesit të inventarizimit;– të zbatojë fazat nëpër të cilat kalon procesi i inventarizimit të elementëve pasurore të fermës;– të përzgjedhë personin e duhur përgjegjës dhe hartojë listën e detyrave që duhet të përmbushë ai, gjatë inventarizimit;– të përcaktojë, në bazë të planit/urdhërit, sektorët ose pasuritë që do t’i nënshtrohen inventarizimit, në rastin e inventarizimit të pjesshëm;– të kryejë, me saktësi dhe brenda tolerancave, të gjitha matjet, numërimet dhe peshimin e elementeve të pasurisë së fermës bujqësore;– të listojë në mënyrë sistematike elementet e inventarizuara të pasurisë së fermës bujqësore;– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me procesin e inventarizimit të fermës bujqësore– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi harton inventarin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit të elementëve pasurore të fermës bujqësore;
- të konceptojë qartë pasqyrën e inventarit, që do të përdoret për pasqyrimin e rezultateve të inventarizimit;
- të hartojë pasqyrën e inventarit sipas llojit;
- të grupojë saktë elementet pasurore të inventarizuara sipas llojeve të tyre;
- të mbartë me saktësi rezultatet e inventarizimit në pasqyrën e inventarit;
- të bëjë vlerësimin me saktësinë e kërkuar, të elementeve pasurore në inventar;
- të llogarisë saktë vlerën e pasurisë së fermës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e inventarit
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të inventarit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë hartimit të inventarit të fermës bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kontrollon përdorimin e pasurisë së fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit të elementëve pasurore të fermës bujqësore;
- të llogarisë saktë vlerën e pasurisë, duke u bazuar në inventare të viteve të kaluara dhe dokumente, që vërtetojnë shtim ose pakësim të saj gjatë vitit;
- të krahasojë, për çdo element, vlerën e pasurisë sipas dokumenteve, me atë sipas inventarit;
- të evidentojë qartë diferencat eventuale në elementë të ndryshme pasurore;
- të kontrollojë saktësinë e dokumenteve dhe hartimin e inventarëve, duke evidentuar qartë gabimet e mundshme;
- të përcaktojë përgjegjësinë për keqadministrimin e pasurisë dhe personat që do të dëmshpërblejnë dëmtimet e shkaktuara.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kontrollin e përdorimit të pasurisë së fermës bujqësore.

- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit gjatë krahasimit të gjëndjes faktike me atë sipas dokumenteve duke kontrolluar mirëpërdorimin e pasurisë së fermës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale, zyra mësimore si dhe në ferma reale.
- Mësuesi duhet të informojë nxënësit në lidhje me elementët pasurorë të fermës t'i orientojë ata për mënyrën e realizimit të procesit të inventarizimit, mënyrën e hartimit të inventarëve si dhe të veprojnë për të kontrolluar përdorimin e pasurisë së fermës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të realizuar procesin e inventarizimit, hartuar inventarin dhe krahasimin e gjëndjes faktike me atë sipas dokumenteve duke kontrolluar përdorimin e pasurisë së fermës.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në fermë, duke e krahasuar atë me praktikën mësimore në shkollë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për realizimin e procesit të inventarizimit, mënyrën e hartimit të inventarëve si dhe për të realizuar kontrollin e përdorimit e pasurisë së fermës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Zyrë mësimore (kabineti) ose fermë reale.
 - Modele inventarësh të marra nga ferma reale.
 - Kompjuter.
 - Formularë dokumentash model të formuluar nga mësuesi.
 - Materiale mësimore të lëndës “Njohuri ekonomike” lidhur me tematikat përkatëse.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjisllacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjisllacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

14. Moduli “Planifikimi i prodhimit në fermën bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	PLANIFIKIMI I PRODHIMIT NË FERMËN BUJQËSORE	M-17-1954-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të hartuar, zbërthyer dhe zbatuar një plan të prodhimit bujqësor, si dhe për të llogaritur kostot e tij, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me planifikimin e prodhimit në fermën bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi harton një plan të prodhimit bujqësor.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet, dhe materialet pajisjet e nevojshme për hartimin e një plani të thjeshtë prodhimi bujqësor;– të studjojë kërkesat e konsumatorëve për periudhën e planifikuar, për të vendosur se çfarë do të prodhohet;– të bëjë vlerësimin e burimeve të nevojshme për të planifikuar sasinë e duhur të prodhimit bujqësor për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve;– të identifikojë dhe analizojë kufizimet dhe vështirësitë, që mund të rrezikojnë prodhimin;– të planifikojë të gjitha kostot, që janë të domosdoshme për realizimin e prodhimit;– të hartojë një plan paraprak të prodhimit;– të kryejë kontrollin e planit paraprak me objektivat që ka vendosur ferma;– të zbulojë mospërputhjet dhe të kryejë modifikimet e mundshme të planit të prodhimit;– të hartojë planin përfundimtar të prodhimit bujqësor.– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e planit të prodhimit bujqësor;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të një plani të prodhimi bujqësor;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p>	

-
- Pyetje përgjigje me gojë
 - Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi zbërthen planin e prodhimit dhe përcakton përgjegjësitë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme për zberthimin e planit të prodhimit dhe përcaktimit të përgjegjësive;
- të përcaktojë saktë tipin e procesit të prodhimit bujqësor;
- të zërthejë në kohë planin e prodhimit në vartësi të tipit të procesit të prodhimit të përcaktuar më parë;
- të zërthejë planin e prodhimit sipas proceseve të punës që janë të nevojshme për realizimin e prodhimit;
- të zërthejë planin e prodhimit në vartësi të produkteve bujqësore që janë parashikuar të prodhohen;
- të llogarisë nevojat për burime për secilën prej pjesëve të veçanta të planit të prodhimit;
- të llogarisë kostot pjesore të prodhimit të produkteve të ndryshme;
- të hartojë listën e përgjegjësive (sektorë, reparte prodhimi, magazina etj.) për realizimin e prodhimit në vartësi të tipit të procesit të prodhimit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me zberthimin e planit të prodhimit dhe përcaktimit të përgjegjësive;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ndjek zbatimin e planit të prodhimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe materialet e nevojshme për ndjekjen e zbatimit të planit të prodhimi;
- të përgatisë dhe lëshojë urdhrat e punës për çdo repart prodhimi;
- të formulojë kërkesa të reparteve për nevojat, që ato kanë për burime të ndryshme;
- të përgatisë dhe lëshojë urdhrat e furnizimit të reparteve me materiale të para dhe ndihmëse nga magazina;
- të hartojë listat e kontrollit për ndjekjen e realizimit të proceseve të ndryshme të planifikuara;
- të përgatisë dhe qarkullojë dokumentet shoqëruese të procesit të prodhimit;

- të hartojë listat e kontrollit të performancës dhe të përputhjes me standardet;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ndjekjen e zbatimit të planit të prodhimit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi llogarit kostot faktike të prodhimit në fermë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e nevojshme për llogaritjen e kostove faktike të prodhimit;
- të kryejë saktë dokumentimin e shpenzimeve materiale si dhe të lëvizjes së tyre në çdo fazë të prodhimit;
- të kryejë saktë dokumentimin e sasisë dhe cilësisë së punës së kryer nga punëtorët, në vartësi të tipit të organizimit të prodhimit;
- të kryejë saktë dokumentimin e shpenzimeve të punës;
- të kryejë saktë dokumentimin dhe llogaritjen e shpenzimeve të tjera të drejtpërdrejta të prodhimit dhe ndarjen e tyre sipas produkteve ose veprimtarive;
- të kryejë saktë dokumentimin e shpenzimeve të tërthorta të prodhimit bujqësor;
- të kryejë saktë ndarjen e shpenzimeve sipas produkteve ose fazave të procesit teknologjik të prodhimit bujqësor;
- të llogarisë koston faktike të prodhimit në fermë;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi llogarit koston e plotë dhe për njësi të prodhimit bujqësor.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe mjetet e nevojshme për llogaritjen e koston të plotë dhe atë për njësi të prodhimit bujqësor;
- të kryejë saktë dokumentimin dhe llogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit;
- të kryejë saktë shpërndarjen e shpenzimeve të tërthorta dhe

atyre të përgjithshme të fermës , sipas produkteve ose shërbimeve;

- të llogarisë koston e plotë të prodhimit në vartësi të tipit të organizimit të prodhimit;
- të llogarisë koston e plotë për njësi, në vartësi të tipit të organizimit të prodhimit;
- të përcaktojë pikën kritike të fermës, sipas produkteve të prodhuara, për të mos lejuar tejkalimin e shpenzimeve.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi planifikon rezervat e domosdoshme në fermë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë pajisjet dhe materialet e nevojshme për planifikimin e rezervave të domosdoshme në fermë;
- të identifikojë faktorët që ndikojnë në madhësinë e rezervave dhe analizojë mënyrën e ndikimit të tyre në vartësi të tipit të procesit të prodhimit, çmimit, largësisë nga furnitorët etj.;
- të planifikojë sasinë e duhur të rezervave në lëndë të para, ndihmëse dhe materiale;
- të planifikojë sasinë e prodhimit në proces, në sasi, kohë dhe llojshmëri në vartësi të llojit të produktit, procesit të prodhimit etj.;
- të planifikojë rezervat e nevojshme të produkteve me karakter stinor prodhimi, për të siguruar një furnizim normal të tregut të shitjes;
- të llogarisë saktë koston e shpenzimeve për rezerva.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale pranë shkollës (zyrat mësimore) dhe në fermat bujqësore.
- Mësuesi duhet të ketë shumë kujdes për të përzgjedhur rastet më të thjeshta dhe mos kaluar kufijtë e kërkuar për nxënësit së shkollës së mesme.
- Nxënësit do të zbatojnë, në kushtet konkrete të fermës, aftësitë e fituara gjatë praktikës në shkollë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur

-
- demonstrimet e rasteve konkrete nga praktika ekonomike e vendit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të planifikuar prodhimin, kostot e tij, evidentuar shpenzimet, kontrolluar realizimin e planeve të prodhimit.
 - Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në ndërmarrjet prodhuese të të mirave dhe shërbimeve.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Zyrat mësimore në shkollë ose ferma reale.
 - Mjete kancelarie.
 - Plane prodhimi të fermave bujqësore reale.
 - Formularë dhe pasqyra shpenzimesh nga fermat reale.
 - Formularë dokumentesh të shpenzimeve, fatura, fletë-hyrje dhe fletë-dalje, dokumenta të qarkullimit të prodhimit, etj, të marra në fermat reale, të përgatitura nga mësuesi ose të hartuara në module të mëparshme.
 - Kompjuter.
 - Manualët e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

15. Moduli “Prodhimi i produkteve organike bimore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PRODHIMI I PRODUKTEVE ORGANIKE BIMORE	M-14-1955-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të zbatuar teknikat e prodhimit të produkteve organike në fermat bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me prodhimin e produkteve organike bimore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përgatit tokën për mbjelljen e kulturave për prodhim organik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatëpunimit bazë dhe plotësues të tokës;– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për punimit bazë dhe plotësues të tokës;– të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglavedhe mjeteve të punës për punimin bazë dhe plotësues të tokës;– të bëjë përshtatjen e veglave dhe mjeteve të punës sipas llojit të punimit;– të kryejë shpërndarjen e plehërave organike;– të kryejë punimin bazë të tokës me vegla të thjeshta ose të mekanizuara sipas llojit të punimit;– të kontrollojë cilësinë e punimit bazë dhe plotësues të tokës sipas llojit të punimit;– të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas përdorimit të tyre;– të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë dhe pas përdorimit të tyre;– të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet bazë dhe plotësuese të tokës;– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave për prodhim organik;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë punimit bazë të tokës;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

gjatë punimit bazë dhe plotësues të tokës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi mbjellë kulturat bujqësore për prodhim organik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatëmbjelljes së kulturave bujqësore;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e kulturave bujqësore;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e kulturave bujqësore;
- të njihet me mënyrën dhe modelet e zërthimit të planit të realizimit të mbjelljeve të kulturave bujqësore për prodhim organik;
- të zërthejë planin e mbjelljeve të fushës sipas udhëzimeve përkatëse;
- të përlogaritë dendësinë e mbjelljes, sipas distancave dhemënyrës së mbjelljes së kulturave bujqësore;
- të përlogaritë sasinë e nevojshme të materialit mbjellës, sipas sipërfaqes së parcelës që do të mbillet me kultura bujqësore;
- të sigurojë materialin mbjellës të përlogaritur përmbjellje, sipas standardeve të bujqësisë organike.
- të përgatitë materialin mbjellës për mbjellje, sipas llojit të kulturës dhe standardeve përkatëse;
- të kryejë piktimin e saktë të ngastrave sipas distancave të mbjelljes së kulturave bujqësore;
- të realizojë mbjelljen sipas distancave të mbjelljes së kulturave bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me mbjelljen e kulturave bujqësore për prodhim organik;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë procesit të mbjelljes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të mbjelljes;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen shërbime agroteknike bimëve për prodhim organik.

Kriteret e vlerësimit.

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së shërbimeve në kulturave bujqësore;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve agroteknike të kulturave bujqësore;

- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimëve agroteknike të kulturave bujqësore;
- të kryejë shërbimet agroteknike menjëherë pas mbjelljes sipas nevojës së kulturave bujqësore;
- të realizojë rrallimin dhe prashitjen e kulturave sipas nevojës së kulturave bujqësore;
- të plotësojë nevojat e kulturave bujqësore për ujë sipas nevojave, duke zbatuar metodat më eficiente të ujitjes së tyre;
- të plotësojë nevojat e kulturave bujqësore për elementë ushqyes, sipas nevojave të tyre dhe mbështetur në standardet e bujqësisë organike;
- të kujdeset për shëndetësimin e kulturave bujqësore, sipas standardeve të bujqësisë organike;
- të kryejë vjeljen e prodhimit organik të kulturave bujqësore, sipas standardeve përkatëse;
- të magazinon prodhimin organik në vendin e caktuar për ruajtje;
- të seleksionon dhe paketon prodhimin organik sipas kërkesave dhe standardeve të bujqësisë organike;
- të përgatisë dhe vendosë etiketat me të gjitha të dhënat e uhura të prodhimit organik, sipas standardit të kërkuar;
- të kujdeset për ruajtjen e produkteve organike në kushte optimale të ruajtjes në përputhje me standardet përkatëse;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e shërbimeve agroteknike ndaj bimëve për prodhim organik;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë procesit të mbjelljes;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në fermë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë saj.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për kultivimin organik të kulturave bujqësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zbatimin e agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë edhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve të agroteknologjisë së kultivimit organik të kulturave bujqësore.

-
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për prodhimin organik të kulturave bujqësore.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të zbatimit të teknologjisë së prodhimit organik të kulturave bujqësore.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Baza prodhuese e shkollës apo fermë e prodhimit bujqësor dhe blegtoral afër saj.
 - Traktor.
 - Makina mbjellëse
 - Vegla dhe pajisje të thjeshta pune për mbjelljen e tokës.
 - Vegla dhe pajisje pune për shërbimet kulturore të bimëve.
 - DVD, video, CD, pankarka, skica apo modele të planit tëmbjelljes së bimëve.
 - Manualët e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

16. Moduli “Mbrotjtja e integruar në bujqësi”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MBROJTJA E INTEGRUAR NË BUJQËSI	M-14-1956-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të organizuar punën, kryer kontrollë fushore, si dhe zbatuar planin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore ndaj dëmtuesve, sëmundjeve dhe barishteve të këqija, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me mbrojtjen e integruar në bujqësi.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK..	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen kontroll fushor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së kontrollit fushor;– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e kontrollit fushor;– të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për kryerjen e kontrollit fushor;– të përcaktojë saktë qëllimin e kontrollit fushor: për dëmtues, sëmundje apo barishte të këqija;– të përzgjedhë llojin e kulturës (bimë arash, perime, drufrutorë etj.) dhe të parcelave për kontroll;– të hartojë planin e vrojtimit për një parcelë të dhënë, duke përfshirë datat dhe kohën e saktë të kryerjes së vrojtimit;– të përcaktojë fazën biologjike të kulturës sipas karakteristikave të rritjes normale;– të identifikojë bimët e infektuara në parcelë sipas karakteristikave të rritjes jo normale të tyre;– të diagnostikojë saktë shkakun e infeksionit (dëmtues, sëmundje apo barishte të këqija);– të përcaktojë shkallën e infeksionit nëse është në rritje apo në rënie;– të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së kulturës;– të realizojë me korrektësi planin e kontrollit fushor duke respektuar datat dhe kohën e vrojtimit;– të mbajë saktë shënimet për parcelën e monitoruar lidhur me bimët dhe dëmtuesin;– të plotësojë saktë dokumentacionin përkatës të kontrollit fushor;– të analizojë të dhënat për të përcaktuar dëmin ekonomik të	

-
- shkaktuar nga infektive të ndryshme;
 - të krahasojë gjendjen aktuale të kulturës së përzgjedhur me standardin e lejuar ekonomik (pragu ekonomik) për të ndërhyrë për mbrojtjen e tyre;
 - të raportojë të dhënat e kontrollit fushor nëninstanca më të larta përgjegjëse për marrjen e masave të kontrollit;
 - të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë vlerësimit të tokës për kryerjen e kontrollit fushor;
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e kontrollit fushor;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kontrollit fushor;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit fushor;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi zbaton masat e mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve;
- të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve;
- të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave ndaj dëmtuesve;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga dëmtuesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi zbaton masat e mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve;
- të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve;
- të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave ndaj sëmundjeve;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së integruar të kulturave bujqësore nga sëmundjet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi zbaton masat e mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave, mjeteve të punës për gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave ndaj barishtet e këqija;
- të zbatojë masat kimike të mbrojtjes së kulturave ndaj barërave të këqija;

- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me zbatimin e masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes së bimëve nga barërat e këqija;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në fermë të prodhimit bujqësor.
- Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të kryerjes së veprimtarive të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe për zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija.
- Mësuesi/instruktori mund të organizojë vizita mësimore apotakime me eksperte bujqësie për shkëmbimin e përvojave mbi organizimin e planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija, në familjaritet me mjedisin.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur në kryerjen e veprimtarive të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si për zbatimin e planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të organizimit të planit të punës, kryerjes së kontrollit të fushave të mbjella, si dhe të zbatimit të planit të masave të mbrojtjes së integruar në bujqësi kundër dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Ferma e shkollës ose fermë e prodhimit bujqësor.
 - Mjete për punimin e tokës (bel, shatë, capë etj.).
 - Lëndë ngjitëse për insektet, vajra, naftë etj..
 - Kurthet elektrike.
-

-
- Pesticide të ndryshme të lejuara nga BE.
 - Mjete punë të thjeshta krahu dhe/ose të mekanizuara për kryerjen e trajtimeve kimike.
 - Pompë spërkatëse.
 - Tabela paralajmëruese dhe informuese për rrezikun e pesticideve.
 - Kova e mjete të tjera ndihmëse për spërkatje.
 - Mjete transporti.
 - Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde etj.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

17. Moduli “Blerja dhe shitja e produkteve bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	BLERJA DHE SHITJA E PRODUKTEVE BUJQËSORE	M-17-1957-23
Qëllimi i modulit	Një modul, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer procedurën e blerjes dhe të shitjes, në kushtet e një tregu edhe ndërkombëtar dhe konkurrues, si dhe për të plotësuar dokumentacionin përkatës, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me blerjen dhe shitjen e produkteve bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV I KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi vendos marrëdhënie me furnitorët Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për të analizuar dhe vendosur marrëdhënie me furnitorët për blerjet e fermës bujqësore;– të kërkojë me kujdes dhe të orientuar nga qëllimi, informacione për furnitorë vendas dhe për furnitorë në tregun ndërkombëtar bujqësor;– të identifikojë furnitorët potencialë, me të njëjtin objekt veprimtarie me fermën tonë;– të hartojë lista përmbledhëse me informacione të qarta dhe të plota të furnitorëve potencialë të identifikuar;– të shqyrtojë kartelat e furnitorëve potencialë, për periudhat e kaluara, duke identifikuar qartë furnitorët aktualë;– të hartojë statistika të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për furnitorët aktuale;– të identifikojë saktë blerjet, të cilat do të kryhen pranë furnitorëve;– të vendosë marrëdhënie korrekte me furnitorët duke i dokumentuar ato;– të kërkojë oferta nga furnitorët me lista çmimesh për produktet bujqësore;– të përgatisë porositë përkatëse për produktet që do të blihen, në bazë të nevojave për blerje të fermës;– të llogarisë sipas llojeve, sasi të produkteve që do të blihen pranë furnitorëve.– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me	

-
- vendosjen e marrëdhënieve me furnitorët;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me furnitorët;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen blerjet dhe plotëson dokumentacionin përkatës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për realizimin e blerjeve në fermën bujqësore.
- të marrë ofertat nga ofruesit e produkteve/shërbimeve;
- të regjistrojë ofertat e marra nga ofruesit e produkteve/shërbimeve;
- të krahasojë ofertat e mbërritura nga furnitorë të ndryshëm, në bazë të kushteve dhe veçorive të tyre;
- të llogarisë ofertat, duke përcaktuar ofertën më të mirë;
- të hartojë kontratat të sakta me ofruesit e përzgjedhur si oferta më e mirë (përshtatshme);
- të kryejë porositë në ofruesit e përzgjedhur për tregun;
- të plotësojë saktë formularët për secilin ofrues;
- të regjistrojë me saktësi porositë;
- të kryejë saktë regjistrimet e blerjeve në kartelat e furnitorëve;
- të regjistrojë blerjet për veprimtarinë e biznesit në kartelat e magazinës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e blerjeve plotësimin e dokumentacionit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me furnitorët;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të blerjes së produkteve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi vendos marrëdhënie me klientët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për kryerjen e analizës dhe vendosjen e

- marëdhëniet me klientët;
- të kërkojë me kujdes në mënyrë të orientuar nga qëllimi informacione për klientë shoqëri apo individë, vendas dhe të huaj;
 - të shfrytëzojë burime dhe mjete të ndryshme të duhura të informacionit, për gjetjen e klientëve potencialë;
 - të hartojë lista të qarta dhe të plota të klientëve potencialë të identifikuar nga kërkimi, veçorive dhe kërkesave të tyre, si dhe kontakteve me to;
 - të shqyrtojë kartelat e klientëve ekzistues, të periudhave të kaluara;
 - të hartojë statistika të sakta të shitjeve të periudhave të kaluara të analizuara, sipas klientëve;
 - të hartojë lista të klientëve në të cilat të pasqyrojë saktë preferencat dhe kërkesat e vecanta të sejcilit prej tyre si dhe kushtet e lëvrimit dhe të pagesave të deritanishme me ta;
 - të përcaktojë saktë klientët e preferuar dhe format e trajtimit të veçantë të tyre, duke evidentuar dhe kërkesat e tyre në të ardhmen.
 - të shqyrtojë kartelat e klientëve aktualë, për periudhat e kaluara;
 - të hartojë statistika të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për klientët aktuale, mbi bazën e veprimeve dhe vëllimit të shitjeve të realizuar me ta.
 - të përgatisë, në bashkëpunim me sektorin e marketingut materialet informative që u dërgohen klientëve;
 - të reklamojë, nëpërmjet internetit, materialet informative të ndërmarrjes për vendosjen e marrëdhëniet të biznesit me klientët;
 - të përpunojë saktë informacionet e marra nga klientët e kontaktuar, që kanë shfaqur interes;
 - të hartojë lista të plota të klientëve me të cilët parashikohet të vazhdoen marrëdhëniet e biznesit;
 - të dërgojë informacione të plota klientëve mbi listën e çmimeve dhe katalogëve;
 - të dërgojë oferta të veçanta, për ulje çmimi, kushte të veçanta lëvrimi e pagese, dhurata, etj.;
 - të dërgojë anketime për kërkesa të veçanta të klientëve;
 - të hartojë planin e detajuar të përmbushjes së kërkesave të klientëve.
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me vendosjen e marrëdhëniet me klientët;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientët vendas dhe të huaj;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen shitjen e produkteve bujqësore dhe plotëson dokumentacionin përkatës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për kryerjen e shitjeve të produkteve bujqësore dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës.
- të hartojë kontratat e shitblerjes, mbi bazë e elementëve ligjorë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të regjistrojë saktë porositë e mbërritura nga klientët;
- të kontrollojë gjendjen e produkteve sipas cilësisë dhe sasisë së tyre;
- të dërgojë njoftimet sektorit të blerjeve, për plotësimin e gjendjes së produkteve, në rast se ato nuk disponohen;
- të hartojë saktë dëftesat e lëvrimin dhe fletëdaljet e produkteve për t'u shitur;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së produkteve;
- të regjistrojë, saktë, ekzekutimin e porosive të klientëve;
- të plotësojë kartelat individuale të klientëve;
- të regjistrojë saktë pakësimin e gjendjes së mallrave të shitura në kartelat e magazinës;
- të dërgojë, brenda afateve, në zyrën e kontabilitetit dokumentet e shitjes për ndjekjen e arkëtimeve.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me shitjen e produkteve bujqësore dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me klientët vendas dhe të huaj;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shitjes së produkteve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kryen blerje dhe shitje në Web-shop.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për kryerjen e blerjeve dhe shitjeve në Web-shop;
- të kërkojë informacion për fermat në Web-shop, për nevojat për blerje të të fermës bujqësore, të orientuara sipas produkteve të kërkuara për blerje;
- të identifikojë saktë produktet që do të porositin;
- të krahasojë ofertat dhe kushtet e lëvrimin e të pagesës së

- tyre;
- të përzgjedhë saktë ofertën më të mirë;
- të kryejë saktë porosinë për produktet që do të blihen;
- të kryejë ruajtjen elektronike dhe printimin e porosisë së kryer;
- të regjistrojë saktë porosinë në regjistrin e porosive të kryera;
- të përcjellë në kohë porosinë për blerje, për përdorime të mëtejshme, duke zbatuar të njëjtën procedurë me atë të blerjeve të tjera.
- të kontrollojë rubrikën e porosive në faqen e Web-shop, duke identifikuar saktë porositë e reja që duhet të përpunohen;
- të përpunojë dhe të regjistrojë saktë porositë e reja në regjistrin e tyre, duke ndjekur të njëjtën procedurë me atë të shitjeve në forma të tjera;
- të dërgojë në formë elektronike konfirmimin për marrjen e porosisë;
- të ruajë porosinë në formën e përshtatshme elektronike, për ta përdorur për qëllime të mëtejshme.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me blerjet dhe shitjet në *Web-shop*;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me furnitorët dhe klientët;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore .
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e fermave reale.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse të tyre, për analizimin e klientëve potencialë, nxitjen e marrëdhënieve me ta, sigurimin e klientëve të rinj, hartimin e kontratave të shitblerjes, kryerjen e shitjeve të drejtpërdrejta dhe në Web-shop, si dhe dokumentimin e regjistrimit të këtyre shitjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe

regjistrimet përkatëse të tyre, analizimin e klientëve potencialë, nxitjen e marrëdhënieve me ta, hartimin e kontratave të shitblerjes, kryerjen e shitjeve të drejtpërdrejta dhe në Web-shop, si dhe dokumentimin e regjistrimit e këtyre shitjeve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- mjedis i zyrave mësimore;
 - materiale kancelerie dhe kompjuter në lidhje me internetin;
 - dokumente të ndryshme model nga feramat reale dhe të përgatitura nga mësuesi;
 - dëftesa lëvrimi, formularë, fatura, regjistra të blerjeve dhe shitjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

18. Moduli: “Magazinimi, ruajtja dhe sigurimi i cilësisë së prodhimit bujqësor”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MAGAZINIMI, RUAJTJA DHE SIGURIMI I CILËSISË SË PRODHIMIT BUJQËSOR	M-14-1958-23
Qëllimi i modulit	Një modul, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të magazinuar, ruajtur dhe siguruar cilësinë e prodhimeve bujqësore si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me magazinimin, ruajtjen dhe sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi kryen veprime të magazinimit të prodhimit bujqësor</p> <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të sistemojë vendin me mjetet dhe paisjet e duhura për të magazinuar prodhimet e fermës bujqësore;– të kontrollojë kushtet teknike dhe higjienike të magazinës;– të organizojë dhe sistemojë magazinën me pajisjet e duhura në varësi të prodhimit bujqësor.– të plotësojë inventarin e magazinës;– të plotësojë librin e magazinës me gjendjet fillestare;– të plotësojë saktë fletëhyrjet e magazinës;– të grupojë sipas cilësive të tyre prodhimin bujqësor në magazinë;– të zbatojë planin e qarkullimit dhe të trajtimit të prodhimeve të cilat dëmtohen ose kanë afat skadence;– të kontrollojë gjendjen e prodhimit bujqësor sipas cilësive;– të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me magazinimin e prodhimit bujqësor;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimeve të magazinimit të prodhimit bujqësor. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje përgjigje me gojë– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi kryen ruajtjen e prodhimit bujqësor

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për ruajtjen e prodhimit bujqësor;
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme për ruajtjen e prodhimit bujqësor;
- të transportojë me kujdes veglat, pajisjet dhe materialet për ruajtjen e prodhimit bujqësor;
- të kryejë ndarjen dhe seleksionimin e prodhimit bujqësor sipas standardit të prodhimit;
- të ruajë prodhimin bujqësor në kushte të përshtatshme sipas standardeve;
- të kujdeset për ruajtjen e prodhimit nga dëmtuesit e depove;
- të realizojë trajtimin në kohë dhe në mënyrën e duhur të dëmtuesve në depo;
- të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë ruajtjes së prodhimit bujqësor;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ruajtjen e prodhimit bujqësor;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ruajtjes së prodhimit bujqësor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen analiza për sigurinë dhe cilësinë e produkteve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në laborator për kryerjen e analizave organo-shqisore, fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të produktit bujqësor;
- të dezinfektojë mjetet dhe mjedisin e punës, sipas rregullave higjiëno-sanitare;
- të përzgjedhë metodat për kryerjen e analizave organo-shqisore, fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të produktit bujqësor.
- të përzgjedhë kriteret për marrjen e mostrës të produktit bujqësor, sipas llojit dhe karakteristikave së tij;
- të marrë mostrën mesatare të produktit bujqësor, sipas konsistencës dhe veçorive të tij dhe sipas rregullave për marrjen e mostrave;
- të kryejë matje të temperaturës së produktit bujqësor dhe mjedisit të laboratorit sipas kërkesave standarde për kryerjen e analizave;
- të vlerësojë pamjen e jashtme të produktit bujqësor sipas

kërkesave standard;

- të përcaktojë ngjyrën e produktit bujqësor sipas kërkesave standarde për kryerjen e analizës;
- të përcaktojë aromën e produktit bujqësor sipas kërkesave standarde për kryerjen e analizës;
- të përcaktojë shijen e produktit bujqësor sipas kërkesave standarde për kryerjen e analizës;
- të përcaktojë treguesit fizikë të produktit bujqësor;
- të përcaktojë treguesit kimikë të produktit bujqësor;
- të përcaktojë treguesit mikrobiologjik të produktit bujqësor;
- të krahasojë rezultatet e analizave me kërkesat standarde;
- të interpretojë rezultatet e analizave dhe të plotësojë raportin laboratorik;
- të kujdeset vazhdimisht për sigurinë dhe cilësinë e prodhimit bujqësor;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e analizave dhe sigurimin e cilësisë së produkteve bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së analizave për sigurinë dhe cilësinë e produkteve bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së analizave të produkteve bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës dhe në laboratorin e kryerjes së analizave për sigurimin e cilësisë së produkteve bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të zbatimit të masave për magazinimin, ruajtjen dhe kryerjen e analizave për sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për zbatimin e masave për magazinimin, ruajtjen dhe kryerjen e analizave për sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.
- Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen proceseve të punës për magazinimin, ruajtjen dhe kryerjen e analizave për sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për magazinimin, ruajtjen dhe kryerjen e analizave për sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për magazinimin, ruajtjen dhe kryerjen e analizave për sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.
- Instruktori i praktikës, duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mirëmbajtjes së pajisjeve laboratorike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës

së arritjes së shprehive praktike të zbatimit të masave për magazinimin, ruajtjen dhe kryerjen e analizave për sigurimin e cilësisë së prodhimit bujqësor.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
 - Baza prodhuese e shkollës apo fermë e prodhimit bimor afër saj.
 - Vegla dhe pajisje pune për magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit bujqësor (thasë, lidhëse, arka, frigoriferë etj).
 - Preparate kimike për dëmtuesit e depove.
 - Pompë spërkatëse.
 - Manuale të ndryshme për magazinimin dhe ruajtjen e prodhimit bujqësore.
 - Laborator i kontrollit të sigurisë dhe cilësisë për vlerësimin e produktit bujqësor;
 - Mjete, paisje për marrjen, transportimin dhe ruajtjen e mostrave të produkteve bujqësore;
 - Mjete, solucione dhe reagent kimike, instrumenta, aparatura dhe pajisje laboratorike për kryerjen e analizave për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së produktit bujqësor të prodhuar.
 - Kampione të ndryshme për kryerjen e analizave organo - shqisore fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të produktit bujqësor.
 - Skema për sigurimin teknik, udhëzuesa, metodika analizash, katalogë, manuale, materiale të shkruara, kushte teknike dhe standarde shtetërore, në mbështetje të çështjeve që do të trajtohen në këtë modul.
 - Manuale të preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

19. Moduli “Marketingu në ferma bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MARKETINGU NË FERMËNBUJQËSORE	M-17-1959-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të zbatuar planin e marketingut, për të krijuar imazhin e fermës bujqësore si dhe për të realizuar fushata promovuese të produkteve bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me marketingun në fermat bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton planin e marketingut të fermës bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë dhe sistemojë vendin e punës me mjetet, materialet dhe paisjet e duhura për të zbatuar planin e marketingut të fermës bujqësore;– të parashikojë hapat dhe strukturën e planit marketing;– të evidentojë grupet e synuara të klientëve sipas produkteve të prodhuara në fermën bujqësore;– të përzgjedhë kanalet e shpërndarjes sipas produktit bujqësor që po promovohet;– të kontribuojë në hartimin e një plani të saktë, të qartë dhe të detajuar të masave për promovimin e fermës bujqësore;– të kryejë llogaritje të kostove përkatëse të promovimit të fermës bujqësore;– të hartojë listat e përgjegjësive për promovimin e fermës bujqësore;– të hartojë planin e kontrollit për realizimin e detyrave në fushën e promovimit.– të kontribuojë në përzgjedhjen e produkteve të reja që do të hidhen në treg.– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me zbatimin e planit të marketingut të fermës bujqësore;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të planit të marketingut të fermës bujqësore;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të planit të marketingut të fermës	

bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi krijon imazhin e fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe sistemojë vendin e punës me mjetet, materialet dhe paisjet e duhura për krijimin e imazhit të fermës bujqësore.
- të kontribuojë në konceptimin e imazhit të fermës dhe evidentojë saktë se çfarë do të kërkohet të përcillet tek të tretët;
- të kontribuojë në konceptimin e logos së fermës, e cila të përshtatet me objektin e veprimtarisë dhe imazhin e konceptuar;
- të kontribuojë në hartimin e një motoje, që karakterizon më mirë imazhin, veprimtarinë dhe pritshmërinë për fermën bujqësore;
- të kontribuojë në konceptimin dhe hartimin e fletëpalosjeve, katalogjeve dhe materialeve të tjera të shkruara për të promovuar fermën bujqësore, në përputhje me imazhin që kërkohet të krijohet;
- të hartojë formularë dhe dokumente model me “kokën” dhe ngjyrat e fermës bujqësore, për tu përdorur në vazhdim në korrespondencën me të tretët;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me krijimin e imazhit të fermës bujqësore
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krijimit të imazhit të fermës bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë krijimit të imazhit të fermës bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi realizon fushatën promovuese të produkteve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe sistemojë vendin e punës me mjetet, materialet dhe paisjet e duhura për realizimin e fushatës promovuese të produkteve bujqësore.
- të kontribuojë në përcaktimin e drejtë të grupit të synuar, në vartësi të tregut të produkteve bujqësore;
- të mbajë parasysh konsumatorin aktual të produkteve bujqësore, sepse ai është reklamuesi më i mirë i vetë asaj;
- të kontribuojë në përzgjedhjen e bartësit të reklamës në

- varësi të madhësisë së tregut, grupit të synuar, kostove të reklamës etj.;
- të kontribuojë në përzgjedhjen e teknikave të reklamimit për formulimin e mesazhit të reklamës së produkteve bujqësore;
 - të kontribuojë në formulimin e konceptit të një reklame me strukturë të zakonshme (titulli, nëntitulli, “trupi” i reklamës);
 - të kontribuojë në realizimin e promovimit të përfitimeve nga produkti në “zemrën” e strukturës së reklamës;
 - të kontribuojë në formulimin e sloganit të fushatës së reklamës;
 - të bëjë prezantimin e duhur të reklamës së hartuar.
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me realizimin e fushatës promovuese të produkteve bujqësore;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së fushatës promovuese;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së fushatës promovuese të produkteve të fermës bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore në shkollë ose ferma reale.
- Trajtimi i këtij moduli duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor. Ai duhet të zhvillohet paralelisht me module të tjera.
- Për realizimin e modulit dhe RN-ve të tij nxënësit punojnë me grupe dhe qarkullojnë sipas një plani rotacioni të hartuar nga mësuesi.
- Ashtu si dhe në fermat reale, të njëjtat veprime përsëriten disa herë, dhe secili prej tyre performohet nga grupe të ndryshme nxënësish.
- Mësuesi duhet të nxisë aftësitë krijuese të nxënësve duke i inkurajuar për gjenerimin e ideve, për përdorimin e burimeve të ndryshme të informimit (Internet, gazeta, revista, fletëpalosje, kontaktet me ekspertë dhe me konsumatorë etj.) dhe duke u lejuar hapësirën dhe kohën e nevojshme për të punuar.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë për hapat e punës që do të ndiqen për realizimin e reklamës së fermës bujqësore, për idetë e paraqitura si edhe të vlerësojnë arritjet e nxënësve të tjerë. Gjithashtu, ata duhet të nxiten që të bashkëpunojnë sa më shumë me njëri-tjetrin.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Zyrat mësimore në shkollë ose ferma reale.
- Mjedise pune me kompjutera dhe lidhje interneti
- Programe të ndryshme kompjuterike për realizimin e marketingut të fermës bujqësore.
- Materiale kancelarie. Pajisje për përgatitjen e materialeve promovuese.
- Fletëpalosje dhe materiale të ndryshme reklame dhe materiale udhëzuese.
- Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
- Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.

20. Moduli: “Menaxhimi i burimeve njerëzore në fermën bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE NË FERMËN BUJQËSORE	M-17-1960-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procedurat e identifikimit, planifikimit, rekrutimit, punësimit, zhvillimit të vazhduar të personelit si dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore në fermën bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen planifikimin e nevojave për personel të fermës bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për planifikimin e nevojave për personel të fermës bujqësore;– të mbledhë informacion të saktë dhe të plotë nga sektorët e fermës bujqësore për nevojat për personel;– të analizojë saktë dhe me përgjegjshmëri kërkesat esektorëve për personel;– të përcaktojë saktë nevojat për personel, sipas sektorëve të fermës bujqësore;– të hartojë formularët përmbledhës për personelin e ri;– të marrë vendimin përfundimtar për personel, sipas analizës së nevojave;– të përcaktojë dokumentet dhe kriteret e nevojshme për vendet e lira të punës, sipas standardeve të kërkuara (Kërkesë punësimi, CV, dokumente vërtetuese të aftësive profesionale dhe personale të kandidatit);– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e planifikimit të nevojave për personel të fermës bujqësore;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë teknikat për negocim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi harton njoftimet për vendet e reja të punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për hartimin e njoftimeve për vendet e reja të punës në fermën bujqësore;
- të formulojë një njoftim të qartë për personelin që kërkohet;
- të renditë sipas rëndësisë listën e saktë të dokumenteve që do t'u kërkohen kandidatëve;
- të përcaktojë mjetet/mënyrat me të cilat mund të kryhet njoftimi për vende të reja pune;
- të llogarisë me saktësi kostot paraprake të njoftimeve;
- të marrë një vendim të argumentuar ekonomikisht dhe efektiv për mënyrën e publikimit të njoftimit;
- të publikojë njoftimin sipas mënyrës së përzgjedhur;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e njoftimeve për vendet e reja të punës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen procedurat e rekrutimit të personelit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për kryerjen e procedurave të rekrutimit të personelit në fermën bujqësore.
- të shqyrtojë me korrektesë dokumentat e kandidatëve për vendet e punës;
- të hartojë kriteret profesionale dhe korrekte për vlerësimin e kandidatëve;
- të formulojë saktë pyetësorët dhe formularët për kandidatët që intervistohen;
- të realizojë me korrektesë dhe profesionalizëm intervistat me kandidatët e përzgjedhur nga seleksionimi i dosjeve;
- të kryejë vlerësim objektiv bazuar në dokumentacionin dhe rezultatin e intervistës;
- të marrë vendimin e duhur lidhur me pranimin e kandidatëve;
- të kryejë publikimin e emrave fitues dhe njoftimin e sektorëve për personelin e ri.

- të prezantojë kandidatin fitues me vendin e punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e procedurave të rekrutimit të personelit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së procesit të rekrutimit të personelit;
- të zbatojë teknikat për negociim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me kandidatët gjatë procesit të rekrutimit të personelit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen procedurat e punësimit të personelit të fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për kryerjen e procedurave të punësimit;
- të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë korrekte të gjithë informacionin mbi bazën ligjore që rregullon marrëdhëniet e punës;
- të negociojë lidhur me kushtet e punës, pagesën etj.;
- të hartojë kontratën e punës mbështetur në kuadrin ligjor, kodin e punës dhe negociatave paraprake;
- të nënshkruajë kontratën e punës;
- të regjistrojë me saktësi punonjësin/it e ri/nj në regjistrin themeltar të fermës bujqësore;
- të kryejë regjistrimin në zyrën e punës, sigurimet shoqërore dhe të marrë numrin/at e sigurimeve;
- të çelë librezat e punës dhe sigurimeve shoqërore;
- të kryejë regjistrimin e punonjësve të rinj në librin e pagave;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e procedurave të punësimit të personelit të fermës bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së procedurave të punësimit;
- të zbatojë teknikat për negociim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me punonjësit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi harton planin për zhvillimin e vazhduar të personelit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë dhe sistemojë vendin e punës me mjetet dhe paisjet e duhura për zhvillimin dhe trajnimin e vazhduar të personelit të fermës;
- të identifikojë nevojat për kualifikime sipas sektorëve dhe vendeve të punës;
- të ndërtojë një plan kualifikimi të personelit të ri;
- të hartojë një program rikualifikimi për personelin ekzistues;
- të llogarisë kostot për veprimtaritë kualifikuese dhe rikualifikuese;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e planit të zhvillimit të vazhduar të personelit të fermës bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të planit për zhvillimin e vazhduar të personelit;
- të zbatojë teknikat për negociim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul mund të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore por gjithashtu edhe në mjediset e fermave bujqësore, i shtrirë në kohë përgjatë një viti shkollor.
- Për realizimin e modulit dhe përmbushjen e RN-ve nxënësit ndahen në grupe, hartohet një plan qarkullimi nga mësuesi.
- Sikurse në njësitë e tjera ekonomike e njëjta veprimtari mund të realizohet më shumë sesa një herë kështu që u jepet mundësia nxënësve që të ndarë në grupe të performojnë në rolin e punonjësit të burimeve njerëzore.
- Mësuesi duhet të tregohet sa më fleksibël dhe të krijojë mundësinë që nxënësit të marrin vendime të pandikuara dhe të drejta.
- Nxënësi duhet të angazhohet konkretisht në planifikimin, përzgjedhjen, rekrutimin, punësimin, kualifikimin, rikualifikimin e personelit të fermës bujqësore.
- Nxënësi duhet të kryejë procedurat e punësimit dhe dokumentimit të personelit në fermën bujqësore.
- Vlerësimi i nxënësve të argumentohet dhe të bazohet në aftësitë dhe shprehitë praktike të fituara dhe të demonstruar në këto veprimtari.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqëshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis i zyrave mësimore ose fermë bujqësore ose biznes familjar;
 - Materiale kancelerie;
 - Dokumente të ndryshme model nga fermat reale dhe të përgatitura nga mësuesi për menaxhimin e burimeve njerëzore në fermë;
 - Kompjuter në lidhje me internetin;
 - Materiale të ndryshme informative të marra nga fermat reale panairt e punës, seminare të ndryshme etj.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

21. Moduli “Veprime ekonomike në fermën bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VEPRIME EKONOMIKE NË FERMËN BUJQËSORE	M-17-1961-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar veprime ekonomike si: llogaritje, kontabilizime, mbylljen vjetore, ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të fermës bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me veprimet ekonomike në fermën bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi kryen regjistrimin kontabël të krijimit të fermës bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të sistemojë vendin e punës, paisjet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël të krijimit të fermës bujqësore.– të kryejë saktë regjistrimin kontabël të kapitalit fillestar të derdhur nga pronarët për krijimin e fermës bujqësore;– të kryejë saktë regjistrimin kontabël të shumave të shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin dhe regjistrimin e fermës bujqësore;– të kryejë saktë regjistrimin kontabël të gjendjeve tëbilancit fillestar (artikulli i çeljes) në ditar;– të kryejë saktë çeljen e kartelave të magazinës, sipasformatit të përcaktuar;– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me regjistrimin kontabël të krijimit të fermës;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së regjistrimeve kontabël;– të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi kontabilizon blerjet, shitjet, pagesat dhe arkëtimet për produktet bujqësore. Kriteret e vlerësimit:</p>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me paisjet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e regjistrimeve kontabël të blerjeve, shitjeve, pagesave dhe arkëtimeve;
- të çelë ditarin analitik të blerjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të rregjistrojë saktë faturat e blerjes së produkteve në ditarin analitik të blerjeve;
- të kryejë regjistrimin e saktë kontabël në shtim të gjendjes së produkteve në magazinë;
- të kryejë regjistrimin e saktë të faturave të blerjeve në regjistrin e faturave të marra.
- të çelë ditarin analitik të shitjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të rregjistrojë saktë faturat e shitjeve të produkteve në ditarin analitik të shitjeve;
- të kryejë regjistrimin kontabël, në pakësim, të gjendjes së produkteve bujqësore;
- të rregjistrojë saktë faturat e shitjeve në regjistrin e faturave të emetuara.
- të kontabilizojë saktë arkëtimin e faturave të shitjes duke kryer dhe përditësimet përkatëse në regjistrin e faturave të emetuara;
- të hartojë saktë urdhrin e transfertës për pagesën e produkteve dhe shërbimeve të blera;
- të kontabilizojë saktë pagesën e produkteve apo shërbimeve të blera.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kontabilizimin e blerjeve, shitjeve, pagesave dhe arkëtimeve;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së kontabilizimit të blerjeve, shitjeve, pagesave dhe arkëtimeve;
- të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen vlerësime dhe kontabilizime në magazinë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës, paisjet dhe mjetet e nevojshme të punës për kryerjen e vlerësimeve dhe kontabilizimeve përkatëse në magazinë;
- të vlerësojë saktë koston e mallit të shitur (KMSH) sipas metodave të legjislacionit në fuqi.
- të kryejë saktë regjistrimin e KMSH në librat përkatës;
- të kontabilizojë saktë daljet e lëndëve të para dhematerialeve për prodhimet bujqësore;
- të kontabilizojë saktë hyrjen e produkteve bujqësore në magazinë;

- të vlerësojë saktë gjendjen përfundimtare të magazinës nëpërmjet inventarizimeve të sakta dhe të plota të saj;
- të kontabilizojë saktë gjendjet e magazinës dhe ndryshimin e tyre;
- të kontabilizojë saktë diferencat në magazinë;
- të kuadrojë magazinën me repartet e prodhimit për materialet, lëndët e para dhe produktet bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me vlerësimet dhe kontabilizimet në magazinë;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së vlerësimeve dhe kontabilizimeve në magazinë;
- të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen vlerësimin e aktiveve afatgjata.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës, paisjet dhe mjetet e nevojshme të punës për kryerjen e vlerësimeve të aktiveve afatgjata.
- të kryejë saktë kontabilizimin e blerjes dhe hyrjes së aktiveve afatgjata, sipas prejardhjes;
- të llogarisë saktë, sipas normativave ligjore në fuqi, amortizimin e aktiveve afatgjata sipas llojeve dhe grupeve të tyre;
- të kryejë saktë rregjistrimin kontabël të shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata;
- të kontabilizojë saktë daljen e aktiveve afatgjata për destinacione dhe qëllime të ndryshme (jashtë përdorimit, faljen, shitjen e tyre).
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me vlerësimet të aktiveve afatgjata;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së vlerësimeve të aktiveve afatgjata;
- të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi kontabilizon shpenzime, të ardhura, pagesa dhe arkëtime të tjera.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës, paisjet dhe mjetet e nevojshme të

- punës për kryerjen e kontabilizimeve të shpenzimeve, të ardhurave, pagesave dhe arkëtimeve të tjera;
- të kontabilizojë saktë shpenzimin dhe pagesën për taksatlokale;
 - të shkarkojë dhe dorëzojë urdhër pagesat për kuotat e parashikuara të tatimit mbi fitimin;
 - të shkarkojë dhe dërgojë në bankë urdhër pagesat për pagesën e tatimit mbi fitimin në rastin e biznesit të vogël;
 - të kontabilizojë saktë pagesat për tatimin mbi fitimin;
 - të kontabilizojë saktë shpenzimet për blerjet, mirëmbajtjen dhe pagesën e materialeve të zyrës;
 - të kontabilizojë saktë shpenzimet për shërbime të tjera të blera (energji, telefon, ujë, internet, etj) dhe pagesën e tyre.
 - të kontabilizojë saktë shpenzimet/pagesat për interesa,qera, etj;
 - të kontabilizojë saktë arkëtimet/të ardhurat nga interesa e qera;
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kontabilizimin e shpenzime, të ardhurave, pagesave dhe arkëtimeve të tjera;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kontabilizimit të shpenzime, të ardhurave, pagesa dhe arkëtime të tjera që realizon ferma bujqësore;
 - të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi kryen veprimet e mbylljes dhe hartimin e bilancit përfundimtar të fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës, paisjet dhe mjetet e nevojshme të punës për kryerjen e veprimeve të mbylljes dhe hartimin e bilancit përfundimtar të fermës bujqësore;
- të kryejë saktë kontabilizimin e përmbledhjes së shpenzimeve;
- të regjistrojë saktë në kontabilitet përmbledhjen e të ardhurave;
- të llogarisë saktë, rezultatit ekonomik të fermës bujqësore;
- të hartojë saktë, dhe sipas normativave ligjore në fuqi bilancin e fermës bujqësor.
- të deklarojë online në afat tatimin përfundimtar mbi fitimin;
- të deklarojë online në afat pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- të deklarojë online në afat fitimin e parashikuar për vitin e ardhshëm;
- të kontabilizojë saktë tatimin e fitimit përfundimtar dhe pagesën e diferencave.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me veprimet e mbylljes dhe hartimit të bilancit përfundimtar të fermës bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion,

iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;

- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së veprimeve të mbylljes dhe hartimit të bilancit përfundimtar të fermës bujqësore;
- të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore.
- Realizimi i RN-ve duhet të trajtohen në atë mënyrë që i përshtatet veprimtarisë së fermës bujqësore.
- Gjithashtu RN-ja konsiderohet e arritur në se zgjidhet njëra prej metodave të vlerësimit LIFO ose FIFO si dhe njëra nga metodat e regjistrimit kontabël: inventarit periodik ose të përhershëm. Marrja e vendimit është pavarësi e mësuesit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e fermave reale.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të zyrës mësimore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer llogaritje ekonomike, kontabilizime dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të fermës bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për të kryer llogaritje ekonomike, kontabilizime dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të fermës bujqësore.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis i zyrës mësimore ose ferma reale;
 - Materiale kancelerie;
 - Dokumente të ndryshme financiare, model nga ferma reale dhe të përgatitura nga mësuesi;
 - Mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin;
 - Formularë, pasqyra financiare, libra financiarë të detyrueshëm, të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme;
 - Materiale të ndryshme informative.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

22. Moduli “Veprime për detyrimet ndaj Shtetit”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	VEPRIME PËR DETYRIMET NDAJ SHTESTIT	M-17-1962-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për llogaritjen e detyrimeve për: Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin mbi të Ardhurat Personale (TAP) dhe Tatimin mbi Fitimin (TF), si dhe deklarimin, pagesën dhe kontabilizimin e tyre, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me veprimet për detyrimet ndaj shtetit.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV I KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN), dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi llogarit, kontabilizon dhe rregullon marrëdhëniet me shtetin për TVSH-në. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përgatitë vendin, paisjet dhe mjetet e nevojshme për llogaritjen, regjistrimin dhe dokumentimin e TVSH-së;– të llogarisë saktë qarkullimin vjetor për të konstatuar nëse ferma është ose jo subjekt i TVSH-së;– të plotësojë saktë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin për TVSH-në nëse ferma bujqësore është subjekt i saj;– të aplikojë pranë QKB për regjistrimin e ndërmarrjes si subjekt i TVSH-së;– të afishojë në vend të dukshëm certifikatën e numrit të NUIS (NIPT-it);– të hartojë saktë dokumentet e duhur në rast se ferma ka ndryshim të vëllimit të veprimtarisë së saj;– të trajtojë njoftimet e organeve tatimore mbi rivlerësimin e TVSH-së.– të hartojë saktë faturën për eksportet;– të regjistrojë saktë në librin e shitjeve faturat e eksporteve;– të llogarisë saktë vlerën e tatueshme për faturat e importit;– të llogarisë saktë TVSH-në për importet;– të plotësojë saktë tërë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritjen dhe vërtetimin e TVSH-në për importet;– të kryejë saktë regjistrimet e faturave të importit në librin e	

-
- blerjeve duke regjistruar dhe TVSH-në përkatëse;
 - të pasqyrojë saktë dhe qartë në mënyrë të veçantë TVSH për importin e makinerive dhe pajisjeve që do të përdoren për prodhim;
 - të llogarisë dhe pasqyrojë saktë në librat e shitjes dhe blerjes VSH-në për hidrokarburet sipas qëllimeve të përdorimit të tyre;
 - të kryejë saktë dokumentimin e TVSH-së në rast kur pagesa kryhet para emetimit të faturës.
 - të regjistrojë saktë faturat e të gjitha blerjeve dhe shitjeve të kryera në librat e blerjeve dhe shitjeve;
 - të përgatisë dhe dërgojë në zyrën e tatimeve, në mënyrë elektronike, librat e shitjes dhe blerjes, në datat 5 të çdo muaji;
 - të plotësojë deklaratat të sakta dhe të plota tatimore për TVSH-në;
 - të kuadrojë shumat e deklaruara me ato të librave të shitjes dhe blerjes, të dërguara në mënyrë elektronike, si dhe me regjistrat kontabël;
 - të plotësojë UXH për pagesën e TVSH-së;
 - të regjistrojë shumat e njoftuara nga organet tatimore për rivlerësim të TVSH-së;
 - të kuadrojë në fund të periudhës ushtrimore me zyrën e tatimeve për TVSH-në dhe të regjistrojë diferencat eventuale;
 - të kryejë veprimet e duhura për rregullimin e diferencave me zyrën e tatimeve dhe shlyerjen e tyre.
 - të mbartë saktë shumat nga librat e blerjes dhe shitjes në llogari;
 - të llogarisë saktë dhe kontabilizojë tepricën e TVSH për t'u derdhur dhe për t'u marrë;;
 - të pasqyrojë saktë dhe qartë në bilancin përfundimtar detyrimet ose të drejtat përfundimtare ndaj shtetit për TVSH-në;
 - të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë llogaritjes, regjistrimit dhe dokumentimit të TVSH-së;
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me llogaritjet, kontabilizimin dhe rregullimin e marrëdhënieve me shtetin për TVSH-në;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së llogaritjeve, kontabilizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TVSH-në;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë llogaritjeve, kontabilizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TVSH-në.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi llogarit, kontabilizon dhe rregullon marrëdhëniet me shtetin për TAP.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin paisjet dhe mjetet e nevojshme të punës për kryerjen e llogaritjeve, kontabilizimit, deklarimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TAP.
- të llogarisë saktë pagën bruto të punonjësve të fermës;
- të llogarisë saktë ndalesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- të llogarisë saktë Tatimin mbi të Ardhurat Personale TAP;
- të llogarisë saktë pagën bruto;
- të hartojë saktë listëpagesën e fermës dhe listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore
- të kontabilizojë saktë listëpagesat në ditar dhe në llogaritë e duhura;
- të plotësojë saktë deklaratën tatimore për TAP dhe sigurimet shoqërore /shëndetësore;
- të kontabilizojë saktë rregullimin e marrëdhënies me shtetin për TAP dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë llogaritjes, regjistrimit dhe dokumentimit të TAP;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me llogaritjet, kontabilizimin dhe rregullimin e marrëdhënieve me shtetin për TAP;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së llogaritjeve, kontabilizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TAP;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë llogaritjeve, kontabilizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TAP.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi llogarit, kontabilizon dhe rregullon marrëdhëniet me shtetin për TF.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin paisjet dhe mjetet e nevojshme të punës për kryerjen e llogaritjeve, kontabilizimit, deklarimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TAP.
- të parashikojë saktë fitimin e parashikuar për periudhën e ardhshme duke u bazuar në periudhat e kaluara dhe ndryshimet e parashikuara të kushteve ose veprimtarisë;
- të llogarisë saktë TF që parashikon për periudhën e ardhshme;

- të hartojë deklaratë të saktë dhe të plotë mbi TF e parashikuar;
- të ndjekë me rigorozitet procedurat e deklarimit të TF të parashikuar;
- të përpunojë saktë njoftimin përfundimtar mbi TF paraparak të marrë nga zyra e tatimeve;
- të llogarisë saktë kuotat mujore të TF që do të paguhen në formë paradhënie gjatë periudhës së ardhme, duke u bazuar në njoftimin e zyrës së tatimeve.
- të urdhërojë, në afatin e duhur çdo muaj, pagesat e TF për shumën e saktë të llogaritur;
- të kontabilizojë saktë paradhëniet mujore nga TF;
- të përpunojë dhe evidentojë njoftimet e marra nga zyra e tatimeve për rivlerësim të TF;
- të llogarisë saktë shumat shtesë që duhen paguar cdo muaj në përputhje me rivlerësimet e marra.
- të llogarisë, saktë mbi bazën e fitimit përfundimtar, detyrimin vjetor faktik për TF;
- të kontabilizojë saktë TF vjetor faktik në llogaritë përkatëse;
- të llogarisë saktë shumat e TF që ndërmarrja duhet të derdhë ende ose të marrë nga shteti;
- të pasqyrojë saktë dhe qartë në bilancin e periudhës ushtrimore marrëdhënien me shtetin për TF;
- të plotësojë saktë deklaratën tatimore për TF përfundimtar faktik;
- të kryejë veprimet e plota dhe të sakta për të rregulluar marrëdhënien përfundimtare me shtetin për TF, në vartësi të pozicionit debitor ose kreditor të fermës;
- të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë llogaritjes, regjistrimit dhe dokumentimit të TF;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me llogaritjet, kontabilizimin dhe rregullimin të marrëdhënieve me shtetin për TF;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së llogaritjeve, kontabilizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TF;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë llogaritjeve, kontabilizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve me shtetin për TF.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore të shkollës dhe në ferma bujqësore.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e fermave bujqësore.

-
- Është veçanërisht e rëndësishme, që nxënësve t'u theksohet se trajtimi i tematikave të modulit duhet t'i qendrojë shumë besnik legjislacionit në fuqi, sepse ferma ka detyrimin që ta rrespektojë atë.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të llogaritur vëllimin e veprimtarisë dhe kryer veprimet për të llogaritur TVSH, TAP dhe TF dhe kryer veprimet për regjistrimin e tyre, deklaruar TVSH, TAP dhe TF, rregulluar marrëdhëniet me shtetin për to dhe kryer regjistrimet përkatëse kontabël.
 - Për realizimin e modulit janë të domosdoshme njohuritë e marra në lëndën “Njohuri ekonomike” Kl. 13-të.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për të llogaritur TVSH, TAP dhe TF dhe kryer veprimet për regjistrimin e tyre, deklaruar TVSH, TAP dhe TF, rregulluar marrëdhëniet me shtetin për to dhe kryer regjistrimet përkatëse kontabël.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Materiale kancelarie.
- Kompjuter në lidhje me internetin.
- Modele deklaratsh tatimore për TVSH, TAP, parashikimin e TF, deklarimin e TF, derdhjen e TF etj.
- Legjislacioni mbi TVSH, TAP, TF;
- Dokumente të ndryshme pune nga feramat reale ose të përgatitura nga mësuesi.
- Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
- Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.

23. Moduli “Dixhitalizimi i fermave bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	DIXHITALIZIMI I FERMAVE BUJQËSORE	M-26-1963-23
Qëllimi i modulit	Një modul që pajis nxënësit me aftësitë bazë për të mundësuar menaxhimin e fermave bujqësore përmes teknikave të ndryshme dixhitale, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me dixhitalizimin e fermës bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënësve (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përzgjedh platformën dixhitale për dixhitalizimin e të dhënave bazë për menaxhimin e fermës bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të identifikojë llojet e platformave dixhitale për menaxhimin e informacionit në fermën bujqësore;– të identifikojë sektorët prodhues të fermës për dixhitalizimin e të dhënave të tyre;– të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës së duhur dixhitale për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të fermës;– të përzgjedhë platformën dixhitale për grumbullimin dhe përpunimin dixhital të të dhënave të fermës bujqësore;– të prezantojë platformën dixhitale të përzgjedhur për grumbullimin dhe përpunimin dixhital të të dhënave të fermës bujqësore;– të instalojë platformën dixhitale të përzgjedhur për grumbullimin dhe përpunimin dixhital të të dhënave të fermës bujqësore;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për dixhitalizimin e fermës bujqësore. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi përdor platformën dixhitale për menaxhimin e faktorëve të prodhimit në fermën bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përdorë platformën dixhitale për menaxhimin e informacionit për tokën bujqësore;	

- të instalojë platformën dixhitale për menaxhimin e makinerive bujqësore;
- të përdorë platformën dixhitale për monitorimin e kushteve agrometeorologjike në fushë, në serra dhe në stalla;
- të përdorë platformën dixhitale për menaxhimin e informacionit për plehërimin, ujitjen dhe mbrojtjen e bimëve;
- të përdorë platformën dixhitale për menaxhimin e informacionit për ushqyerjen, parametrat shëndetësorë, mjeljen dhe vendndodhjen e kafshëve në kullotë;
- të përdorë platformën dixhitale për monitorimin e kohës së vjeljes së prodhimeve bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ërdorimin e platformës dixhitale për menaxhimin e faktorëve të prodhimit në fermën bujqësore;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për përdorimin e platformës dixhitale për menaxhimin e faktorëve të prodhimit në fermën bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përdor pajisje e sensorë dixhitale për monitorimin e faktorëve të prodhimit në fermën bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë pajisje e sensorë dixhitalë për monitorimin e parametrave të tokës (temperaturë, lagështi, etj.);
- të përdorë pajisje e sensorë dixhitalë për monitorimin e makinerive bujqësore;
- të përdorë pajisje e sensorë dixhitalë për monitorimin e parametrave agrometeorologjikë (temperatura, rreshjet, lagështia e ajrit, ndriçimi diellor, shpejtësia dhe drejtimi i erës, evapotranspirimi etj.);
- të përdorë pajisje e sensorë dixhitalë për monitorimin e parametrave agrometeorologjikë në serra dhe në stalla;
- të përdorë pajisje dixhitale të thjeshta në fushë, serra dhe stalla si termohigrometra etj.;
- të përdorë pajisje dixhitale për monitorimin e sasisë së ushqyesve për plehërimin e bimëve;
- të përdorë pajisje dixhitale për monitorimin e sasisë së ujit për ujitjen e bimëve;
- të instalojë pajisje e sensorë dixhitalë për monitorimin e parametrave shëndetësorë të kafshëve në stallë, mjeljen dhe vendndodhjen e kafshëve në kullotë;
- të përdorë pajisje e sensorë dixhitalë për monitorimin e kohës së vjeljes të produkteve bujqësore;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përdorimin e pajisjeve e sensorëve dixhitale për monitorimin e faktorëve të prodhimit në fermën

- bujqësore;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për përdorimin e pajisjeve e sensorëve dixhitale për monitorimin e faktorëve të prodhimit në fermën bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përdorë rrjetet e informacionit dhe komunikimit dixhital për grumbullimin e informacioneve në fermën bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë rrjetet për komunikimin dixhital në fermën bujqësore (internet, rrjeti Wireless, rrjeti celular etj.);
- të analizojë rrjetet e informacionit dhe komunikimit që përdoren për dixhitalizimin e informacioneve;
- të përzgjedhë llojin e rrjetit të informacionit dhe komunikimit që do të përdorë për dixhitalizimin e të dhënave të fermës;
- të prezantojë rrjetet e informacionit dhe komunikimit të përzgjedhur për grumbullimin dhe përpunimin dixhital të të dhënave të fermës bujqësore;
- të përdorë rrjetet e informacionit dhe komunikimit të përzgjedhur për grumbullimin dhe përpunimin dixhital të të dhënave të fermës bujqësore;
- të përdorë aplikacionet që duhen për përcjelljen e informacionit në mënyrë dixhitale;
- të përdorë aplikacionet që duhen për përcjelljen dixhital të rrugë dixhitale të informacioneve;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me llogaritjet, kontabilizimin dhe rregullimin të marrëdhënieve me shtetin për TF;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për përdorimin e rrjeteve të informacionit dhe komunikimit dixhital për grumbullimin e informacioneve në fermën bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi grumbullon, sistemon dhe hedh të dhënat dhe informacionet e fermës bujqësore në platformën dixhitale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të grumbullojë të dhënat dhe informacionet e sektorëve prodhues të fermës (të dhëna financiare, të dhëna mbi prodhimin, të dhëna mbi tokën etj.);
- të komunikojë të dhënat e informacioneve nga sektorët prodhues të fermës në mënyrë dixhitale;
- të grupojë të dhënat e informacioneve nga sektorët

- prodhues të fermës në mënyrë dixhitale;
- të ngarkojë të dhënat dhe informacionet e sektorëve prodhues të fermës në platformën dixhitale të instaluar;
- të sistemojë të dhënat duke përdorur programe (software) të ndryshëm në kompjuter, laptop, etj.;
- të sistemojë informacione të tjera lidhur me aktivitetin e fermës duke përdorur programe (software) të ndryshëm në kompjuter, laptop etj.;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për grumbullimin, sistemimin dhe hedhjen e të dhënave dhe informacioneve të fermës bujqësore në platformën dixhitale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi përpunon informacionet e grumbulluara në mënyrë dixhitale për aktivitetin prodhues të fermës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë informacionin e grumbulluar në platformën dixhitale për menaxhimin e tokës bujqësore;
- të vlerësojë informacionin e grumbulluar në platformën dixhitale për menaxhimin e makinerive bujqësore;
- të gjykojë informacionin e grumbulluar në platformën dixhitale për monitorimin e kushteve agrometeorologjike në fushë, në serra dhe në stalla;
- të vlerësojë informacionin e grumbulluar në platformën dixhitale për menaxhimin plehërimit, ujitjes dhe mbrojtjes së bimëve;
- të analizojë informacionin e grumbulluar në platformën dixhitale për menaxhimin ushqyerjes, parametrave shëndetësorë, mjeljen dhe vend-ndodhjen e kafshëve;
- të analizojë informacionin e grumbulluar në platformën dixhitale për menaxhimin e kohës së vjeljes së prodhimeve bujqësore;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për përpunimin e informacioneve të grumbulluara në mënyrë dixhitale për aktivitetin prodhues të fermës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 7 Nxënësi përgatit raporte nga rezultatet e të dhënave nga platformat dixhitale për menaxhimin e fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë ndryshimet në përdorimin e tokës bujqësore;
- të evidentojë eficiencën e përdorimit të makinerive bujqësore;
- të përcaktojë ecurinë e kushteve agrometeorologjike në

lidhje me kultivimin e bimëve;

- të evidentojë efikasitetin e skemave të të ushqyerit të bimëve;
- të përcaktojë me saktësi sasinë e ujit për ujitjen e bimëve;
- të përcaktojë shkallën e përhapjes së dëmtuesve dhe dëmit mbi bimët bujqësore;
- të përcaktojë racionet ushqimore të kafshëve;
- të evidentojë parametrat shëndetësorë të kafshëve;
- të përcaktojë kohën më të përshtatshme të vjeljes së produkteve bujqësore sipas qëllimit të përdorimit;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së raporteve nga rezultatet e të dhënave nga platformat dixhitale për menaxhimin e fermës bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset mësimore, laboratorë të TIK ose në ferma reale.
- Ky modul kërkon, që rezultatet mësimore të realizohen online.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembujt konkretë dhe të nxisë kreativitetin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, duke evidentuar në kohë reale gjendjen e fermës, duke evidentuar rezultatet e monitorimeve dixhitale të faktorëve të prodhimit në fermën bujqësore.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë dhe bashkëpunojnë në lidhje me përdorimin e platformave dixhitale, instalimin e paisjeve monitoruese dixhitale dhe instalimin e aplikacioneve për transmetimin on line të informacioneve nga sektorët prodhues të fermës bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për instalimin e platformave dixhitale, paisjeve dixhitale monitoruese, aplikacioneve për përcjelljen në mënyrë dixhitale të informacioneve për menaxhimin dixhital të fermës bujqësore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisë mësimore në shkollë ose ferma reale.
 - Mjedisë pune me kompjutera, laptop dhe lidhje interneti
 - Programe të ndryshme kompjuterike për instalimin e platformave dhe aplikacioneve dixhitale.
 - Paisje dixhitale monitoruese dhe sensorë dixhitalë.
 - Katalogë, udhëzues mbi përdorimin e platformave dixhitale, paisjeve dixhitale dhe aplikacioneve dixhitale.
 - Informacione mbi menaxhimin dixhital.
 - Legjislacioni mbi dixhitalizimin e aktiviteteve prodhuese.
-

-
- Materiale të tjera udhëzuese.
 - Manualët e preventivimit dhe për zbrëthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli: “Kultivimi i luleve në mjedise të hapura”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KULTIVIMI I LULEVE NË MJEDISE TË HAPURA	M-14-146-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për kultivimin e luleve dekorative në mjedise të hapura.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi prodhon fidanë lulësh për mbjellje në fushë të hapur. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat dhe materialet për prodhimin e fidanëve të luleve;– të përcaktojë llojet e luleve sipas kushteve klimatiko- tokësore;– të përcaktojë saktë sasinë e farës për mbjellje sipas madhësisë së sipërfaqes dhe dendësisë së bimëve;– të zbatojë teknikën e përgatitjes së dherishten sipas raporteve të sakta të plehut dhe dheut;– të përgatisë shtartin e mjelljes sipas teknikës më të përshtatshme;– të zbatojë me korrektësi teknikën e mbjelljes së farës së luleve;– të zbatojë me korrektësi teknikën e mbulimit të farës;– të kryejë shërbimet në farishte pas mjelljes sipas kërkesës;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi kultivon me fidanë lule në mjedise të hapura. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat dhe materialet për mbjelljen e fidanëve;	

- të përcaktojë vendin për mbjelljen e fidanëve të luleve sipas kritereve të përcaktuara;
- të piketojë sipërfaqes për mbjelljen e fidanëve sipas kërkesës;
- të shkulë me kujdes fidanët;
- të përcaktojë fidanët e shëndetshëm për mbjellje;
- të mbjellë fidanët sipas distancave të përcaktuara;
- të kryejë ujitjen së lehtë e fidanëve të porsa mbjellë sipas nevojave;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të luleve me fidanë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kujdeset për rritjen e bimëve pas mbjelljes.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë veglat e dorës për kryerjen e shërbimeve pas mbjelljes së fidanëve;
- të kryejë kontrollim e zënies së fidanëve të mbjellë sipas teknikës përkatëse;
- të ujisë bimët lulore sipas nevojave specifike të tyre;
- të zëvendësojë bimët e thara me fidanë të rinj të shëndetshëm;
- të prashitë lulet me thellësinë e duhur sipas llojit të luleve;
- të bëjë plehrimin plotësues të luleve sipas kërkesave dhe dozave përkatëse;
- të shkullë dhe largojë barërat e këqia;
- të krasisë bimët gjatë vegjetacionit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatimi drejt rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve për rritjen e luleve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese, oborrin e shkollës e sipërmarrjet private të prodhimit të luleve e fermat pranë shkollës.
- Mësuesi/Instruktori mund të organizojë edhe vizita mësimore në sera ku prodhohen fidanë lulor dhe kopshte botanike dhe vende të tjera publike të zbukuruara me lule të ndryshme.
- Nxënësit duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e kultivimit të luleve njëvjeçare, dyvjeçare dhe shumëvjeçare. Kjo duhet të

përfshijë përgatitjen e tokës, mbjelljen e farës, mbjelljen e fidanëve dhe kujdesin për rritjen e tyre.

- Mësuesi/Instruktimi duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet praktike për përgatitjen e tokës për mbjellje, mbjelljen e farës, mbjelljen e fidanit dhe shërbimet pas mbjelljes. Ai duhet të nxisë fantazinë e nxënësve për ide racionale për prodhimin e luleve.
- Realizimi i pranuehëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqëshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe toke të caktuara në shkollë, fermë, qytet etj..
 - Katalogë për lulet, fotografi, diapozitiva.
 - Farëra të ndryshme lulore.
 - Plehra organike e minerale.
 - Metër-shirit.
 - Piketa.
 - Spango.
 - Tel, lopata, bela.
 - Gërshërë krasitjeje, brisqe, sharrë etj..
-

2. Moduli “Rritja e krimbit të mëndafshit dhe e kërmillit”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RRITJA E KRIMBIT TË MËNDAFSHIT DHE E KËRMILLIT	M-28-1844-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të mbarështuar në sisteme specifike krimbin e mëndafshit dhe kërmillin për prodhimin e fijes së mëndafshit për industrinë e pëlhurave dhe mishit të kërmillit për industrinë ushqimore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi/ja kryen procese pune të mbarështimit të krimbit të mëndafshit për prodhimin e fijes së mëndafshit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë karakteristikat e ambjenteve/terreneve për kultivimin e krimbit të mëndafshit;– të përzgjedhë saktë veglat e dorës për ndërtimin e ambjenteve/terreneve specifike për krimbin e mëndafshit;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës që do përdoren;– të zbatojë masat higjieno-sanitare gjatë kultivimit të krimbit të mëndafshit;– të garantojë rrethimin/izolimin e ambjentit kultivues për krimbin e mëndafshit;– të dezinfektojë me kujdes pa krijuar probleme për krimbin e mëndafshit duke përdorur për dezinfektim dezinfektues të lejuar;– të marrë masat për sigurimin e territorit pas dezinfektimit;– të përzgjedhë veglat e nevojshme të punës për të ushqyer krimbin e mëndafshit;– të përzgjedhë ushqimin sipas llojit dhe nevojës së krimbit të mëndafshit;– të bëjë higjienizim periodik të ambjenteve dhe mjeteve apo pajisjeve që përdoren në të ushqyerit e krimbit të mëndafshit;– të bëjë trajtim paraprak të ushqimeve që do përdoren për krimbin e mëndafshit;– të kontrollojë cilësisë e ushqimeve që do përdoren për	

krimbini e mendafshit;

- të mbledhë në mënyrë periodike fijen e mendafshit të prodhuar nga krimbi mendafshit,
- të vlerësojë cilësinë e fijen se mendafshit të prodhuar nga krimbi mendafshit
- të zbatojë metodologjinë e caktuar për mbledhjen e fijen se mendafshit.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë me përpikëmbëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të mbarështimit të kribit të mendafshit për prodhimin e fijen së mendafshit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi kryen procese pune të mbarështimit të kërmijve për mish.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë karakteristikat e ambjenteve/ terreneve për kultivimin e kërmijve;
- të përzgjedhë saktë veglat e dorës për ndërtimin e ambjenteve/ terreneve specifike për kërmijtë;
- të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës që do përdoren;
- të zbatojë masat higjieno-sanitare gjatë kultivimit të kërmijve;
- të garantojë rrethimin/ izolimin e ambjentit kultivues për kërmijve;
- të dezinfektojë me kujdes pa krijuar probleme kërmijve duke përdorur për dezinfektim, dezinfektues të lejuar;
- të marrë masat për sigurimin e territorit pas dezinfektimit;
- të përzgjedhë veglat e nevojshme të punës për të ushqyer kërmillin;
- të përzgjedhë ushqimin sipas llojit dhe nevojës së kërmillit.
- të bëjë higjienizim periodik të ambjenteve dhe mjeteve apo pajisjeve që përdoren në të ushqyerit të kërmijve;
- të bëjë trajtim paraprak të ushqimeve që do përdoren për kërmijtë;
- të kontrollojë cilësinë e ushqimeve që do përdoren për kërmijtë;
- të vlerësojë madësinë dhe peshën e kërmijve sipas standardeve përkatëse.
- të mbledhë dhe seleksionojë kërmijtë sipas kërkesave të tregut, mbajtja e kërmijve në dietë urie dhe pastrimi tyre;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë me përpikëmbëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës të mbarështimit të kërmijve për mish.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose në ferma që rrisin krimb mëndafshi ose kërmij.
- Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në ferma që kultivojnë krimbin e mëndafshit dhe kërmij duke iu dhënë mundësi nxënësve për të vrojtur konkretisht disa nga shërbimet që bëhen për kultivimin e tyre.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të përdorimit sa më të mirë të veglave të punës, orendive dhe pajisjeve në një fermë ku kultivohen krimbi mëndafshit ose kërmij si dhe të kryerjes së shëbimëve për rritjen ose zhvillimin e tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të kryerjes së shëbimëve për rritjen e krimbit të mëndafshit ose kërmijve vetëm në mbikqyrje të instruktorit apo specialistit të rritjes së krimbit të mëndafshit ose kërmillit.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për kryerjen e shëbimëve për rritjen e krimbit të mëndafshit dhe/ose kërmillit
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të kryerjes së shëbimëve për rritjen e krimbit të mëndafshit dhe/ose kërmillit
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kapanon për zhvillimin e krimbit të mëndafshit.
- Magazinë për depozitimin e ushqimit për krimbin e mëndafshit.
- Sharrë dore, çekiç, pinca, gozhdë, arka.
- Parcela me cilësi shumë të mirë toke.
- Rrjeta teli për të rrethuar parcelën e tokës.
- Sistem vaditës me pika për parcelën e tokës.
- Kazma, shatë për punimin e parcelës.
- Mjete të tjera vizuale.
- Video me demonstrime të ndryshme.

3. Moduli “Kompostimi i mbetjeve organike ”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KOMPOSTIMI I MBETJEVE ORGANIKE	M-14-1964-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer ruajtjen e ftohtë e të ngrohtë të plehut organik të stallës, si dhe për përgatitjen e kompostove si dhe përpunimit të mbetjeve organike.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi/ja duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përgatitet për ruajtjen e plehut organik të stallës. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën e punës;– të realizojë me korrektësi radhën e përgatitjes për punë;– të caktojë vendin e ruajtjes së plehut pranë një stalle ose mbeturinave bimore;– të për zgjedhë materialet dhe veglat e duhura të punës; cfurqe, bela, lopata, plehëra organikë, kashtë, plehëra qyteti;– të transportojë me kujdes veglat dhe mjetet e punës në vendin e caktuar;– të grumbullojë plehun, kashtën, mbetjet e zonës etj, në vendin e caktuar– të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës.– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për ruajtjen e plehut; <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2	Nxënësi kryen ruajtjen e ftohtë (anaerobike) të plehut të stallës. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet dhe veglat e duhura të punës: cfurqe, bela, lopata, plehëra organikë, kashtë, plehëra qyteti;
- të vendosë një shtresë pleh stalle dhe një shtresë kashtë në kavaletë;
- të ngjeshë kavaletin me këmbë ose me mjete të tjera;
- të mbulojë kavaletin me një shtresë dheu 5–8 cm;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ruajtjes së ftohtë të plehut;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen ruajtjen e ngrohtë (aerobike) të plehut të stallës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e duhura të punës: cfurqe, bela, lopata, plehëra organikë, kashtë, plehëra qyteti;
- të vendosë një shtresë plehun e stallës dhe një shtresë kashtë në kavaletë pa u ngjeshur në kushte të mira ajrimi.
- të mbulojë kavaletin ;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik, shëndetësor dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ruajtjes së nxehtë të plehut;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi përgatit komposto me mbeturina bimore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e duhura të punës;
- të grijë kashtën sipas kërkesave;
- të lagë kashtën me një sasi të caktuar uji;

- të vendosë në shtresë masën me trashësi 10 – 15 cm;
- të përziejë masën me plehëra minerale (azotike, fosforike, potasike) ose organike. ;
- të vendosë shtresa të tjera pjesë-pjesë deri sa të bëhet kavaleti;
- të mbulojë kavaletin me shtresë dheu 5 – 8 cm;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kompostos me mbeturina bimore;

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi/ja përgatit komposto me plehërat e zones.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e duhura të punës;
- të grumbullojë plehërat dhe fekalet e banesave përreth
- të pastrojë plehun dhe mbeturinat nga materialet joorganike (qelq, gurë, lëndë plastike, metale) ;
- të përcaktojë raportin pleh – fekalet: 60-70% pleh me 40- 30% fekalet;
- të përziejë mirë plehun me fekalet;
- të vendosë masën në shtresa (kavalet) pjesë-pjesë;
- të ngjeshë kavaletin;
- të mbulojë me shtresë dheu 5 – 8 cm;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kompostos me plehërat e qytetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë stallave dhe mbeturinave të ndryshme bimore të rajonit.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove me mbeturina të ndryshme.

-
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
 - Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove me mbeturina të ndryshme.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë si dhe të përgatitjes së kompostove.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës pranë stallave dhe mbeturinave të ndryshme bimore e të qytetit.
 - Kompleti i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për ruajtjen e ftohtë dhe të ngrohtë të plehut të stallë dhe përgatitjen e kompostove.
 - Plehra organike.
-

4. Moduli: “Kultivimi i bimëve aromatike dhe mjekësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KULTIVIMI I BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE	M-14-1865-23
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore sipas standarteve të caktuara.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi/ja duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kultivon bimët aromatike dhe mjekësore. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për punimin e tokës;– të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur ;– të pastrojë me kujdes tokën nga gurët dhe mbeturinat e tjera të forta;– të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehëra organike dhe minerale;– të kryejë punimin bazë të tokës;– të kryejë punimin plotësues të tokës;– të kontrollojë cilësinë e kryerjes së punimeve sipas instruksionit të përcaktuar;– të kryejë mbjelljen e farave sipas mënyres, kohës dhe distancave të mbjelljes;– të kryejë shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm; të pastrojë dhe sistemojë vendin punës;– të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore; <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2 Nxënësi ruan bimët aromatike dhe mjekësore pas vjeljes. <i>Kriteret e vlerësimit:</i>	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë mjetet dhe pajisjet për vjeljen, përpunimin dhe ruajtjen e bimëve aromatike dhe mjeksore;
- të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vendin e duhur ;
- të përcaktojë sakë kohë e vjeljes së bimëve aromatike dhe mjeksoret;
- të kryejë vjeljen e bimëve aromatike dhe mjeksore sipas standartit;
- të kryejë tharjen dhe përpunimin e prodhimit të vjelë
- të kryejë paketimin e prodhimit të tharë në qese sipas standartit;
- të kryejë ruajtjen e prodhimit të paketuar në kushte të përshtatshme;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vjeljes përpunimit dhe ruajtjes së bimëve aromatike dhe mjeksore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës (mjedise të mbrojtura ose fushë e hapur), në ekonomi bujqësore ku kultivohen bimët aromatike dhe mjeksore.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kultivimin e bimëve aromatike dhe mjeksore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e një sërë operacionesh pune për kultivimin e bimëve aromatike dhe mjeksore, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas të pavarur.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës dhe rëndësinë e kryerjes së tyre.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve gjatë kultivimit të bimëve aromatike dhe mjeksore.
- Mësuesi/Instruktori mund të organizojë vizita mësimore në kultivues të suksesshëm të bimëve aromatike dhe mjeksore në mënyrë që nxënësit të shohin dhe të praktikohen në proceset e punës së përgatitjes së tokës për mbjelljen e bimëve aromatike dhe mjeksore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Pleh stalle , plehra kimike.
 - Fara të ndryshme.
 - Preparate dezinfektuese.
 - Uniforma e punës
 - Vegla të thjeshta dhe të mekanizuara .
 - Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë etj.
 - Pompa spërkatëse.
-

5. Shtimi me copa i kulturave bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHTIMI ME COPA I KULTURAVE BUJQËSORE	M-14-1847-23
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të shtuar kulturave bujqësore me copa të thjeshta, kamza dhe përpaja.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV I KSHK..	
Rezultatet e të nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi shton me anë të copave të thjeshta bimët <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën e punës;– të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet e nevojshme për mbjelljen e copave të thjeshta të bimëve zbukuruese;– të marrë copat e thjeshta nga bimët mëmë sipas kriterëve dhe llojit të bimëve zbukuruese;– të përcaktojë ngastrën për copëtore sipas parametrave të kërkuara;– të përgatisë vazot për mbjellje copave sipas radhës së punës: mbushje, pastrim dhe plehërim etj duke iu përmbajtur kriterëve;– të mbjellë në çdo vazo në thellësinë e caktuar copëzat;– të ngjeshë mirë dhe të mbulojë me dhë të shkrifët çdo copat të mbjellë.– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizem të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës.– të pastrojë dhe sistemojnë vendin e punës;– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së copëzave të pemëve frutore. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.
	RN 2	Nxënësi shton kulturat drufrutore me anë të kamzave. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet e nevojshme për mbjelljen e kamzave të thjeshta të drufrutore;
- të marrë kamzat nga bimët mëmë sipas kritereve dhe llojit të pemës frutore;
- të përcaktojë ngastrën për mbjelljen e kamzave sipas parametrave të kërkuara;
- të përgatisë ngastrën për mbjellje sipas radhës së punës: punim; pastrim dhe plehërim etj duke iu përmbajtur kritereve;
- të piketojë ngastrën duke ruajtur largësinë konstante midis rrjeshtave dhe midis kamzave në rresht;
- të marrë kamzat nga pemët mëmë sipas kritereve dhe llojit të pemës frutore duke zbatuar me rigorozitet teknikën e marrjes;
- të mbjellë në çdo gropë në thellësinë e caktuar kamzat;
- të ngjeshë mirë dhe të mbulojë me dhe të shkrifët çdo kamëz;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së kamzave të pemëve frutore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi shton me përpaja kulturat drufrutore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për mbjelljen e përpajave;
- të përzgjedhë bimën ku do të merret përpaja sipas karakteristikave përkatëse;
- të hapë kanal sipas udhëzimeve për mbjelljen e përpajave;
- të vendosë përpajën në thellësinë e caktuar në kanal dhe të nxjerrë pjesën e majës jashtë;
- të mbulojë me dhe të shkrifët dhe të ngjeshë çdo përpajë;
- të vendosë kunjin pranë pjesës së dalë mbi tokë të përpajës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtrirjes së përpajës së thjeshtë për rrenjëzim;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**zbatimin e modulit
dhe për vlerësimin
e nxënësve.**

ose pranë saj, në ferma ku realizohet mbjellja e me kulturave bujqësore të ndryshme.

- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për mbjelljen e copave të thjeshta, kamzave dhe përpajave të me kulturave bujqësore të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për shtimin e drufrutorëve me copa fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me shtimin e me kulturave bujqësore të ndryshme me copa.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për shtimin e me kulturave bujqësore të ndryshme me copa;
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Parcela e mbjellë me pemë frutore të ndryshme
 - Komplet i veglave, veshjes, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për shtimin e pemëve frutore me copa.
 - Plehra të ndryshme organike e minerale.
 - Katalogë dhe manuale për teknikat e shtimit të pemëve frutore me copa të thjeshta.
 - Material mbjellës si copa, kamza, përpaja, copa kercej luleve etj.
 - Hunj mbështetës.
-

6. Moduli “Mbjellja e fidanëve të hardhisë”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	MBJELLJA E FIDANËVE TË HARDHISË	M-14-150-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të hapur gropën, përgatitjen e fidanit, si dhe për të zbatuar teknikat e mbjelljes së fidanit të hardhisë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV I KSHK..	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi hap gropën për mbjelljen e fidanit. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë saktë veglat e duhura të punës për hapjen e gropës: dërrasë mbjellëse, piketa, lopata, bela, hunj, lidhës, gëlqere, furçë dhe përzierje bajgë + deltinë;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës;– të caktojë në vend të përshtatshëm për hapjen e gropës për mbjelljen e fidanit të hardhisë;– të piketojë në largësi të caktuar, sipas llojit ose kultivarit duke respektuar distancat e mbjelljes;– të hapë gropën me vegla dore duke hedhur dheun në të dy krahët e gropës sipas teknikës së duhur, si dhe duke respektuar thellësinë e hapjes;– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;– të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;– të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hapjes së gropës për mbjelljen e fidanit; <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi përgatit fidanin për mbjellje. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë llojin e fidanit frutor për mbjellje sipas kushteve klimatiko-tokësore;– të nxjerrë me shumë kujdes fidanët nga shtratifikimi;– të kontrollojë sistemin rrënjor të fidanëve dhe të pastrojë ato;– të zhytë fidanët në ujë për 1-2 ditë;	

- të rifreskojë sistemin rrënjor duke shkurtuar rrënjët e dëmtuara;
- të zhytë sistemin rrënjor në përzierjen bajgë-deltinë dhe ujë sipas raporteve të përcaktuara;
- të transportojë fidanët me kujdes në vendin e mbjelljes;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së fidanëve për mbjellje;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi mbjell fidanin e hardhisë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpërndarjë plehun organik dhe mineral pranë gropa të hapura sipas sasisë së nevojshme.
- të përzierjë në mënyrë të njëtrajtshme dheu e sipërfaqes me plehrat organo-minerale;
- të kryejë mbushjes së gropës me dheun e sipërfaqes së përgatitur në 2/3 e thellësisë së saj;
- të përcaktojë qendrën e gropës ku do të mbillet fidani me përdorimin e dërrasës mbjellëse dhe ngulja e hurit në thellësi të gropës;
- të mbjelljë fidanin sipas teknikës së mbjelljes së fidanëve frutorë; të mbushë gropë me pjesën tjetër të dheut duke lënë pikën e shartimit 7-8 cm mbi rrafshin e tokës
- të lidhë fidanin me hurin në formë tete pak të lirë;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së mbjelljes së fidanëve frutorë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale pranë shkollës ose jashtë saj.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave të ndryshme të mbjelljes së fidanë ve frutorë.
- Të diskutohen metoda për teknikën më të përshtashme të mbjelljes së fidanëve frutorë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të hapjen e gropës, përgatitjen fidanit dhe mbjelljen e tij, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së

arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për të kryerjen e mbjelljes së fidanit të hardhisë.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe toke.
- Fidanë hardhie.
- Vegla të punës për hapjen e gropës dhe mbjelljen e fidanëve.
- Dërrasa mbjellëse.
- Lidhëse
- Hunj
- Piketa
- Gëlqere
- Bajgë, deltinë
- Gërshërë krasittëse etj.

7. Moduli “Rritja dhe kujdesi për bletët ”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	RRITJA DHE KUJDESI PËR BLETËT	M-28-1965-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të rritur dhe kujdesur për bletën, si dhe mbarështimin e saj.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV I KSHK..	
Rezultatet e të nxënëtit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përgatit ambjentet për rritjen e bletës Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë vendin e përshtatshëm për rritjen e bletës;– të perzgjedhë saktë veglat e pajisjet për rritjen dhe kujdesin e bletëve;– të veshë uniformen e punës;– të përgatisë vendin ku do vëndosën kosheret/zgjoit e bletëve;– të përgatisë kosheret/zgjoin sipas standartit;– të vendosë kosheret në kundrejtim nga drejtimin jugore;– të përgatisë kornizat e bletëve;– të vendosë kornizat në koshere sipas rradhës;– të marrë masat për sigurimin e territorit për rritjen e bletëve.– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;– të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;– të zbatojë me përpikëmeri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ambjenteve për rritjen e bletëve. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2 Nxënësi kryen ushqyerjen e bletëve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të perzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për të ushqyer bletët;– të veshë uniformën e punës;– të perzgjedhë ushqimin sipas llojit dhe nevojës së bletëve;	

- të bëjë higjienizimn e enëve që përdoren për të ushqyerit e bletëve;
- të përgatisë shërbetin për të ushqyer bletët;
- të kryejë tymosjen e kosherës;
- të hapë kapakun e kosherës;
- të vendosë ushqimin në vëndin e caktuar;
- të vendosë kapakun e kosherës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojë vëndin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të bletëve;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi/ja kujdeset për riprodhimin e bletëve

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë rroba te pastra para fillimit të punës;
- te percaktoje fazat e ciklit jetesor të bletës;
- të percaktojë kohën zhvillimit të mëmës;
- të vëzhgoje fazën e vendosjes së vezëve në hoje;
- të monitoroje procesin e çeljes së vezëve,formimi i varvave dhe bletëve punëtore;
- të pastrojë zgjoin nga mbeturinat dhe insektet që formohen brenda në zgjua;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojë vëndin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për riprodhimin e bletëve .

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi/ja kryen kontrollin shëndetësor të bletëve.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë rroba të pastra para fillimit të punës;
- të kontrollojë funksionimin e sistemit te ajrimit të zgjoit
- të kontrollojë lagështirën e zgjoit;
- të kryejë ajrimin e zgjoit;
- të vendosë ujit afër zgjoit;
- te kontrollojë sasinë e ushqimit të zgjoit;
- te kontrollojë për sëmundje dhe dëmtues të ndryshëm koloninë e

- bletëve;
- të kryejë trajtimin e nevojshëm për sëmundjet dhe dëmtuesit e bletës;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për bletët;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

<p>Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktika të fermës parqet e bletëve të shkollës ose pranë saj që merren me rritjen e bletëve. – Rekomandohet të organizohet – en edhe vizita në ferma private ku aplikohen rritja e bletëve. – Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet konkrete të metodave për rritjen, ripodhimin dhe kujdesin e bletëve . – Nxënësit, nxiten të diskutojnë mbi mënyrën e rritjes dhe kujdesit të bletëve. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete punë për të kryer higjienizime të ambjenteve, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjeteve që përdoren, në rritjen dhe kujdesin për bletën. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e rritjes dhe kujdesit të bletës. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Parqe bletësh – kapela e bletarit, pajisja speciale për tymosjen e kosheres, thika e bletarit – Mjetet për të ushqyerit e bletëve: ushqyesja për bletë; – Mjetet për vendosjen e hojeve artificiale – korniza, këllëfi për korniza, transformatori i rrymës, etj; – Arkat, sëndukët dhe zgjoi; – Mjetet për transportin e mbretëreshave: koshere dhe rrjetat; – Doreza – Kova uji

8. Moduli “Mbarështimi i shpendëve shtëpiakë”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 11

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MBARËSHRIMI I SHPENDËVE SHTËPIAKË	M-28-1849-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të mbarështuar ne sisteme gjysem intensive ose ekstensive shpendë shtëpiakë (fazane, pula, pata, rosa etj.,) për prodhim mish dhe për prodhim vezësh.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimor	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.10-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi/ja përgatit mjediset për mbarështimin e shpendëve shtëpiakë.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë karakteristikat e kapanonit për rritje fazanesh, pula indi, pata, rosa etj.;– të përzgjedhë saktë veglat e dorës për dezinfektim;– të kontrollojë gjendjen fizike të veglave të punës që do përdoren;– të përgatise pompën dizinfektuese me dezinfektantë të lejuar;– të dezinfektojë me kujdes ambientet e brendshme dhe territorin përreth; të shtrojë shtresat me tallash brenda kapanonit;– të largojë në kohën e duhur plehun nga stalla;– të bëjë pastrimin e vendin të hedhjes së plehut për ruajtjen e mjedisit;– të marrë masat për sigurimin e territorit pas dezinfektimit;– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;– të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;– të zbatojë me përpikëmeri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së mjedisit për mbarështimin e shpendëve të tjerë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi ushqen shpendët shtëpiakë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë veglat e nevojshme të punës për të ushqyer fazane, pula indi, pata, rosa etj.;
- të përzgjedhë ushqimin sipas llojit dhe nevojës së fazaneve, pulave te indi, patave, rosa etj.;
- të bëjë higjienizimn e perditshem te enëve qe perdoren per te ushqyerit e fazaneve, pulave te indi, patave, rosave etj.;
- të bëjë përpunimin paraprak të ushqimeve qe do perdoren;
- të kontrollojë cilësisë e ushqimeve të magazinuara me anë të prekjes, nuhatjes dhe dallimit të ngjyrës së ushqimeve;
- të transportojë ushqimet nga magazina në kaponon ne menyre te pershtatshme;
- të shperndaje racionet ushqimore bazuar nevojave të fazaneve, pulave te indi, patave, rosa etj.;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë të ushqyerit të fazaneve, pulave te indi, patave, rosa etj.;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kujdeset për riprodhimin shpendëve shtëpiakë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë rroba të pastra para fillimit të punës;
- të përcaktoje fazat e ciklit jetësor të fazaneve, pulave, patave, rosa etj.;
- të përcaktojë kohën kur fazanet, pulat, patat, rosat, etj., pergatiten per çelje vezesh;
- të pershkruaj elementet përbëres të inkubatorit;
- të higjienizojë inkubatorin para vendosjes së vezeve brenda tij.;
- të monitorojë temperaturën e inkubatorit gjatë inkubimit të vezeve;
- të përkujdeset për zogjtë e sapo çelur;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojnë dhe sistemojë vendin e punës;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kujdesit për riprodhimin e shpendëve të tjerë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen kontrollin shëndetësor të shpendëve shtëpiakë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë rroba të pastra para fillimit të punës;
- të kontrollojë funksionimin e sistemit të ventilimit
- të kontrollojë funksionimin e shpërndarjes së ujit
- të kontrollojë konsumimin e ujit nga fazanet, pulat, patat, rosat etj.;
- të kontrollojë sasinë e ushqimit të ngrënë nga fazanet, pulat, patat, rosat etj.;
- të kontrollojë nëse fazanet, pulat, patat, rosat, etj.; kane diarre apo jo;
- të kontrollojë rregullsinë e vezes së prodhuar nga fazanet, pulat, patat, rosat etj.;
- të kontrollojë menyren e levizjes të sjelljes së fazaneve, pulave, patave, rosave etj.;
- të kontrollojë mënyrën e qendrimit të fazaneve, pulave, patave, rosave, etj.;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kontrollit shëndetësor të shpendëve të tjerë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi grumbullon vezët nga shpendët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbledhë vezët e fazaneve, pulave, patave, rosave etj.;
- të pastojë vezët e fazaneve, pulave te indi, patave, rosave, etj., nga papasterti të mundshme;
- të largojë vezet e thyera;
- të seleksionojë vezët bazuar madhësinë që kanë;
- të vensosë vezët në bikerina apo mjete të tjera mbajtëse;
- të vendosë vezët për magazinim bazuar standardeve higjienike të kerkuara;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;
- të respektojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit të vezëve nga shpendët e tjerë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale të fermës blegtorale të shkollës ose pranë saj me shpernde si fazane, pula indi, pata, rosa, etj.,
- Rekomandohet të organizohen edhe vizita në ferma private ku aplikohen mbareshtimi i fazaneve, pulave të indi, patave, rosave, etj..
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet konkrete të metodave për mbarëshkrimin, riprodhimin dhe prodhimin të produkteve të perftuara nga fazane, pula indi, pata, rosa, etj.,.
- Nxënësit, nxiten të diskutojnë mbi metodat e mbarshimit të fazaneve, pulave të indi, patave, rosave, etj., dhe interesit ekonomik nga ky aktivitet.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer grumbullimin e vezeve, higjienizime të ambjentëve mbarshuese, mirmbajtjen e pajisjeve dhe mjeteve që përdoren.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e mbarshimit të fazaneve, pulave të indi, patave, rosave, etj.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kompleks për mbarshim të fazaneve, pulave të indi, patave, rosave, etj.
 - Ambjente frigoriferike
 - Mjete për grumbullimin e vezeve
 - Pastrues për vezët
 - Inkubator për celje vezesh
 - Lampa infrarëd
 - Dezinfektantë.
 - Doreza
 - Dezinfektantë
 - Pompe dezinfektimi
 - Peshqire, sapun, kova uji.
 - Ene për dhenien e ushqimit
 - Kafaze, etj.
-

9. Moduli “Përpunimi i bimëve aromatike dhe mjekësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Kl asa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRPUNIMI I BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE	M-14-1966-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer mbledhjen seleksionimin dhe tharjen e bimëve aromatiko-mjekësore sipas zonave.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN)dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përcaktojnë vendin e mbledhjes së bimëve aromatike dhe mjekësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet dhe materialet e domosdoshme që nevojiten për mbledhjen si: dorashka, kosha, gërshërë, spango etj;– të vlerësojnë zonën ku ndodhen bimët aromatike-mjekësore;– të transportojë me kujdes mjetet dhe materialet e nevojshme;– të përcaktojnë bimët aromatike-mjekësore që do të mbledhen;– të rrethojnë me kujdes vendin ku ndodhen bimëtaromatike-mjekësore;– të pastrojnë zonën nga bimët helmuese dhe papastërtitë etj;– të marrin masa për parandalimin e rasteve të pakujdesisë;– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;– të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës;– të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi mbledhin bimë aromatike dhe mjekësore. bujqësore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojnë llojin e bimëve aromatike për erëza sipas	

- llojit që ka zona;
- të përcaktojnë llojin e bimëve mjekësore sipas llojit që ka zona;
 - të përcaktojnë fazën e zhvillimit vjetor në varësi të llojit të bimës (formim gjethesh, lulëzim, pjekje);
 - të përcaktojnë kohën e mbledhjes së bimëve sipas kritereve (mëngjes, agim, mbrëmje) duke iu përshtatur llojit të kulturës;
 - të mbledhin bimët e përcaktuara sipas procedurës;
 - të vendosin bimët e mbledhura me kujdes në vendin e caktuar në fushë, mundësisht në hije;
 - të rendisin bimët e mbledhura sipas përkatësisë së përdorimit me shumë kujdes;
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me mbledhjen e bimëve aromatike dhe mjekësore;
 - të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
 - të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë mbledhjes së bimëve aromatike dhe mjekësore

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryejnë përpunimin dhe tharjen e bimëve aromatike dhe mjekësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të transporojnë pa firo materialin nga fusha në vendin e përpunimit;
- të selekcionojnë me kujdes bimët e dobëta dhe të sëmura;
- të veçojnë organet e bimës që nuk janë objekt i përpunimit;
- të coptohen kërcejtë dhe rrënjët që dotë përpunohen për të patur një ekspozim sa më të gjerë në procesin e tharjes;
- të përgatisin lokalin, hambarin, trinat për procesin e tharjes në hije sipas kushteve që përmbush zona;
- të vendosin bimët në korniza me rrjetë teli apo pëlhure sipas teknologjisë të përcaktuar;
- të zbatohet kohëzgjatja e tharjes sipas gjëndjes së lokalit, kushteve të motit dhe llojit të bimës, e cila zgjat 3–7 ditë;
- të përziejnë materialin bimor 3–4 herë në ditë, deri sa kërcejtë të thyhen lehtë;
- të mbledhin materialin e tharë në grumbuj dhe formë dengu;
- të ruajnë dengjet në lokale të thata dhe të ajrosur mirë deri në tërheqjen e materialit të tharë sipas mënyrës së përdorimit;

- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përpunimin dhe tharjen e bimëve aromatike dhe mjekësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizem;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit dhe tharjes së bimëve aromatike dhe mjekësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në zonat përreth.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për mbledhjen e përpunimin dhe ruajtjen e materialit bimor si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve në lidhje me to.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e përgatitjes së procesit të mbledhjes , përpunimit dhe ruajtjes të materialit bimor, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve për përgatitjen gjithë procesit të mbledhjes , grumbullimit, seleksionimit dhe tharjes përfundimtare të bimëve .
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mjeteve të domosdoshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për mbledhjen,dhe përpunimin e bimëve aromatike.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Fermë me bimë aromatike dhe mjekësore.
 - Vegla dhe pajisje punë për mbledhjen dhe përpunimin e bimëve aromatike dhe mjekësore.
 - Hangarë, depo etj., ër të kryer tharjen e materialit.
 - Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
 - Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të bimëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

10. Moduli: “Prezantimi në panairë të produkteve bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PREZANTIMI NË PANAIRE I PRODUKTEVE BUJQËSORE	M-17-1967-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i përgatit nxënësit të kryejnë veprimet e përgatitjes së standave, të materialeve të shkruara të reklamës dhe promocionit për pjesëmarrje në panairë, të kryejnë veprimet dhe bisedat e shitjes në panair, si dhe veprimet e nevojshme pas panairit, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me prezantimin në panairë të produkteve bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të Profilit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi kryen hartimin e konceptit, llogaritjen e kostove dhe aplikimin për pjesëmarrje në panair. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për hartimin e konceptit, llogaritjen e kostove dhe pjesëmarrjes në panair;– të përcaktojë qartë mesazhin që do të përcillet në panair nga ferma bujqësore në lidhje me veprimtarinë dhe identitetin e saj;– të hartojë një slogon, i cili të shprehë saktë, qartë dhe në mënyrë të koncentruar mesazhin e përcaktuar për fermën, produktin dhe imazhin e saj;– të hartojë lista të sakta dhe të plota të detyrave që duhet të kryhen për përgatitjen e produkteve bujqësore që do të prezantohen në panair;– të kryejnë qartë ndarjen e detyrave, përcaktimin e afateve kohore sipas tyre dhe caktimin e përgjegjësive përkatëse për përmbushjen e detyrave për përgatitjen për panair;– të përcaktojë rregulla dhe përgjegjësi të sakta për raportimin periodik mbi ecurinë e përgatitjeve;– të hartojë lista të plota të materialeve që duhen për realizimin e panairit ku të evidentojë qartë për secilin burimin nga do të sigurohet;– të evidentojë qartë listën e materialeve që do të porositen tek organizatorët e panairit;– të llogarisë saktë dhe hartojë pasqyra të qarta të kostove të panairit, duke pasqyruar edhe mënyrën e parashikuar për mbulimin e tyre;	

- të hartojë planin e saktë të transportit të materialeve për në panair, si dhe përgjegjësitë përkatëse;
- të hartojë saktë kërkesën për pjesëmarrje në panair dhe dërgojë atë tek organizatorët e panairit, të shoqëruar me informacionet e kërkuara për fermën bujqësore;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjeve për pjesëmarrje në panair.
- të respektojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjeve për pjesëmarrje në panair.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi realizon standën e panairit, materialet e shkruara si dhe prezantime e materiale të tjera plotësuese.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e standës së panairit, materialeve të tjera për pjesëmarrjen në panair;
- të përcaktojë mënyrën se si do të përcillet nga stenda mesazhi i fermës bujqësore;
- të përcaktojë përmbajtjen e prezantimeve elektronike ose reklamave filmike;
- të përcaktojë saktë ngjyrat, skemën, materialet, pajisjet e standës;
- të bëjë ndarjen e detyrave për përpunimin e pjesëve përbërëse të standës (materialet në kompjuter, printimin, etj);
- të përcaktojë saktë dhe qartë përmbajtjen, strukturën dhe paraqitjen e prezantimeve elektronike dhe audiovizive që do të prezantohen në panair;
- të hartojë lista të sakta dhe të plota të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive për përgatitjen e prezantimeve elektronike dhe audiovizive;
- të hartojë planin e detajuar kohor të raportimit periodik mbi ecurinë e punës për përgatitjen e standës dhe prezantimeve;
- të përpunojë katalogun e panairit, duke respektuar rregullat mbi elementët e domosdoshëm të tij;
- të hartojë fletëpalosje dhe materiale të tjera reklamuese edhe informuese, në sintoni me mesazhin që do të përcillet, ngjyrat dhe sloganin e panairit;
- të hartojë oferta speciale, të qarta dhe të sakta, për panairin;
- të hartojë kartvizitat dhe materiale të tjera informative për agjencinë ose personelin e saj;
- të printojë dhe përgatisë materialet e shkruara në formën e duhur;
- të përcaktojë mënyrën e veshjes në panair në sintoni me sloganin, veprimtarinë e fermës bujqësore dhe mesazhin që kërkohet të përcillet;

- të sigurojë në kohë veshjet e caktuara për panair dhe materialet e nevojshme për montimin e standës;
- të paketojë dhe përgatisë për transport materialet e shkruara dhe të standës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me realizimin e standës së panairit, materialeve të shkruara, prezantimeve dhe materialeve të tjera plotësuese;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë realizimit të standës së panairit, materialeve të shkruara si dhe prezantimeve dhe materialeve të tjera plotësuese;
- të respektojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të standës së panairit, materialeve të shkruara, prezantimeve dhe materialeve të tjera plotësuese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi kryen planifikimin dhe ndarjen e punës, për montimin e standës gjatë panairit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për montimin e standës së panairit;
- të hartojë lista të detajuara të detyrave për montimin e standës;
- të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për marrjen dhe përcjelljen e informacionit gjatë panairit;
- të përcaktojë personat përgjegjës dhe detyrat për mbarëvajtjen e prezantimeve elektronike gjatë panairit;
- të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për pritjen dhe informimin e klientëve në standë;
- të përcaktojë detyrat dhe grupin e punës për prezantimin dhe reklamimin e fermës bujqësore dhe produkteve të saj gjatë panairit;
- të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për kryerjen e shitjeve dhe dokumentimin e tyre, gjatë panairit;
- të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për mbajtjen e marrëdhënieve me bankën.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kryerjen e planifikimit dhe ndarjes së punës për montimin e standës në panair;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë planifikimit dhe ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiave, për montimin e standës gjatë panairit;
- të respektojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së planifikimit dhe ndarjes së punës për montimin

e standës në panair.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi prezanton standën, realizon promovimin dhe reklamimin e produkteve bujqësore gjatë panairit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për prezantimin e standës, realizimin e reklamës dhe promovimit të produkteve bujqësore gjatë panairit;
- të kryejë saktë procedurën e regjistrimit të fermës bujqësore në panair;
- të njihet me rregullat e panairit;
- të firmosë formularin përkatës të panairit.
- të kryejë procedurën e plotë të marrjes në dorëzim të materialeve të porositura;
- të montojë saktë standën sipas ndarjes së parashikuar të detyrave;
- të kryejë përgatitjet e nevojshme për vendosjen e prezantimeve elektronike dhe provën e tyre;
- të përgatisë dhe vendosë materialet e planifikuar në tavolinën e punës;
- të pastrojë mjedisin e standës dhe largojë mbeturinat;
- të kryejë saktë promocionin dhe reklamimin e fermës bujqësore dhe produkteve të saj gjatë panairit;
- të kryejë saktë promocionin dhe reklamimin e fermës bujqësore dhe produkteve të saj në standat e firmave të tjera gjatë panairit;
- të kryejë saktë promocionin dhe reklamimin e fermës bujqësore dhe produkteve të saj, gjatë panairit, me anë të prezantimeve elektronike ose audiovizuale duke zbatuar rregullat mbi formën, zërin etj;
- të kryejë saktë promocionin dhe reklamimin e fermës bujqësore dhe produkteve të saj nëpërmjet shpërndarjes së dhuratave në mënyrë sa më efektive;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me prezantimin e standës, promovimin dhe reklamimin e fermës bujqësore dhe produkteve të saj gjatë panairit;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë prezantimit të standës, promovimit dhe reklamimit të fermës bujqësore dhe produkteve të saj.
- të respektojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë prezantimit të standës, promovimit dhe reklamimit të fermës bujqësore dhe produkteve të saj gjatë panairit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi realizon shitjet dhe veprimet pas panairit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e shitjeve të produkteve bujqësore gjatë panairit;
- të hartojë kontrata të plota dhe të sakta shitblerjeje me firmat pjesëmarrëse në panair;
- të kryejë, duke respektuar procedurën dhe plotësuar gjithë dokumentet e duhura, blerje për personelin dhe fermën gjatë panairit;
- të kryejë, duke respektuar procedurën dhe plotësuar gjithë dokumentet e duhura, shitje me karta krediti për personelin dhe vizitorët e panairit;
- të regjistrojë saktë shitjet e kryera me karta krediti në formularët përmbledhës përkatës;
- të hartojë faturën e saktë përmbledhëse të shitjeve të panairit me karta krediti dhe kuadrojë atë;
- të kryejë regjistrimet e sakta dhe të plota të shitjeve të panairit në regjistrat përkatës dhe kartelat e magazinës;
- të plotësojë saktë UXH (urdhër xhirimet) për blerjet e kryera me pagesë të mëvonshme;
- të regjistrojë arkëtimet nga shitjet me pagesë të menjëhershme dhe të mëvonshme;
- të llogarisë saktë rezultatin ekonomik të panairit;
- të hartojë statistika të sakta, të plota dhe domethënëse mbi veprimet e panairit;
- të analizojë shitjet sipas mallrave dhe grupmallrave dhe evidentojë mallrat më të shitura, mallrat që kërkojnë ndryshime në çmime, etj.;
- të interpretojë saktë statistikat e hartuara për efekt të vlerësimeve dhe krahasimeve me periudhat e kaluara.
- të çmontojë stendën dhe të sistemojë materialet për ti transportuar pas mbylljes së panairit;
- të pastrojë mbeturinat e stendës pas përfundimit të panairit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me realizimin e shitjeve dhe kryerjes së veprimeve pas panairit;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të kontratave të shitblerjeve, kryerjes së shitjeve dhe veprimeve pas panairit;
- të respektojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të shitjeve dhe kryerjes së veprimeve pas panairit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin

- Ky modul duhet të trajtohet në klasa të pajisura me kompjuter, printer, materiale zyre.
- Për vetë natyrën e tij ai realizon një kombinim të sistemit modular të

e nxënësve.	<p>praktikave mësimore me atë të punës në projekte. Përgatitja për panair është një projekt i madh i cili planifikohet dhe realizohet nga e gjithë klasa.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Pavarësisht nga sektori, në të cilin grupe të ndryshme nxënësish janë të angazhuar, përveç detyrave të sektorit, ata duhet të përmbushin edhe detyra në kuadër të pjesëmarrjes në panair. Kjo do të thotë që ky modul punohet paralelisht me të tjerët dhe për të gjithë klasën njëkohësisht, por me detyra të ndara sipas RN-ve dhe me një plan rotacioni të përcaktuar që më parë nga mësuesi. – Ky modul duhet të realizohet jo më parë se semestri i dytë i shkollës. Në këtë mënyrë nga njëra anë nxënësit do të kenë marrë njohuritë e nevojshme në lëndët përkatëse. – Për të mundësuar realizimin e modulit, mund të organizohen disa kohë më parë, kur është e mundur, edhe vizita në panair të fermave reale. – Mësuesi mund të përdorë në mësim edhe materiale filmike të panairëve të tjera të organizuara nga ferma reale. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e standave, të materialeve të shkruara, të reklamës dhe promocionit, për kryejen e veprimeve dhe bisedave të shitjes në panair si dhe veprimeve të nevojshme pas panairit. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen dhe prezantimin në panair. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Materiale kancelarie. – Statistika dhe informacione të panairëve të mëparshme të përpunuara nga nxënës të viteve të kaluara; – Kompiuter dhe projektor; – Materiale të ndryshme audiovizuale, foto, filma që ilustrojnë paraqitje në panair të mëparshme. – Kompiutera me programe të përpunimeve grafike dhe me lidhje në Internet. – Manualët e preventivimit dhe për zbrërthimin e kostos. – Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal). – Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.

11. Moduli: “Sigurimi i informacioneve ekonomike në internet”

Drejtimi: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	SIGURIMI I INFORMACIONEVE EKONOMIKE NË INTERNET	M-17-108-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kërkuar, gjetur, vlerësuar dhe seleksionuar informacione të ndryshme të fushës ekonomike në Internet, si dhe për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me sigurimin e informacioneve ekonomike në internet.	
Kohëzgjatja e modulit	54 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi evidenton fjalët kyçe për kërkimin e informacionit ekonomik në Internet. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kërkimin e informacionave ekonomike në Internet;– të përcaktojë saktë karakterin e informacionit që do të kërkojë, në vartësi të qëllimit të përdorimit të tij në praktikën ekonomike të fermës bujqësore;– të përcaktojë saktë burimet nga ku do të kërkohet informacioni;– të përcaktojë qartë fjalët ose frazat përcaktuese të përmbajtjes së informacionit ekonomik që do të kërkojë.– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kërkimin e informacionit në internet;– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kërkimit të informacionit ekonomik në Internet;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kërkimit të informacionit ekonomik në Internet; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje përgjigje me gojë– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi gjen dhe seleksionon informacionin e kërkuar në Internet.</p>	

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për gjetjen dhe seleksionimin e informacionit të kërkuar në Internet;
- të përcaktojë saktë “motorrin e kërkimit”;
- të përdorë fjalët kyç në kërkimin të informacionit;
- të vlerësojë drejt shkallën në të cilën informacioni i gjetur plotëson qëllimin e kërkimit;
- të provojë përdorimin e fjalëve të tjera kyç dhe funksionimin e tyre në sigurimin e informacionit në funksion të kryerjes së krahasimeve;
- të seleksionojë siç duhet informacionet ekonomike të përdorshme ndërmjet atyre të gjetura;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me gjetjen dhe seleksionimin e informacionit të kërkuar në internet;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë gjetjes dhe seleksionimit të informacionit të kërkuar në Internet;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjetjes dhe seleksionimit të informacionit të kërkuar në Internet;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi evidenton informacione dhe i përpunon ato.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për evidentimin dhe përpunimin e informacioneve;
- të evidentojë informacionet e marra në Internet;
- të krahasojë saktë informacione ekonomike të marra nga burime të ndryshme në Internet;
- të përpusojë siç duhet informacionet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë kërkuar;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me evidentimin dhe përpunimin e informacioneve;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë evidentimit të informacioneve dhe përpunimit të tyre;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë evidentimit të informacioneve në internet dhe përpunimit të tyre;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi ruan në “Favorites” adresat e informacioneve për t’u përdorur në vazhdimësi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ruajtjen në “Favorites” adresat e informacioneve për t’u përdorur në vazhdimësi;
- të evidentojë qartë adresat e faqeve në të cilat mund të gjendet informacion i dobishëm edhe për të ardhmen;
- të ruajë adresat në “Favorites” për përdorim të mëtejshëm.
- të organizojë saktë foldera në “Favorites”;
- të grupojë adresat në “Favorites” sipas grupit të informacioneve për të cilat do të përdoren në të ardhmen;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ruajtjen në “Favorites” të informacioneve ekonomike;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë ruajtjes në “Favorites” adresat e informacionit për tu përdorur në vazhdimësi;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ruajtjes në “Favorites” adresat e informacionit për tu përdorur në vazhdimësi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore të shkollës.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e demonstrimet konkrete për kërkimin e informacioneve në Internet.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionet.
- Ky modul është konceptuar si zbatim praktik në fushën e ekonomisë i njohurive të marra në lëndën e TIK.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për sigurimin dhe përdorimin e informacionit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e zyrave mësimore.
- Komputera (të paktën një kompjuter për tre nxënës).
- Rrjet të brendshëm.
- Internet me shpejtësi minimale prej 1.0 Mbps.
- Projektor të lidhur me kompjuterin e mësuesit.

-
- Informacione të shkruara ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

12. Moduli: “ Hartimi i kontratave në fermën bujqësore”

Drejtimi: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	HARTIMI I KONTRATAVE NË FERMËN BUJQËSORE	M-17-1968-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të hartuar e plotësuar kontrata të llojeve të ndryshme në fermën bujqësore, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e kontratave në fermën bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi harton kontratat ekonomike.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për hartimin e kontratave ekonomike në fermën bujqësore;– të konstatojë diferencat në qarkullimin e mallrave;– të regjistrojë diferenca në qarkullimin e mallrave;– të identifikojë elementët e kontratave ekonomike;– të përpilojë kontratat e qarkullimit të mallrave;– të plotësojë kontrata ekonomike, sipas rregullave të posaçme për lidhjen e tyre, duke kryer:<ul style="list-style-type: none">– para-bisedimet për lidhjen e kontratës;– përcaktimin e gjykatës kompetente në rast kontestimi;– përcaktimin e ndikimit të shtetit në lidhjen e kontratave ekonomike;– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin e kontratave ekonomike;– të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit të kontratave ekonomike në fermën bujqësore;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë hartimit të kontratave ekonomike në fermën bujqësore. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje përgjigje me gojë– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi kryen përpilimin dhe plotësimin e kontratave të punës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përpilimin dhe plotësimin e kontratave të punës;
- të përcaktojë kushtet për lidhjen e kontratave të punës;
- të përcaktojë efektet e kontratës së punës;
- të përcaktojë rastet e anulimit të kontratës së punës;
- të identifikojë saktë elementet e kontratës së punës;
- të përpilojë një kontratë pune;
- të plotësojë kontratën e punës, sipas kushteve të paracaktuara;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përpilimin dhe plotësimin e kontratave të punës;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përpilimit dhe plotësimit të kontratave të punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përpilimit dhe plotësimit të kontratave të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi realizon kontrata shitjeje dhe blerjeje.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për realizimin e kontratave të shitjeve dhe blerjeve për produktet bujqësore;
- të përcaktojë elementet qenësore të kontratës mbi shitjen dhe blerjen e produkteve bujqësore;
- të identifikojë objektin e kontratës mbi shitjen dhe blerjen;
- të llogarisë çmimin e kontratës mbi shitjen dhe blerjen;
- të caktojë në kontratë detyrimet e shitësit të produkteve bujqësore;
- të caktojë në kontratë detyrimet e blerësit të produkteve bujqësore;
- të identifikojë në kontratë vonesat e blerësit dhe shitësit;
- të identifikojë elementët e kontratës së shitjes së produkteve bujqësore;
- të identifikojë elementët e kontratës së blerjes së produkteve bujqësore;
- të përpilojë një kontratë shitjeje për produktet bujqësore;
- të përpilojë një kontratë blerjeje për produktet bujqësore;
- të plotësojë kontratën e shitjes dhe kontratën e blerjes.

- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me realizimin e kontratave të shitjeve dhe blerjeve.
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë realizimit të kontratave të shitjeve dhe blerjeve të produkteve bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë realizimit të kontratave të shit-blerjeve të produkteve bujqësore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme;
- të përpilojë kontratën mbi sigurimin e fermës bujqësore;
- të plotësojë kontratën mbi sigurimin;
- të identifikojë llojet e sigurimit të fermave bujqësore;
- të përcaktojë elementët e kontratës së sigurimit të fermave bujqësore;
- të identifikojë policat e sigurimit;
- të përpilojë kontratën mbi shpërndarjen e produkteve bujqësore;
- të përpilojë kontratën mbi transportimin e produkteve bujqësore;
- të plotësojë kontratën mbi transportimin produkteve bujqësore;
- të identifikojë elementët e kontratës së transportit të produkteve bujqësore;
- të identifikojë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese në sektorin bujqësor;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë hartimit dhe plotësimit të kontratave të llojeve të ndryshme;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë hartimit dhe plotësimit të kontratave të llojeve të ndryshme;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e fermave bujqësore, si dhe në mjediset e zyrave mësimore.
- Lidhur me përmbajtjen e rezultateve të të nxënësve, theksohet që moduli është i tillë që, shërben për t'u thelluar në argumente të ngjashme, të trajtuara në mënyrë më të thjeshtë edhe në zyrën mësimore që zhvillohet në shkollë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dokumentet dhe shembujt konkretë për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në fermën bujqësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të mbikëqyrur dhe të pavarur për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në fermën bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për hartimin dhe plotësimin e kontratave të llojeve të ndryshme në fermën bujqësore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjediset e zyrave mësimore dhe të fermave reale.
 - Template të llojeve të ndryshme kontratash të fermave bujqësore.
 - Materiale kancelarie.
 - Informacione të shkruara, ose elektronike të siguruar nga burime të ndryshme.
 - Kompjuter.
 - Lidhje Interneti.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

13. Moduli “Marketingu dixhital i fermave bujqësore”

Profili: Agrobiznes
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MARKETINGU DIXHITAL I FERMAVE BUJQËSORE	M-26-1969-23
-------------------------	--	---------------------

Qëllimi i modulit Një modul që pajis nxënësit me aftësitë bazë për të mundësuar marketingun e fermave bujqësore përmes teknikave të ndryshme dixhitale, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me marketingun dixhital të fermave bujqësore.

Kohëzgjatja e modulit 36 orë mësimore

Niveli i parapëlqyer për pranim Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.11-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli IV i KSHK.

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit

RN 1 Nxënësi përzgjedh platformën dixhitale dhe mediat sociale për promovimin dixhital të fermës bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë produktin bujqësor të cilit do t’i bëhet marketingu;
- të analizojë veçoritë e kategorive të klientëve të mundshëm të produktit;
- të identifikojë lloje të ndryshme të platformave dixhitale dhe mediave sociale;
- të analizojë kriteret për përzgjedhjen e platformës dixhitale dhe medias sociale;
- të përzgjedhë platformën dixhitale dhe median sociale;
- të prezantojë platformën dixhitale dhe median sociale të përzgjedhur.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përgatit materialet për hedhjen e tyre në platformën dixhitale dhe median sociale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë materiale të ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.);
- të ndërtojë video, duke përdorur programe (softëare) të ndryshme (psh. *Movie maker*, ose nëpërmjet aparatit celular, *smartphone* etj.);
- të modifikojë imazhe të ndryshme me *software*:

photoshop, canva etj.;

- të ngarkojë (publikojë) materialet e mësipërme në platformën dixhitale dhe median sociale të përzgjedhur.
- të konunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përgatitjen e materialeve për hedhjen e tyre në platformën dixhitale dhe median sociale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, sigurisë në punë dhe ato të mjedisit gjatë përgatitjes së materialeve për hedhjen në platformë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi menaxhon platformën dixhitale dhe mediet sociale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë gabimet e mundshme në materialet e ndryshme interaktive të hedhura në platformën dixhitale dhe median sociale;
- të modifikojë materialet e ndryshme interaktive (tekst, imazh, video etj.) në rast gabimesh;
- të fshijë materiale interaktive të panevojshme në platformën dixhitale dhe mediet sociale;
- të realizojë komunikimin dixhital me ndjekësit/klientët, përmes internetit/mesazheve në inbox ose komenteve për materialet e publikuara në platformën dixhitale;
- të monitorojë impaktin e mesazhit të fermës bujqësore te ndjekësit/klientët;
- të nxitë ndjekësit/klientët që të veprojnë në përgjigje të mesazhit të fermës bujqësore.
- të konunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me menaxhimin e platformës dixhitale dhe median sociale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, sigurisë në punë dhe ato të mjedisit gjatë menaxhimit të platformës dixhitale dhe medieve sociale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi përgatit raporte të dhënash mbi përdorimin e platformës dixhitale dhe medieve sociale nga ndjekësit/klientët.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë numrin e vizitorëve të platformës dixhitale dhe mediave sociale;
- të ndërtojë një paraqitje grafike mbi numrin e vizitorëve që aksesojnë platformën dixhitale dhe mediat sociale (ditore, javore, mujore);
- të evidentojë disa prej elementeve psikologjike të

Marketingut Super Efektiv nëpërmjet internetit/rrjeteve sociale (të cilët bëjnë diferencën midis një fushate të pasuksesshme dhe një fushate jashtëzakonisht të suksesshme);

- të analizojë rolin e menaxherit të platformës dixhitale dhe mediave sociale duke u bazuar tek numri i personave që i aksesojnë ato.
- të konunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përgatitjen e raporteve të të dhënave mbi përdorimin e platformës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, sigurisë në punë dhe ato të mjedisit gjatë përgatitjes së raporteve të të dhënave mbi përdorimin e platformës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi krijon një plan marketingu dixhital për fermën bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë një plan orar, ditor dhe javor në lidhje me publikimin/ shpërndarjen e informacioneve të ndryshme në platformat e përzgjedhura;
- të krijojë fushata marketingu dixhital, duke përdorur burime të ndryshme reklamimi (rrjetet sociale, e-mail ose *mobile marketing*);
- të identifikojë fushata fituese, si dhe të mirëmbajë fushatat ekzistuese të marketingut për sukses maksimal;
- të sugjerojë, nëse është e mundur, zgjidhje të mirëfillta, të shumëllojshme dhe të miranalizuara për arritjen e perceptimit të mesazhit deri tek audiencia e synuar dhe konsumatori final.
- të konunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me krijimin e planit të marketingut dixhital për fermën bujqësore;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, sigurisë në punë dhe ato të mjedisit gjatë krijimit të planit të marketingut dixhital për fermën bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e zyrave mësimore, laboratorë të TIK ose në ferma reale.
- Ky modul kërkon, që rezultatet mësimore të realizohen online.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shembujt konkretë dhe të nxisë kreativitetin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, duke rritur angazhimin e vizitorëve në faqe, duke përgatitur shkrime interaktive, të krijojnë video promovuese, të masin

efikasitetin e marketingut dixhital etj.

- Ata duhet të nxiten të diskutojnë dhe bashkëpunojnë në lidhje me proceset e punës për krijimin e një plani marketingu online për fermën bujqësore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për krijimin dhe menaxhimin e marketingut dixhital për fermën bujqësore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Zyrat mësimore në shkollë ose ferma reale.
 - Mjedise pune me kompjutera dhe lidhje interneti
 - Programe të ndryshme kompjuterike për realizimin e marketingut dixhital
 - Materiale kancelarie.
 - Pajisje për përgatitjen e materialeve promovuese.
 - Informacione mbi marketingun dixhital.
 - Legjislacioni mbi marketingun dixhital.
 - Materiale udhëzuese
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

14. Moduli “Ambalazhimi dhe etiketimi i prodhimeve bujqësore”

Profili: Agrobiznes

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE.	M-14-1970-23
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të ambalazhuar dhe etiketuar prodhimeve bujqësore (bimore dhe blegtorale) sipas standardeve të përcaktuara, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimeve bujqësore	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të kl.12-të, të drejtimit mësimor “Agrobiznes” Niveli i IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përgatitet për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bujqësor. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhur për përgatitjen e ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit bujqësor;– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bujqësor;– të përgatisë materialet e nevojshme për ambalazhimin (arka, kutia prej kartoni, qese, shise, bikerina etj.);– të organizojë vendin e punës për procesin paraprak të ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit bujqësor;– të kryejë përgatitjen e paraprake të ambalazheve dhe etiketave;– të sistemojë në vende të caktuara materialin e përgatitura;– të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përgatitjen për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bujqësor;– të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përgatitjes për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bujqësor;– të pastrojë dhe sistemojë vendin punës;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bujqësor. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Nxënësi ambalazhon dhe etiketon prodhimin bimor.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhur për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bimor;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bimor;
- të përgatisë materialet e nevojshme për ambalazhimin (kavanoz, shishe qelqi, kutia kartoni, kutia plastike etj.);
- të vendosë prodhimet bimore në ambalazhet e përgatitura sipas standartit;
- të kryejë mbylljen e mirë të ambalazheve;
- të vendosë etiketat në materialin e ambalazhuar (emri i produktit, kategorive ose cilësia, sasia neto e produktit, data e prodhimit dhe skadënces, emri i biznesit etj.);
- të sistemojë në rafte ose vende të caktuara, materialet e ambalazhuara dhe të etiketuara;
- të kryejë ajrosjen e ambjetit në mënyrë të vazhdueshme;
- të kontrollojë në mënyrë sistematike materialet e ambalazhuara dhe etiketuara për kushtet e veçanta të ruajtjes dhe të përdorimit të prodhimit bimor;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit bujqësor;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit bimor;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit bimor;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit bimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ambalazhon dhe etiketon prodhimin blegtoral.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhur për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit blegtoral;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit blegtoral;
- të përgatisë materialet e nevojshme për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit blegtoral;
- të vendosë prodhimin blegtoral në ambalazhet e përgatitura sipas standardit;
- të kryejë mbylljen e mirë të materialit të ambalazhuar;
- të vendosë etiketat në materialin e ambalazhuar (emri i

- produktit, kategorive ose cilësia, sasia neto e produktit, data e prodhimit dhe skadënces, emri i biznesit etj.);
- të sistemojë në vende të caktuara materialin e ambalazhuar dhe të etiketuar;
- të kryejë ajrosjen e ambjetit në mënyrë të vazhdueshme;
- të kontrollojë në mënyrë sistematike materialet e ambalazhuara dhe etiketuara për kushtet e veçanta të ruajtjes dhe të përdorimit të prodhimit blegtoral;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimit blegtoral;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eporët, klientët dhe kolegët gjatë ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit blegtoral;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin punës pas ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit blegtoral;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimit blegtoral.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në magazinën e bazës prodhuese të shkollës ose repartet e ambalazhimit dhe etiketimit të fermave bujqësore afër shkollës.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimeve bujqësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete punë për kryerjen e veprimeve për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimeve bujqësore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimeve bujqësore.
- Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për ambalazhimin dhe etiketimin e prodhimeve bujqësore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Arka, shishe, qese letre ose plastike.
 - Thasë letre, plasmasi etj.
-

-
- Lidhëse, bikerina, kuti kartoni ose plastike.
 - Makina për qepjen e thasëve.
 - Makina për ngjitjen e qeseve.
 - Etiketa, mjete kancelarie.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale etj.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e agrobiznesit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-